



Akademia e Sigurisë, institucion në progres

Akreditimi institucional



Akademia e Sigurisë, institutcion në progres *Akreditimi institucional*

Përgatitën për botim:

Prof. dr. Ilirjan Mandro
Prof. asc. Qetsor Orhan
Dr. Albert Hitoaliaj

Tiranë,
Akademia e Sigurisë

2023

Botim me rastin e akreditimit të parë institucional të Akademisë së Sigurisë

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Akademia e Sigurisë, institucion në progres : (akreditimi institucional) / Grup autorësh ; red. Albert Hitoaliaj. -

Tiranë, Akademia e Sigurisë, 2023

187 f. ; 16.5X24cm.

Botohet me rastin e akreditimit institucional të

Akademisë së Sigurisë

ISBN 978-9928-210-27-2

1.Arsimi i lartë 2.Policia 3.Historia 4.Shqipëri

378.6 :351.74(496.5) (091)

P Ë R M B A J T J A

Fjala hyrëse

Prof. dr. Ilirjan MANDRO, Rektor i Akademisë së Sigurisë

6

Raporti i Vetëvlerësimit të Brendshëm

Akademia e Sigurisë

21

Raporti i Vlerësimit të Jashtëm

Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë

99

Shtojcë

Dokumente

163

Ky botim u financua nga Projekti i Binjakëzimit (BE),
“Për forcimin e kapaciteteve dhe efikasitetit të Akademisë së Sigurisë”, 18 IPA JH 01 19



This project is funded
by the European Union







Fjala përshëndetëse

Ndiej kënaqësi dhe mendoj se është nder i veçantë për mua që, “firmën” e parë pas marrjes së detyrës si rektor i Akademisë së Sigurisë, ta hedh për kërkesën me objekt: “Akreditimi institucional i Akademisë së Sigurisë”, e cila i është drejtuar ASCAL-it. I gjithë procesi i akreditimit, në vetvete, përbën dhe shërben si një mekanizëm për vlerësimin e cilësisë në institucionet e arsimit të lartë. Për Akademinë e Sigurisë, procesi i akreditimit është një hap drejt përmirësimit të përputhshmërisë të cilësisë së arsimit të lartë me

standardet dhe udhëzuesit për sigurim të cilësisë në hapësirën evropiane të arsimit të lartë. Ky botim lidhet me rrugëtimin institucional drejt akreditimit. Ndaj, sa gjendet në të ka të bëjë me një analizë të thellë profesionale të politikave, akteve ligjore dhe nënligjore, statuteve dhe programeve studimore, të strukturuar e të realizuara nga ekspertë të Akademisë së Sigurisë dhe mbështetur përmes konsultave me kolegë të Universitetit të Tiranës dhe të Universitetit "Ismail Qemali" të Vlorës. Përfitoj nga rasti t'u shpreh mirënjohjen dhe falënderimet për kontributet e tyre. Lexuesi do të ndeshet me përpjekjet hulumtuese të gjithë aspekteve cilësore, të shoqëruara me analiza e rekomandime, si baza të procesit të akreditimit. Standardet dhe Udhëzuesit Evropian për Sigurimin e Cilësisë kanë ndikuar në zhvillimin e kriterëve për sigurimin e cilësisë dhe mandej zbatimin e tyre nga ana e Akademisë së Sigurisë.

Raportet që gjenden në këtë dokument janë hartuar nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm (GVB) dhe Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dhe në to evidentohen aspekte profesionale, shoqëruar me standardet e paanshmërisë të anëtarëve. Ky proces, nxori në pah këmbënguljen në mbledhjen e informacionit, punën dhe përfaqësimin në grup të njësive përbërëse dhe të studentëve duke evidentuar se e tashmja ka ardhur si pasojë e kujtesës historike të një progresi gradual dhe të sigurt. Ky botim është një pjesë nga historia e Akademisë së Sigurisë. Në të gjenden përmbledhje të të dhënave të institucionit duke u bazuar në fushat kryesore të cilësisë. Ky botim rendit mjetet dhe mënyrat se si menaxhohet ruajtja dhe zhvillimi i cilësisë, mbledh evidencat me anë të së cilave vlerësohet cilësia dhe mundëson analizimin e nevojave dhe vendosjen e synimeve për zhvillimin e cilësisë hap pas hapi. Ky dokument shërben njëkohësisht si bazë e sigurt për të rikonceptuar strategjitë, objektivat, vizionin dhe misionin e Akademisë së Sigurisë në përputhje me nevojat e kohës dhe proceset e përqasjes, me synimin për të ngritur në një nivel akoma më të lartë shkallën e performancës dhe efektivitetin e punës për të garantuar vazhdimësinë e sigurimit të cilësisë. Duke përfunduar, më lejoni të them se kemi përpara një material burimor të shkruar qartë mbi të cilin mund të mbështetet vijimi i një rrugëtimi të suksesshëm. Mendoj se një botim i tillë u vjen në dorë dhe në shërbim atyre që duan të hyjnë në zemër të njohjes së Akademisë së Sigurisë, sepse në të ka një mbulesë të gjerë të problematikave dhe të zhvillimeve të saj bashkëkohore. Ndiej kënaqësi, që mua dhe kolegëve, na u dha mundësia që të punojmë ngushtësisht në këtë proces. Ndjë admirim për çdo kontribuues dhe për punën me përkushtim të shumë gjeneratave të kësaj Akademie.

Prof. dr. Ilirjan MANDRO
Rektor



Greeting speech

It is with great honour that, after taking office as Rector of the Security Academy of Albania, that I put the first “signature” on the request with the object: “Institutional accreditation of the Security Academy”, addressed to higher education institutions. The entire accreditation process, in itself, constitutes and serves as a mechanism for assessing the quality assessment of and in higher education institutions. For the Security Academy, the accreditation process marks a step towards improving the compliance of the quality of higher education with the European

standards and guidelines for quality assurance in the area of higher education. This publication documents the institutional journey towards accreditation. Therefore, what is found in it has to do with a deep expert analysis of policies, legislative acts and by-laws, statutes and study programs, structured and implemented by experts from the Security Academy and supported through consultations with colleagues from the University of Tirana and the University of Vlora “Ismail Qemali”. I take this opportunity to express my gratitude to my colleagues and appreciation for their contributions.

In this publication, the reader will find the research efforts of all qualitative aspects accompanied by analysis and recommendations as the basis of the accreditation process. The European Standards and Guidelines for Quality Assurance have been key to the development of quality assurance criteria and thereafter implementation by the Security Academy. The reports encompassed and referred to in this document were drawn up by the Internal Evaluation Group (IEG) and the External Evaluation Group which highlight professional aspects, accompanied by the impartiality standards of the members. This process showed the persistence in gathering information, work and group representation of constituent units and students, demonstrating that it has come as a result of the historical memory of a gradual and safe progress.

This publication is part of the history of the Security Academy. It contains summaries of the institution's data based on the main areas of quality. This publication lists the means and ways of managing the maintenance and development of quality, collects the evidence by means of which quality is evaluated and enables the analysis of needs and the setting of goals for the development of quality step by step. This document simultaneously serves as a solid basis to reconceptualize the strategies, objectives, vision and mission of the Security Academy in accordance with the needs of the time and the approach processes, with the aim of raising the level of performance and effectiveness to an even higher level to guarantee continuity of quality assurance. To conclude, allow me to express that we have now in our hands a resourceful document on which we can rely for a successful journey. I think that such a publication is valuable especially for those who want to enter the heart of the knowledge of the Security Academy because it covers well the contemporary issues and recent developments. I am pleased that my colleagues and I were given the opportunity to work closely in this process. I feel admiration for each contributor and for the dedicated work of many generations of this Academy.

Prof. Ilirjan MANDRO
Rector

Akademia
e Sigurisë,
institucion
në progres
(Akreditimi
institucional)

Në vend të hyrjes...

Prof. dr. Ilirjan MANDRO

REKTORI
AKADEMIA E SIGURISË

Arsimi policor ka pasur ulje-ngritjet e veta. Kurba e zhvillimit të tij ka ndryshuar në varësi të rrethanave historike, politike, zhvillimit të shkencës dhe ligjit, mentalitetit mbi arsimin policor në përgjithësi, por edhe rolit të drejtuesve në këto zhvillime në veçanti. Koha me kërkesat dhe pritshmëritë e veta ka diktuar trajektoren e këtij zhvillimi. Qëllimi ynë, në këtë botim, nuk është të bëjmë një historik të detajuar, por të paraqesim një informacioni që është produkt i një pune të madhe të bërë nga grupet e angazhuara në Akademinë e Sigurisë prej muajit qershor e deri në nëntor të vitit 2022¹ duke përmbledhur ato që janë shtyllat bazë të arsimit policor. Titulli i këtij botimi (që mund të duket tërheqës), dhe jo pa qëllim, synon të japë esencën e përmbajtjes duke dashur të bëjë bashkë në këtë historik gjithë përpjekjet ndër vite duke përfshirë ato të studentëve të diplomuar në auditorët e kësaj shkolle, të profesionistëve të cilët zhvilluan dhe kanë kontribuar për një sistem arsimor me nivele të larta si pjesë e arsimit universitar në vendin tonë dhe modelet e përparuara të ofruara nga partnerët ndërkombëtarë për një arsimi policor evropian e më gjerë.

Në këtë botim, informacioni përcillet përmes analizës së situatave sfiduese, eksperiencës së shkuar e asaj aktuale të këtij institucioni, ballafaqimit të realitetit me standardet e kërkuara ndërkombëtare dhe sfidat jo të lehta që përballon ky profesion. Gjithçka renditet mbi bazën e prioritetëve që çojnë në realizimet e pritshme në të ardhmen, të një arsimiti policor ku kompetenca akademike e cilësia e lartë profesionale shoqërohet me elementë të një strukture dhe infrastrukture bashkëkohore me qëllim aftësimin e studentëve në detyrat që i presin dhe të atyre që trajnohen me nevojat e përditshmërisë. Çështjet e rendit dhe të sigurisë publike janë delikate. Prej tyre varet cilësia e jetës, shëndetit, mirëqenies dhe qetësisë e stabilitetit në jetën qytetare. Standardi

¹Plani i detajuar i ASCAL-it.

i tyre është tregues i ekzistencës ose jo të shtetit të së drejtës. Në realitetin e sotëm kur lufta me kriminalitetin është bërë më e ashpër dhe më e sofistikuar, roli i Akademisë së Sigurisë në përgjithësi dhe kontributi që ky institucion gjeneron përmes kursantëve² dhe studenteve³ që arsimon, në veçanti, mbetet ende një sfidë së cilës nuk mund t'i përgjigjesh me metoda të vjetra ose jo aq të avancuara sa kërkohet prej ritmeve të zhvillimit aktual.

Cilësia e zhvillimit të planeve, kurrikulave mësimore e progresiste në arsimimin policor dhe veçanërisht akreditimi i institucionit si një hap me rëndësi, kontribuojnë në garantimin e rendit dhe sigurisë publike në luftën kundër krimit dhe krimit të organizuar në mbrojtje të lirive dhe të drejtave themelore të njeriut. Një mision i shenjtë dhe aspak i lehtë për tu përmbushur me sukses pa një dedikim të plotë dhe profesionist.

1. Retrospektivë e zhvillimit arsimor policor

Krijimi i shtetit shqiptar më 28 nëntor 1912, kryeministri i vendit, Ismail Qemali, vuri si detyrë ruajtjen e rendit dhe më 13 janar 1913⁴, në fjalën e tij vë theksin se “Duhet pra, ... të mësohet puna e xhandarmërisë dhe e policisë në duar të ndershme dhe të stërvitura, të zgjidhni xhandarë dhe policë me kujdes të madh dhe të një rregulli të shtrënguar!”-.

Viti 1919 shënon vitin e fillimit të shkollimit policor/xhandar, ndërkohë që miratohet rregullorja⁵ e pranimit në polici. Çdo akt normativ i kohës për veprimtarinë e strukturave të angazhuara për ruajtjen dhe qetësinë, miratohej me vendim të këshillit të qeverisë së përkohshme. Arsimimi i këtyre strukturave ishte prioritet dhe kursi i parë profesional për xhandarmërinë me attribute e një minipolicimi është ngritur më qytetin e Durrësit, edhe pse jetëgjatësia e strukturave arsimore do të varej nga vetë jetëgjatësia e institucioneve qeverisëse.

Më 15.6.1919, në qytetin e Tiranë krijohet për herë të parë sistemi i mirëorganizuar arsimor me kornizat e një shkolle të “Xhandarmërisë Shqiptare” dhe më datën 1.9.1922 në fshatin Kaninë të rrethit të Vlorës si vazhdim i shkollës së xhandarmërisë në Tiranë⁶ hapet shkolla për trajnimin dhe formimin e strukturave të “Xhandarmërisë” ku kandidatët përzgjidheshin nga një testim me standardet e kohës. Kjo shkollë vazhdoi jetëgjatësinë e saj deri në vitin 1924.

Historia daton krijimi e një strukture të mirëfilltë mësimore dhe trajnuese me të gjithë komponentët organizativ mësimorë teorik dhe praktik më 21 maj të vitit 1938⁷. Në këtë kurs u kualifikuan 100 kadetë⁸. Ky kurs nuk la gjurmë në procesin e zhvillimit dhe aktivitetin e tij arsimor pasi kandidatët e përzgjedhur pas datës 7.4.1939, u dërguan për studime në “Shkollën e Policisë”⁹ në Caserta të Italisë. Ky grup kadetësh u emërtua

² Kursantë – në kuptimin e organizimit të brendshëm të AS-së, janë ata që vazhdojnë studimet në “Kolegjin Profesional (ish-Shkolla Bazë e Policisë)”, dhe qenë përfundim të së cilës “Certifikohen” dhe gradën policore “Inspektor”.

³ Studentë - në kuptimin e organizimit të brendshëm të AS-së janë ata që vazhdojnë studimet në Fakultetin e Sigurisë dhe Hetimit, dhe qenë përfundim të së cilës marrin “Diplomë” në nivelin “Bachelor” dhe gradën policore “Nënkomisar”.

⁴ Është caktuar si datë e themelimit të Policisë Shqiptare,

⁵ Rregullorja u miratua më datën 22.9.1919 nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë, z. Halim Gostivari.

⁶ Shkolla e xhandarmërisë e ngritur në Tiranë në vitin 1922, u transferua rrethinat e qytetit të Vlorës, në fshatin Kaninë, destinacioni i saj u kthye vetëm për përgatitjen e trajnimit e strukturave të xhandarmërisë. Kjo shkollë trajnuese funksionoi deri në qershorin e vitit 1924, kur ndodhi Kryengritja e Qershorit 1924.

⁷ Guidë e Akademisë së Policisë “Arben Zylyftari”, Botim i vitit 2002, faqe 13.

⁸ Nuk ka një statistikë të saktë për numrin e aplikimeve për këtë kurs.

⁹ “Scuola Di Polizia-Caserta”.

“I-Corso Allievi Albanesi”.

Nisur nga nevoja për ruajtjen e rendit në të gjithë vendin, në tetor të vitit 1945, organizohen kurse afatshkurtra për përgatitjen profesionale të policisë me përqendrim kryesisht në prefekturën e Tiranës, Peshkopisë dhe të Shkodër.¹⁰

Shkolla e Policisë si e tillë, filloi funksionimin në shtator të vitit 1946¹¹. Ky institucion i zhvillonte kurset për formimin policor me programe që shtriheshin në një periudhë nga 2 javë deri në 6 muaj. Në përfundim, kursanti titullohej “nënoficer policie” ose “oficer policie”¹² në varësi të kohëzgjatjes së programit mësimor që kryente. Fuqizimi i mësimdhënies nëpërmjet kurseve 4 mujore (që datojnë nga janar 1948), dhe hapja në vitin 1951 e kursit të parë policor me kohëzgjatje një vit për oficerë e nënoficerë, tregon një zhvillim progresiv për kohën dhe kujdes për arsimimin e strukturave policore. Ky sistem kursesh vazhdoi deri në vitin 1953. Më 20 janar të vitit 1954 krijohet “Shkolla e Bashkuar e Ministrisë së Punëve të Brendshme”,¹³ e cila arsimonte specialiste për një periudhë 1 deri 2 vjeçare.

Në vitin 1960 sistemi arsimor policor filloi të funksiononte me sistemin arsimor 3-vjeçar, e barasvlershme kjo me “Shkollën e mesme profesionale” të kohës. Për shkak të nevojave, në vitin 1966-1967-1968 e në vazhdim, shkolla filloi gjithashtu edhe përgatitjen e personelit të saj me kurse nga 6 muaj deri në 1 vit, sistem ky arsimimi i cili u aplikua deri në vitin 1971. Në dhjetor të vitit 1971, krijohet “Shkolla e Lartë e Ministrisë së Punëve të Brendshme”,¹⁴ ndërsa në shtator të vitit 1972, kjo shkollë filloi funksionimin e saj të rregullt duke aplikuar kërkesat e sistemit të lartë arsimor (jouniversitar). Në dhjetor të vitit 1972, me Vendim të Këshillit të Ministrave u miratuan kriteret e pranimit në Shkollën e Lartë. Programi mësimor në këtë sistem arsimor,¹⁵ zhvillohej për 2 vjet në auditorët e kësaj shkolle dhe 1 vit në formën e një praktike mësimore pranë organeve vendore policore. Në përfundim të këtij sistemi arsimor studenti mbronte diplomën dhe titullohej “Oficer policie”. Përveç zhvillimit të kurseve të studimit me kohëzgjatje 3 vjet, në shkollë kishte edhe kurse kualifikimi afat shkurtër dhe nga 6-9 muaj për studentë të cilët vinin në strukturat e Ministrisë së Punëve të Brendshme mbasi kryenin një shkollë të lartë universitare.

Në këtë kohë shkolla funksiononte mbi bazën e një plani mësimor të miratuar në vitin 1972, i cili ishte i organizuar në 2965 orë mësimore teorike e praktike si dhe 384 orë punë prodhuese.¹⁶ Përmbajtja e planit të parë mësimor të profilit të policisë kishte elementë për lëndët e kulturës së përgjithshme, profesionale, ideopolitike, përgatitjes ushtarake dhe përgatitjes fizike. Planin mësimor për lëndët e arsimit të përgjithshëm miratohej nga ministri i Arsimit të kohës, ndërsa për lëndët e përgatitjes profesionale nga ministri i Punëve të Brendshme. Pra Planin Mësimor të përgjithshëm në shkollë miratohej dhe zbatohet kundrejt dy firmave të titullarëve të ministrive përkatëse.

Kurrikula e kësaj shkolle ishte e organizuar në 29 lëndë mësimore. Përmbajtja e tyre sipas gruplëndëve ishte: lëndët ideopolitike, lëndët profesionale, lëndët e përgjithshme

¹⁰ Po aty.

¹¹ Datë 1.9.1946, shkolla e policisë filloi të funksionojë me qendër në fshatin Sauk të qytetit të Tiranës.

¹² Emërtimet e gradave dhe niveli i tyre në kohë të ndryshme kanë kuptime menaxheriale të ndryshme.

¹³ Guidë e Akademisë së Policisë “Arben Zylyftari”, Botim i vitit 2002, faqe 13.

¹⁴ Vendim i Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 184 datë 20.12.1971 “Për krijimin e Shkollës së Lartë 3-vjeçare të oficerëve të MPBr”.

¹⁵ Struktura organizative e Shkollës së Lartë përbëhej nga: Komandanti, struktura e degës mësimore, katedra e filozofisë, katedra e policisë, katedra e sigurimit, katedra e kufirit, katedra ushtarake, katedra juridike, struktura komanduese e kurseve, sektori i kuadrit dhe prapavijës.

¹⁶ Punë e cila zhvillohej në bujqësi, industri, sipas një planifikimi të mëparshëm nga drejtuesit e ministrisë.

juridike, lëndët ushtarake dhe përgatitjes fizike. Lëndët e formimit profesional kishin përparësi¹⁷ në raport me lëndët e tjera. Në raporte më të ulëta ishin lëndët e formimit juridike dhe ato të disiplinave ushtarake. Në lëndët “profesionale/speciale” bënin pjesë: shërbimet e policisë, përgatitja operative, procedura penale, kriminalistika, automobilizmi dhe praktika mësimore.¹⁸

Për të plotësuar nevojat e policisë me specialistë profesionistë, në vitin 1973, në Shkollën e Lartë, filloi të funksionojë edhe sistemi i arsimit policor me korrespondencë (pa shkëputje nga puna) për një periudhë 4-vjeçar. Plani mësimor i vitit 1974, mbi bazën e nevojave, solli ndryshimet e nevojshme në përshtatje dhe me zhvillimet e kohës.

Në vitin 1977, pranë këtij institucioni filloi të funksiononte “Këshilli Shkencor i Shkollës së Lartë”. Në vitin 1979, pranë Shkollës së Lartë u ngrit “Komisioni i Aftësimit Profesional”. Plani mësimor i studimeve të vitit 1979 evoluoi duke rritur në 21 % orët mësimore në planin mësimor në krahasim me planin mësimor të vitit 1972. Struktura e planit mësimor për vitin akademik 1979-1980 kishte gjithsej 39 javë mësimore (ose 3780 orë mësimore). Në planin mësimor u pa e domosdoshme marrja e informacionit në lëndën e gjuhës shqipe, rritja e orëve mësimore në lëndët e gjuhëve së huaja¹⁹ dhe lëndëve ideologjike. Ajo që duhet të veçojmë nga përvoja e kësaj shkollë në ato vite, është fakti se, pas vitit 1979, ka filluar një “lëvizje e brendshme” për kualifikimin e mëtijshëm të personelit mësimdhënës, njohjen e gjuhëve të huaja, rritjen e cilësisë së përgatitjes profesionale të studentëve dhe nxitjen e tyre për përvetësimin e programit me rezultate të larta dhe mandej për kualifikimin e tyre në vazhdimësi.

Në vitin 1980, filluan të jepen për herë të parë provimet e formimit pasuniversitar nga trupa pedagogjike pranë Fakultetit të Shkencave Politiko-Juridike. Deri në mesin e viteve ‘80, në Shkollën e Lartë, 33% e stafit pedagogjik vazhdonin kualifikimin pasuniversitar. Një pjesë e tyre edhe mbrojtën grada dhe tituj shkencorë në fushat profesionale, juridike dhe shkencave sociale. Sipas dokumentacionit arkivor që disponojmë, vlerësojmë se në vitet 1980-1990, kjo shkollë mori një fizionomi më të plotë në drejtim të ndryshimit të planit e programeve mësimore, aktiviteteve kërkimore e shkencore të trupit pedagogjik, të bazës didaktike dhe nivelit të studentëve që diplomoheshin.²⁰ Me vendim të KM²¹ nr. 2, dt. 16.2.1982, “Për ngritjen e mëtijshme të punës mësimore edukative të shkollave ushtarake”, Shkolla e Lartë e MPB-së merr një fizionomi të re, me program të plotë mësimor trevjeçar në auditor dhe në shtator të vitit 1984, shkolla e ngritur dhe trashëguar si aset, në kodrat e Tiranës, në fshatin Sauk, u përfshi në një proces ndryshimi të programeve mësimore, kërkimit shkencor, trupës pedagogjike e bazës didaktike. U krijua një sistem arsimor 4-vjeçar me shkëputje nga puna dhe 5-vjeçar pa shkëputje nga puna.

Gjatë periudhës 1975-1990, në Shkollën e Lartë janë përgatitur 365 studentë për oficer policie,²² si dhe janë kualifikuar e specializuar shumë punonjës policie të rolit të

¹⁷ 37-45.7 % e planit të përgjithshëm mësimor.

¹⁸ Arkivi i Ministrisë së Punëve të Brendshme, Dosje nr. 464, viti 1972.

¹⁹ Në vitin 1982 në strukturën e shkollës u krijua edhe katedra e gjuhëve të huaja ku zhvilloheshin gjuhët e huaja si anglisht, rusisht, serbo-kroatisht.

²⁰ Kërkesat gjithnjë në rritje për nivelin e studentëve bënë që, në planin mësimor të vitit 1984, të shtohen disiplina të reja si Logjika, Kontabiliteti, Kriminologjia, Informatika etj, ndërsa plani i vitit 1985 iu dha prioritet shtimit të disiplinave juridike. Një grup pedagogësh nga Universiteti i Tiranës, asistuan në hartimin e Planit Mësimor miratimi i të cilit bëri hop cilësor në dhënien e njohurive juridike duke filluar aktivizimin në mësimdhënie staf nga Fakulteti i Drejtësisë të Universitetit të Tiranës.

²¹ Vendim i Këshillit të Mbrojtjes, nr. 2, datë 16.2.1982, “Për ngritjen e mëtijshme të punës mësimore edukative të shkollave ushtarake”, ku përfshihen 9 shkolla ushtarake, përfshi edhe SHL të MPB-së.

²² Aspektet e vetëvlerësimit të cilësisë në Akademinë e Policisë “Arben Zylyftari” faqe 7, mars 2005 (Arkiva e Akademisë së Policisë, Zyra e personelit në Akademi).

mesëm e të lartë sipas profileve përkatëse. Terreni, kërkonte që dhe punonjësit e policisë në nivel patrulle, inspektorë të policisë rrugore apo punonjësit e policisë në zonë, të kishin një nivel arsimor më të lartë, për t'ju përgjigjur me profesionalizëm luftës kundër kriminalitetit dhe mbrojtjes së qytetarëve.

Në nëntor të vitit 1986, në bazë të detyrave që do të kryente ky nivel policor, u hartuan programet mësimore dhe u hap shkolla 2-vjeçare për punonjës policie të këtij roli.²³ Në vitin 1991, kjo shkollë emërtohet “Instituti i Policisë” dhe programet mësimore u “tkurrën” për tu zhvilluar në një vit akademik. Kursantët, në përfundim të këtyre studimeve, titulloheshin “Punonjës Policie”. Gjatë kësaj periudhe u hapën dhe mjaft kurse formimi 1-3 tremujore për punonjësit e policisë të rolit bazë. Me fillimin e ndryshimeve demokratike në shtator të vitit 1991, në një periudhë transitore, ndryshon emërtimi nga “Shkolla e Lartë e Ministrisë së Punëve të Brendshme”, në “Instituti i Lartë i Rendit”.²⁴ Sistemi i studimit, me këto ndryshime ishte me dhe pa shkëputje nga puna. Ky organizim nuk vazhdoi gjatë. Në shtator 1992²⁵ u krijua “Akademia e Rendit Publik”, si institucion i lartë arsimor për përgatitjen e oficerëve të përgjithshëm të policisë.

Ndryshimet organizative të kësaj kohe konsistonin në krijimin e strukturave të reja sipas shërbimeve si: katedra e policisë kriminale, katedra e shërbimeve të rendit, katedra juridike, katedra e përgjithshme, katedra e përgatitjes ushtarake dhe fizike. Në këtë periudhë u bënë ndryshime të rëndësishme në planin dhe programet mësimore duke “u zhveshur” nga lëndë me terma ideologjike e politike, dhe duke i zëvendësuar me disiplina të reja mësimore. Për herë të parë në vitin 1993, u fut disiplina e sociologjisë dhe disa lëndë të reja të formimit juridik. Sistemi arsimor ishte 3 vite akademikë për formimin e “oficerëve të përgjithshëm të policisë” me shkëputje nga puna dhe 4 vjet për sistemin pa shkëputje nga puna. Në sistemin pa shkëputje nga puna, prej vitit 1991 filloj të ketë një rritje të numrit të femrave që studionin për specialiste të larta policie.²⁶ Në shtator të vitit 1993, në akademi pranohen 25 studentet e para me shkëputje nga puna për “Specialiste të Larta Policie”. Kjo traditë vijon edhe sot.

Në vitin 2000 mbi bazën e një tradite të gjatë shkollimi policor, krijohet “Akademia e Policisë”²⁷ në përbërje të së cilës ishte edhe “Instituti i Policisë”. Hartimi i planit të ri mësimor në vitin 2001-2002, pati si objektiv përafrimin me standardet e shkollave homologe të larta. U rregulluan raportet midis mësimave teorike e praktike në kuotat 51 % me 49 %, u reduktuan njohuritë paralele të dhëna në lëndë të ndryshme, si dhe u futën një serë disiplinash të reja universitare dhe profesionale si: “Psikologji e personalitetit”, “Psikologji e komunikimit”, “Sociologji dhe etikë profesionale”, “E drejta e policisë”, “Taktikat e ndërhyrjes”, “Teknikat e sigurisë”, “Investigimi i krimit”, “Teknikat informative”, etj. Në vitin 2009²⁸ pas një vendimi të KM mbyllet Akademia e Policisë “Arben Zylyftari” dhe prej vitit 2006 filloi organizimi i një sistemi arsimor që funksiononte në formën e një qendre të formimit policor, si hap i parë për zhvillimin e karrierës në polici si strukturë arsimore. Ky program trajnimi kishte një kohëzgjatje 48-javore ku përfshiheshin modulet bazë teorike dhe praktike. Kursi avanconte me trajnimet në terren, i cili mbikëqyrej nga tutor, të specializuar si “Oficer të Trajnimit në Teren”

²³ Shkolla 2-vjeçare e Policisë.

²⁴ Shih vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 339, datë 2.9.1991.

²⁵ Shih Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 405, datë 15.9.1992.

²⁶ “Specialistë policie”, prej të cilëve 1633 studentë me sistemin me shkëputje nga puna dhe 2264 studentë me sistemin pa shkëputje nga puna.

²⁷ Shih vendimin e KM, nr. 281, datë 2.6.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Akademisë së Policisë”.

²⁸ VKM nr.135, datë 11.2.2009 pushon të funksionuari “Akademia e Policisë “Arben Zylyftari”.

(OTT). Kjo qendër është pjesë përbërëse e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit”.

Rihapja e Akademisë së Sigurisë²⁹ në vitin 2015³⁰ dhe konceptimi i saj strukturor, infrastrukturor e në kurrikula si institucion i arsimit të lartë publik me programe të arsimit bazë policor, specializime dhe trajnime sipas kërkesave të arsimit të lartë dhe Kartës së Bolonjës gjeti shprehjen e vet dhe në Ligjin e Policisë së Shtetit³¹. Qëllimi i vetëm në këtë kohë ishte kapërcimi i boshllëqeve të krijuara në vite në fushën e arsimit dhe edukimit profesional policor, shkaktuar nga ndërprerja e studimeve të larta për rendin dhe sigurinë publike. Ky riorganizim do të ndikonte pozitivisht në rritjen e bashkëpunimit me institucionet e tjera arsimore publike dhe jo publike, brenda dhe jashtë vendit, në funksion të mbështetjes së Policisë së Shtetit për një vendimmarrje eficiente në ushtrimin e veprimtarisë së saj dhe rritjen e sigurisë në vend.

2. Kuadri ligjor në vite

Baza juridike mbi të cilën ka funksionuar shkolla në të gjitha fazat e zhvillimit të saj kanë qenë ato arsimore dhe konkretisht ligjet për arsimin e lartë³², legjislacioni policor,³³ vendime të Këshillit të Ministrave,³⁴ urdhra të ministrave përkatës, etj. Aktet normative dhe mandej miratimi i dokumenteve bazë institucionale kanë synuar në normimin e rregullave që krijojnë më shumë hapësira për zhvillimin e veprimtarisë mësimore dhe shkencore, forcimin e rregullit dhe disiplinës në procesin e mësimin, rritjes së autoritetit profesional, si dhe për një evidentim dhe përsosje të vlerave pedagog-student dhe anasjelltas. Ligji i arsimit të lartë, praktikatat universitare paraqitën nevojën që Akademia e Policisë të kishte një dokument bazë. I tillë është “Statuti i Akademisë së Policisë”³⁵ i ndryshuar³⁶ dhe mbi bazën e tij doli “Rregullorja e brendshme e funksionimit të Akademisë”.³⁷ Akte të tjera me rëndësi janë “Aneksi” i rregullores së brendshme me përmbajtje “Detyrat funksionale të personelit sipas organikës”,³⁸ “Rregullorja për konkurrimet e pranimit në akademi”,³⁹ “Programi i pranimit për nëninspektorë dhe agjentë policie”. Këto akte krijuan një disiplinim të aspekteve mësimore dhe administrative në akademi.

Ndryshimet ligjore e nënligjore synuan krijimin dhe përsosjen jo vetëm të bazës

²⁹ VKM nr. 135, datë 11.2.2009, “Për mbylljen e Akademisë së Policisë” dhe riorganizimin e arsimit policor, Akademia pushoi aktivitetin si institucion i arsimit të lartë dhe fillon të funksionojë si “Qendër për Formimin Policor” (Shkolla Bazë e Policisë).

³⁰ Me VKM nr. 185 datë 25.2.2015, u krijua Akademia e Sigurisë, përgjegjëse edhe për edukimin dhe trajnimin e punonjësve të strukturave të sigurisë në Shqipëri.

³¹ Ligji për Policinë e Shtetit, nr. 108/2014, në nenin 37, parashikohet që Policia të ketë institucionin e saj arsimor përgjegjës për formimin, specializimin dhe kualifikimin e punonjësve të strukturave të Policisë së Shtetit të nivelit operues, administrativ dhe menaxherial.

³² Shih për shembull, ligji nr. 8461, datë 25.2.1999 “Për arsimin e lartë në RSH”, etj.

³³ Shih për shembull, ligji nr. 8553, datë 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit”, etj.

³⁴ I tillë është, për shembull, VKM nr.135, datë 11.2.2009 “Akademia e Policisë “Arben Zylyftari”; VKM nr. 281 datë 2.6.2000 “Për organizimin e funksionimit të Akademisë së Policisë”.

³⁵ “Statuti i Akademisë së Policisë Arben Zylyftari”, miratuar me urdhrin e ministrit të Rendit Publik nr. 1550 datë 11.9.2001.

³⁶ Po aty.

³⁷ “Rregullorja e brendshme e Akademisë”; propozuar nga Këshilli i Akademisë dhe miratuar me urdhrin e Drejtorit të Akademisë nr. 342, datë 31.10.2001.

³⁸ “Detyrat e personelit sipas organikës”, miratuar me urdhrin e Drejtorit të Akademisë, nr. 342, datë 31.10.2001.

³⁹ “Rregullorja për konkurrimet/pranimit në Akademi”, miratuar me urdhrin e ministrit të Rendit Publik, nr. 2001 datë 11.09.2004.

juridike të saj, por edhe të rregullimit e harmonizimit të së gjithë aktivitetit dhe veprimtarisë së këtij institucioni si në procesin e mësimdhënies edhe të trajtimit ekonomik e social të studentëve e kursantëve, me qëllim përsosjen e standardeve të rekrutimit të kandidatëve për studentë dhe kursantë policie⁴⁰, si dhe demokratizimin e tërë veprimtarisë së shkollimit të tyre.

2.1 Statusi i Akademisë së Policisë

Statusi i shkollës, prej krijimit të saj e deri në ditët e sotme ka ardhur gjithnjë në përmirësim dhe rritje. Miratimi i kuadrit ligjor për Policinë e Shtetit, në vazhdimësi⁴¹, bëri të mundur krijimin e statusit të ri për Akademinë e Sigurisë⁴². Sipas ligjit “Për arsimin e lartë në RSH”⁴³, Akademia e Sigurisë përfshihet në sistemin e shkollave të larta duke përfutur në statusin e saj të gjithë të drejtat e detyrimit që rrjedhin nga ligji në fjalë⁴⁴. Statusi i saj juridik⁴⁵ është shoqëruar edhe me ndryshime në fushën e demokratizimit të jetës së brendshme të Akademisë, të shprehura në autonominë dhe lirinë akademike në procesin mësimor, në fushën e mësimdhënies dhe kërkimeve shkencore si dhe në respektimin e opinionëve, të ideve e metodave me bashkëkohore.

2.2 Misioni dhe objektivat e Akademisë së Sigurisë

Në strategjinë e reformës në Policinë e Shtetit, Akademinë së Sigurisë, si institucion i lartë arsimor, i lihet detyrim institucional për riorganizimin e saj për të realizuar misionin e formimit dhe kualifikimit të personelit të policisë. Në programin e zhvillimit strategjik të Akademisë si institucion i lartë mësimor dhe kërkimor shkencor, janë përcaktuar misioni dhe këto objektiva. Realizimi i misionit dhe objektivave të Akademisë së Sigurisë shprehet në produktin që ajo nxjerr: “Në përfundim të studimeve një vit akademik, kursanti në “Kolegjin Profesional të Formimit Policor” pajiset me një certifikatë që dëshmon kryerjen me sukses të programit. Në përfundimin e studimeve trevjeçare, “Bachelor”, studenti i Fakultetit të Sigurisë dhe Hetimit, pajiset me diplomë “Bachelor” në “Siguri dhe Hetim”; ndërsa kursantët e të gjithë kurseve të kualifikimit pajisen me certifikata sipas specialiteteve janë që trajnuar.

3. Strategjitë e arsimimit policor

Në zbatim të Strategjisë së Reformës në Policinë e Shtetit⁴⁶, Akademia, duke u gjendur në dilemën e zigzaget nëpër të cilat ka kaluar kjo shkollë si dhe duke u nisur nga kërkesat bashkëkohore për zhvillimin arsimor dhe shkencor, në vitin 2015, hyri në

⁴⁰ Vendimi i KM, nr. 605 datë 13.10.2001, “Për kurset e formimit profesional të kualifikimit e specializimit në Akademinë e Policisë “Arben Zylyftari”.

⁴¹ Ligji për Policinë e Shtetit, nr. 108/2014, i ndryshuar.

⁴² Vendimi i Këshillit të Ministrave, nr. 185 datë 25.3.2021, Për ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, të ndryshuar.

⁴³ Ligji nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH”.

⁴⁴ Vendimi nr. 7 datë, 27.1.2023, “Akreditimi për herë të parë i institucionit të arsimit të lartë, Akademia e Sigurisë”.

⁴⁵ Vendimi i Këshillit të Ministrave, nr. 881, dt. 28.10.2020, i ndryshuar me VKM, nr. 320, dt. 2.6.2021, “Për dhënien e statusit të veçantë Akademisë së Sigurisë, si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e rendit dhe sigurisë publike, si dhe organizimi e funksionimi i saj”.

⁴⁶ Urdhër i ministrit të Brendshëm, nr. prot 5449/6 datë 26.10.2022 “Për miratimin e strukturës dhe organikës të Akademisë së Sigurisë”.

rrugën e reformës institucionale. Synimi i kësaj reforme ishte konsolidimi i sistemit të arsimit dhe kualifikimit të punonjësve të policisë me qëllim ngritjen e nivelit profesional sipas standardeve të përfuara të policimit evropian.

Programet e hartuara nga njësitë kryesore në akademi, përcaktojnë vizionin dhe konceptin modern për shkollimin e policisë, drejtimet kryesore, rrugët, mënyrat dhe mjetet për të ndërtuar një sistem bashkëkohor arsimi dhe kualifikimi. Njëkohësisht për të zhvilluar një aktivitet kërkimor shkencor nisur nga nevojat e kohës dhe ato të perspektivës së policimit, ky program përbën bazën për ndryshimet në vijim të akteve normative, ndërtimin strukturor, hartimin e planit e programeve të reja mësimore dhe zhvillimin e kërkimeve dhe studimeve shkencore në fushën e policimit. Në zbatim të programit strategjik dhe politikave të zhvillimit arsimor policor, u hartua planveprimi (kur) për zbatimin e programit sipas fushave të reformës dhe fazave përkatëse. Zbatimi i këtij programi, ka vendosur disa prioritetet e rëndësishme që lidhen me:

- krijimin e infrastrukturës ligjore e nënligjore të AS-së;
- ristrukturimin dhe konsolidimin e AS-së si institucion i lartë arsimor dhe i vetmi përgjegjës për arsimin policor dhe strukturat e tjera ligjzbatuese;
- zhvillimin e programeve të reja mësimore sipas standardeve evropiane dhe të përvojave më të mira të ofruara nga partnerët tanë ndërkombëtarë;
- përforcimin e kriterëve dhe procedurave në përzgjedhjen e stafit akademik e mësimdhënës dhe punonjësve të rinj të policisë;
- rritjen e aktivitetit kërkimor dhe atij shkencor;
- përmirësimin e kushteve të akomodimit dhe studimit në AS.

Ndryshimet ligjore e nënligjore që u bënë në këtë periudhë⁴⁷ kanë synuar në krijimin dhe përsosjen e bazës normative të Akademisë së Sigurisë, rregullimin dhe harmonizimin e gjithë aktivitetit dhe veprimtarisë së këtij institucioni sipas legjislacionit të ri, plotësimet dhe rregullimet e nevojshme të akteve të ndryshme për mësimdhënien dhe trajtimin ekonomik e social të studenteve dhe kursanteve, për përforcimin e standardeve të rekrutimit të kandidatëve për studentë dhe kursantë policie, si dhe demokratizimin e tërë veprimtarisë së shkollës.

4. Struktura organizative

Synimi i organizimit të ri strukturor⁴⁸ ishte ngritja dhe konsolidimi i një institucioni arsimor, kërkimor shkencor në funksion të nevojave të Policisë së Shtetit dhe organizmave të tjerë ligjzbatues. Për këtë nevojiteshin struktura të konsoliduara dhe elastike, rregulla e procedura të qarta funksionimi të tyre dhe hapësira për përmirësim në vijimësi. E veçanta e ndryshimeve organizative të akademisë, prej muajit qershor 2022 e në vazhdim, qëndron te krijimi hap pas hapi i strukturave të reja të organizuara sipas specifikave të formimit të përgjithshëm universitar dhe profesional, duke qenë në përputhje me kërkesat e ligjit të arsimit të lartë; organizime të tilla si: rektor⁴⁹, Rektorat, administrator, dekan, Dekanat, njësi kryesore dhe bazë mësimore-shkencore.

Kjo strukturë organizative u shoqërua me një infrastrukturë ligjore, e cila përfundoi

⁴⁷ Urdhër i përbashkët, nr. 130 datë 10.3.2023 i ministrit të Arsimit (1322/2 datë 10.3.2023) dhe ministrit të Brendshëm (13475/9 datë 28.3.2023) "Për miratimin e Statutit të Akademisë së Sigurisë".

⁴⁸ Po aty.

⁴⁹ Urdhër i përbashkët, nr. 521 datë 9.9.2022 i ministrit të Arsimit (5165/2 datë 9.9.2022) dhe ministrit të Brendshëm (Prot. 1960/5 datë 3.10.2022) "Për caktimin e Rektorit të Akademisë së Sigurisë, prof. dr. Ilirjan Mandro".

me Statutin e AS-së⁵⁰, “Rregulloren e brendshme të AS-së”⁵¹ si dhe akte të tjera në të cilat përcaktohen standarde të reja për rekrutimin e personelit mësimdhënës dhe punonjësve të rinj të policisë (studentëve e kursantëve).

4.1 Standardet e pranimeve të studentëve në akademi

Deri në vitin 1990 studentët regjistroheshin në shkollë me urdhrin e ministrit të Brendshëm. Pas kësaj periudhe pranimet dhe regjistrimet në shkollë bëheshin vetëm me konkurs si për kandidatët për kursantë edhe për kandidatët për studentë. Kandidatët nevojitej të plotësonin disa kriteret.⁵² Konkurrimi i kandidatët për kursantë apo studentë në Akademinë e Policisë pasi janë kualifikuar për procesin e pranimet në AS, i nënshtrohen fazave të konkurrimit⁵³:

- testimi me shkrim;
- testimi i aftësive fizike;
- intervista me gojë, ushtrime vlerësuese dhe testimit të aftësive të të shkruarit;
- testimi psikologjik;
- kontrolli shëndetësor;
- marrja dhe identifikimi i shenjave daktiloskopike;
- verifikimi përfundimtar i kandidatit.

Procedurat e pranimet dhe konkurrimit janë përcaktuar në rregulloren përkatëse të miratuar nga ministri i Rendit Publik dhe kriteret të përcaktuara në aktet e tjera ligjore e nënligjore⁵⁴. Programet e lëndëve për të cilat duhet të përgatitet kandidati janë përgatitur nga njësitë kryesore në akademi dhe miratuar nga Senati Akademik. Këto të fundit iu vihen në dispozicion të gjitha drejtorive dhe komisarivateve në qarqe me qëllim që kandidatët të mund të njihen me to dhe t’ju referohen në përgatitjen e tyre teorike dhe fizike për testim. Të përzgjedhur për studime në AS, janë shtetasit që fitojnë konkursin mbi bazën e rezultateve të arritura në rend zbritës, deri në kufirin e kuotës së pranimeve sipas nevojave të përcaktuara nga Drejtoria e Personelit në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, për vitin akademik në vijim.

Për nevojat e sektorëve specifik në polici, që kërkojnë njohuri të posaçme nga fusha të tjera si mjekësi, informatikë, ekonomi, drejtësi, biologji etj., akademia harton programe specifike profesionale për këtë kategori studentësh. Edhe në këto raste kandidatët e fitonin të drejtën përmes konkurrimit. Gjithashtu, akademia, afron programe studimi apo kualifikimi për punonjës të strukturave të tjera ligjzbatuese në bazë të marrëveshjeve dypalëshe.

5. Progres

Të analizosh situatën për vite të tëra është një detyrë e vështirë, sidomos në këto pak faqe ekspozive, por është shumë e rëndësishme nëse duam të ecim përpara. Problematikat

⁵⁰ Urdhër i përbashkët, nr. 130 datë 10.3.2023 i ministrit të Arsimit (1322/2 datë 10.3.2023) dhe ministrit të Brendshëm (13475/9 datë 28.3.2023) “Për miratimin e Statutit të Akademisë së Sigurisë”.

⁵¹ “Rregullore e brendshme të AS-së”, miratuar nga Senati Akademik i AS-së.

⁵² Të kenë zotësi të plotë për të vepruar; të kenë kryer arsimin e mesëm; të kenë kryer shërbimin ushtarak (vetëm për kursantë-meshkuj); të kenë sjellje të mira qytetare; të mos jenë dënuar penalisht; të kenë mbushur moshën 19 vjeç, ndryshuar me “Rregullore e Policisë së Shtetit” miratuar me VKM nr. 750, datë 16.9.2015 neni 127.

⁵³ “Rregullore e Policisë së Shtetit”, miratuar me VKM nr. 750, datë 16.9.2015 neni 135.

e hasura në kohë, na lejojnë të bëjmë një analizë të kujdesshme të:

- bazës ligjore dhe nënligjore që ndikon në veprimtarinë e Akademisë;
- bashkëpunimit me misionet e huaja policore dhe disa shkolla homologe jashtë vendit;
- planeve dhe programeve mësimore;
- kualifikimit të specialistëve të gjitha roleve të Policisë së Shtetit dhe strukturave të

tjera ligjzbatuese, për të qenë të aftë dhe të përkushtuar për mbrojtjen e rendit dhe të sigurisë publike;

- ballafaqimit me ndërlidhjen teori-praktikë dhe të kuptojmë drejt pozicionin aktual, distancën që kemi me standardet e kërkuara dhe mjetet për të shkuar deri në këtë destinacion.⁵⁵

Është e rëndësishme që objektivat e arsimit të lartë policor në çdo mënyrë dhe këndvështrim të korrespondojnë me nevojat e praktikës policore. Sigurimi i cilësisë arsimore⁵⁶ në Akademi, në përshtatje me kërkesat e standardet e shkollave policore evropiane dhe më gjerë, ishte një nga drejtimit kryesore të reformës institucionale të arsimit policor shqiptar⁵⁷.

Qëllimi i përgjithshëm i rishqyrtimit institucional të Akademisë së Sigurisë ishte të vlerësonte shkallën e përmbushjes së “Standardeve të Cilësisë të Arsimit Policor Shqiptar”. Kërkesa për studim të organizimit, programimit dhe funksionimit të Akademisë së Sigurisë, drejtuar Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë⁵⁸ (ASCAL), këtë synim kishte.

Raportet mbi rezultatet e këtij shqyrtimi shërbejnë jo vetëm për akreditimin institucional të Akademisë, por dhe në peshën e institucionit në renditjen e institucioneve të tjera të arsimit të lartë. Raporti i hartuar nga grupi i vlerësimit të brendshëm⁵⁹ dhe të jashtëm, ndihmon në identifikimin e prioritetëve në të gjithë aspektet që lidhen me sistemin e arsimit të lartë. Raporti identifikon tipare të praktikave të mira, rekomandime, pohime për veprimet në proces dhe dobësitë për secilën “fushë të vlerësimit”, së bashku me një gjykim mbi formatin e përmbushjes së standardeve⁶⁰.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm ka shqyrtuar dokumentacionin⁶¹ e vetëvlerësimit të

⁵⁴ “Rregullore e Policisë së Shtetit”, miratuar me VKM nr. 750, datë 16.9.2015, me ndryshime VKM 1143 datë 9.12.2020, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 750, datë 16.9.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores së Policisë së Shtetit”.

⁵⁵ Aspektet e vetëvlerësimit të cilësisë në Akademinë e Sigurisë, në vijimësi të materialit.

⁵⁶ AAAL është institucion përgjegjës për vlerësimin e cilësisë së AL si në aspektin e zhvillimit të programeve mësimore ashtu dhe në ato institucionale. Vlerësimi nga kjo agjenci ushtrohet nëpërmjet një grupi ekspertësh i vlerësimit të jashtëm të institucionit arsimor që vlerësohet. Ky proces kryhet sipas kriterëve e procedurave të hartuara nga AAAL dhe miratuar nga Bordi i Akreditimit. Në materialin e vlerësimit evidentohet misioni dhe objektivat e institucionit, programet, kurrikulat mësimore, strukturat organizative, analizat e kurseve të studimit, e të programeve, bashkëpunimi me institucionet e tjera homologe jashtë vendit. Vlerësohet për nivel dhe cilësi në mësimdhënie stafi pedagogjik, kërkimet shkencore, fasilitetet, burimet materiale, logjistike, financiare e burimet e tyre.

⁵⁷ Më 23.5.2022, i kërkohej Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë (ASCAL), për fillimin e procesit të vlerësimit të Akademisë së Sigurisë si institucion i vetëm arsimor për strukturat ligjzbatuese. Akreditimi i saj do të ndikojë në zhvillimin dhe rritjen cilësore të programeve dhe nivelit mësimdhënës pedagogjik.

⁵⁸ Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë është krijuar me vendim të posaçëm të KM, nr. 109 datë 15.2.2017, nga riorganizimi i Agjencisë Publike të Arsimit të Lartë e cila është krijuar me VKM, nr. 303 datë 1.7.1999 dhe në mbështetje të ligjit nr.80/2015, për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor”.

⁵⁹ Grupi i punës për vlerësimin e të brendshëm të institucionit u drejtua nga prof. asc. Qetso Orhan dhe me anëtarë: prof. asc. Zaho Golemi, dr. Albert Hitoaliaj, dr. Fjorida Ballauri, drejtues Konstandin Naço, studente Kadife Muça, student Besmir Rexha (Urdhër i Rektorit të AS-së, nr. 112/2, dt.20.6.2022). Koordinator me zyrat e ASCAL-it, u caktua kryekomisar Arjan Zoto.

⁶⁰ a-standardet janë plotësuar plotësisht; b- standardet janë përmbushur kryesisht; c- standardet janë përmbushur pjesërisht; d- standardet nuk janë përmbushur.

⁶¹ Grupit të vlerësimit të jashtëm dhe Bordit të Akreditimit iu paraqitën tetë dosje voluminoze me rreth 6000 faqe në shqip dhe anglisht.

përgatitur nga strukturat e Akademisë së Sigurisë, ku përfshiheshin të dhëna të përgjithshme institucionale, raporte të vetëvlerësimit dhe dokumentacionet mbështetëse ku vetë strukturat e akademisë paraqitën në mënyrë të drejtpërdrejtë pikat e forta dhe të dobëta si pjesë e një analize për të vendosur piketat e forta në zhvillimin e sistemit arsimor policor në Shqipëri. Data 23 maj 2022 shënoi fillimin e këtij procesi akreditimi⁶², me kërkesën e bërë nga Akademia e Sigurisë, institucionit të ASCAL-it për miratimin dhe fillimin e procedurave për këtë proces sa të vështirë po aq dhe sfidues.

Stafi drejtues i Akademisë së Sigurisë, vlerësoi procesin akreditues si një domosdoshmëri për rritjen cilësore dhe profesionale të së vetmit institucion arsimor për strukturat ligjzbatuese. Angazhimi, bashkëpunimi dhe kooperimi institucional bëri që nga ana e akademisë, në gjashtë muaj, maj-nëntor 2022⁶³, të përgatiteshin qindra dokumente (mbi 6000 faqe), në shqip dhe në anglisht, në funksion të akreditimit institucional si dhe organizimin e gjithë takimeve të kërkuara me ekipin e shqyrtimit dokumentar të vlerësimit të jashtëm, të ASCAL-it.

Në fund të këtij procesi u konstatua se procedura dhe procesi i vlerësimit ishin kryer në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore, procedurën dhe afatet e përcaktuara nga ASCAL për këtë proces, vlerësimi në përmbajtje i mbështetur në dokumentacionin e vetëvlerësimit, vlerësimit të jashtëm si dhe gjetjet e verifikimet gjatë vizitës në institucion.

Aspekti i rëndësishëm në gjithë këtë proces, është vlerësimi përfundimtar “pozitiv” i Grupit të Vlerësimit të Jashtëm për cilësinë akademike të Akademisë së Sigurisë. Mbi këtë bazë dhe pas studimit të dosjeve, Bordi i Akreditimit ka bërë vlerësimin përfundimtar “pozitiv për Akademinë e Sigurisë”, me “Akreditim Institucional me kohëzgjatjen prej pesë vite 27.1.2023 deri më 26.1.2028”. Rekomandimet në zbatim të vendimit të Bordit të Akreditimit⁶⁴ për Akademinë e Sigurisë, janë si vijon:

a. Akademia e Sigurisë si IAL të krijojë e verë në përdorim të studentëve një sistem informatik të dedikuar për menaxhimin akademik të institucionit, i pavarur nga sistemi informatik i Policisë së Shtetit, ku studentët të kenë akses në programet e studimit, syllabuset, etj.;

b. Akademia e Sigurisë të rrisë mbështetjen financiare për personelin akademik, në kuadër të projekteve kërkimore shkencore, publikimeve të librave shkollorë, si dhe pjesëmarrjes në konferenca;

c. Akademia e Sigurisë të promovojë më tej mobilitetin e studentëve dhe personelit akademik;

d. Akademia e Sigurisë të marrë masa për rritjen e gjurmueshmërisë së studentëve të diplomuar si edhe të rrisë bashkëpunimin me ta”.

Të gjitha këto rekomandime⁶⁵ të marra së bashku në përmbushje të tyre do të rrisin cilësinë dhe standardet arsimore duke shërbyer më mirë për garantim të rendit dhe sigurisë në të ardhmen.

⁶² Firma e parë e hedhur në institucion nga prof. dr. Ilirjan Mandro, si Rector i Akademisë së Sigurisë.

⁶³ Dosjet e depozituara në dy kopje: në ASCAL dhe në Akademinë e Sigurisë.

⁶⁴ Vendim i Bordit të Akreditimit, nr. 7, datë 27.1.2023, për “Akademinë e Sigurisë”.

⁶⁵ Akademia e Sigurisë brenda gjashtë muajve nga dalja vendimit të Akreditimit, të hartojë një plan veprimi konkret për përmbushjen e këtyre rekomandimeve i cili dorëzohet pranë Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, si institucion përgjegjës për ndjekjen e përmbushjes së këtyre rekomandimeve dhe raportimin në Bordin e Akreditimit brenda afatit të përcaktuar në “Planin e veprimit” të IAL-së së arsimimit policor shqiptar.

Vlerësimi nga stafi Akademik për pesë fushat e akreditimit:

Për fushën e parë: “Akademia e Sigurisë e ka të garantuar me ligj autonominë e funksionimit të saj si IAL”, garantohet nëpërmjet 11 standardeve.

Për fushën e dytë: “Burimet dhe partneriteti”, garantohet nëpërmjet realizimit të 22 standardeve.

Për fushën e tretë: “Programet e studimit, mësimdhënia dhe vlerësimi”, garantohet nëpërmjet 21 standardeve.

Për fushën e katërt: “Aktiviteti shkencor dhe inovacioni”, garantohet nëpërmjet 17 standardeve.

Për fushën e pestë: “Studentët dhe mbështetja e tyre”, garantohet nëpërmjet 9 standardeve.

Në përfundim në plan të përgjithshëm Akademia e Sigurisë, plotëson në total tetëdhjetë standarde.

Me përmbushjen e rekomandimeve Akademia përmbush sfidën me vetveten dhe sfidën e një cilësie të garantuar brenda dimensioneve të veprimtarisë së ligjit nr. 80/2015, datë 17.9.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.

Akademia e Sigurisë në kuadrin e detyrimeve institucionale të lëna nga Bordi i Akreditimit është angazhuar për të garantuar një mjedis pune të sigurt në të cilin të zhvillohet veprimtaria mësimore dhe kërkimore shkencore bazuar plotësisht në respektimin e LAL, me politika të qarta për mësimdhënien bashkëkohore si dhe në mbledhjen e materialeve, ruajtjen e të dhënave dhe rezultateve të veprimtarisë kërkimore.

Synimi është vijimi i bashkëpunimit dhe transparencës për ta ngritur arsimimin policor shqiptar në nivele elitare, rritjen e kapaciteteve të mësimdhënies profesionale të stafit akademik, ngritjen e aftësive individuale dhe përmirësimi i vazhdueshëm i kapaciteteve mësimdhënëse të personelit akademik në njësitë kryesore të Akademisë.

Sfida e ardhshme e AS-së është akreditimi i programeve, në njësitë kryesore të saj. Akademia e Sigurisë Shqiptare hyri në procesin e akreditimit, me koshiençë dhe me vullnetin e saj të lirë për të parë vlerat dhe kapacitetet e saj për t’ju përgjigjur vizionit dhe qëllimit të saj për një qasje moderne dhe konceptim bashkëkohor të arsimit, trajnimit dhe kualifikimit policor dhe zhvillimin profesional të qëndrueshëm në fushën e policimit dhe sigurisë publike. Ky është thelbi i akreditimit, certifikimit dhe standardizimit të institucionit “Akademia e Sigurisë”.

Kryerja e një vetëvlerësimi institucional dhe vlerësimit nga ekspertët jashtë institucionit të veprimtarisë së akademisë, si i vetmi institucion i lartë mësimor, kërkimor e shkencor që ka për mision formimin, përgatitjen dhe kualifikimin e specialistëve të policisë për të gjitha rolet e funksioneve në Policinë e Shtetit si dhe zhvillimin e veprimtarisë kërkimore shkencore në fushën e policimit⁶⁶ konsiston në zhvillimin e kësaj shkolle drejt standardeve të arsimit të lartë dhe sigurimit të një cilësie të këtij arsimit.

Vëzhgimi i ekspertëve dhe ekspertiza e bërë prej tyre për zhvillimin e Akademisë së

⁶⁶ “Raport i vlerësimit të Akademisë së Policisë “Arben Zylyftari”, nga grupi i ekspertëve të jashtëm të AAAL datë 20.6.2005, faqe 2.

Sigurisë, arriti në dhënien e disa rezultateve sipas tabelës më poshtë:

FUSHAT	STANDARDI SHTETËROR I CILËSISË
1. Institucioni i arsimit të lartë menaxhimi, autonomia dhe sigurimi i cilësisë	Përbushen Plotësisht
2. Burimet dhe partneriteti	Përbushen Kryesisht
3. Programet e studimit, mësimdhënia/vlerësimi	Përbushen Plotësisht
4. Aktiviteti shkencor /artistik dhe inovacioni	Përbushen Kryesisht
5. Studentët dhe mbështetja e tyre	Përbushen Plotësisht

Këto detyra⁶⁷ të lëna nga Bordi i Akreditimit Institucional, janë konkrete, të prekshme dhe të realizueshme, me vullnet dhe përkushtim.

⁶⁷ Vendimi nr.7, datë 27.1.2023 për “Akreditimin për herë të parë të institucionit të arsimit të lartë, Akademia e Sigurisë” .



AKADEMIA E SIGURISË

RAPORTI I VETËVLERËSIMIT PËR AKREDITIMIN INSTITUCIONAL

GRUPI I VETËVLERËSIMIT

- | | | |
|----|------------------------------|-------------------|
| 1. | Prof. Asc. Dr. Qetsor Orhan, | Kryetar |
| 2. | Prof. Asc. Dr. Zaho Golemi, | Anëtar |
| 3. | Dr. Albert Hitoaliaj, | Anëtar |
| 4. | Dr. Fjorida Ballauri, | Anëtar |
| 5. | MSc Kostandin Naço, | Anëtar |
| 6. | Kadife Muça, | Anëtar (Studente) |
| 7. | Besmir Rexha, | Anëtar (Student) |

25. 7. 2022

Lista e shkurttimeve

AS	<i>Akademia e Sigurisë</i>
PSH	<i>Policia e Shtetit</i>
FSH	<i>Fakulteti i Sigurisë dhe Hetimit</i>
KLFP	<i>Kolegji i Lartë i Formimit Policor</i>
QKSH	<i>Qendra e Kërkimeve Shkencore</i>
IAL	<i>Institucion i Arsimit të Lartë</i>
MASR	<i>Ministria e Arsimit Sporteve dhe Rinisë</i>
NJSBC	<i>Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë</i>
VKM	<i>Vendim i Këshillit të Ministrave</i>
GVB	<i>Grupi i Vlerësimit të Brendshëm</i>
RVB	<i>Raport i Vlerësimit të Brendshëm</i>
BE	<i>Bashkimi Evropian</i>

**1. Raporti i Vetëvlerësimit të Brendshëm (RVB)
të Akademisë së Sigurisë**

2. Çfarë është vetëvlerësimi

- a) Realizimi
- b) Përmbajtja
- c) Qëllimi
- d) Vetëvlerësimi në Akademinë e Sigurisë

3. Historiku i akademisë së sigurisë

**4. Vetëvlerësimi kundrejt fushave të vetëvlerësimit
për akreditim institucional**

- 1) Institucioni i arsimit të lartë menaxhimi, autonomia dhe sigurimi i cilësisë
- 2) Burimet dhe partneriteti
- 3) Programet e studimit, mësimdhënia dhe vlerësimi
- 4) Aktiviteti shkencor /artistik dhe inovacioni
- 5) Studentët dhe mbështetja e tyre

5. Përfundime dhe vlerësimi i përgjithshëm

6. Lista e evidencave mbështetëse të AS-së

1. Hyrje në procesin e vetëvlerësimit

Raporti i Vetëvlerësimit të Brendshëm (RVB) të Akademisë së Sigurisë është realizuar në përputhje me ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH”, VKM nr. 824, dt. 24.12.2021, për miratimin e “Kodit të cilësisë së arsimit të lartë”, VKM nr. 109, datë 15.2.2017, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në Arsimin e Lartë” si dhe Manualin e ASKAL për “Procedurat dhe afatet për vlerësimin e cilësisë në kuadër të akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë”.

Raporti është hartuar nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm (GVB) me urdhër të rektorit të Akademinë së Sigurisë nr. 112, datë 24.3.2022 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm për akreditimin institucional të Akademisë së Sigurisë”, i ndryshuar me urdhër nr. 112/2, datë 20.6.2022

Në përzgjedhjen e anëtarëve të Grupit të Vlerësimit të Brendshëm janë marrë parasysht kritere si: kompetenca profesionale, paanshmëria e anëtarëve, mundësitë e komunikimit dhe të mbledhjes së informacionit, përfaqësimi në grup i njësive përbërëse dhe studentëve, kujtesa historike etj.

Strukturat të cilat kanë bashkëpunuar me GVB-në janë Fakulteti i Sigurisë dhe Hetimit (FSH), Kolegji Profesional i Formimit Policor (KPFP), Qendra e Kërkimeve Shkencore (QKSH), Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) si dhe komisionet institucionale për mbrojtjen e studentëve.

Raporti krijon një përmbledhje të të dhënave të institucionit duke u bazuar në fushat kryesore të cilësisë, jep kontribut në mjetet dhe mënyrën se si menaxhohet ruajtja dhe zhvillimi i cilësisë, mbledh evidencat me anë të së cilave vlerësohet cilësia

dhe mundëson analizimin e nevojave dhe vendosjen e synimeve për zhvillimin e cilësisë.

Në Akademinë e Sigurisë, sigurimi i cilësisë është një prioritet. Ne jemi të vetëdijshëm se është pikërisht sigurimi i cilësisë në mësimdhënie e mësimnxënie, në organizim strukturor të menaxhimit akademik e financiar të institucionit, në veprimtaritë e stafit akademik e administrativ, duke vënë në qendër gjithmonë studentët, është ajo që ka bërë që institucioni ynë të vlerësohet si brenda vendit ashtu dhe nga institucionet homologe jashtë vendit.

RVB-ja shërben njëkohësisht edhe për të rikonceptuar strategjinë, objektivat, vizionin dhe misionin e AS-së, me synimin për të ngritur në një nivel akoma më të lartë shkallën e performancës dhe efektivitetin e punës për të garantuar vazhdimësinë e sigurimit të cilësisë.

GVB në hartimin e raportit ka pasur si qëllim të përshkruajë dhe evidentojë përmbushjen e standardeve të cilësisë, referuar dhe përmbushjes së rekomandimeve të ekspertëve të MARS-it. Raporti është organizuar sipas fushave të vlerësimit si më poshtë:

- institucioni i arsimit të lartë, menaxhimi, autonomia dhe sigurimi i cilësisë;
- burimet dhe partneriteti;
- programet e studimit, mësimdhënia dhe vlerësimi;
- aktiviteti shkencor/artistik dhe inovacioni;
- studentët dhe mbështetja e tyre.

Pas hartimit Raporti është diskutuar në njësi duke marrë sugjerime të cilat u reflektuan në raportin përfundimtar.

2. Historiku i Akademisë së Sigurisë

Shkolla e policisë filloi të funksionojë më 1.9.1946, në periferi të Tiranës, në Sauk, me mësimdhënës instruktorë që kryesisht vinin nga radhët e formacioneve partizane, në vitin 1951 u hapën kurset profesionale, si për oficerë ashtu edhe për nënoficer policie njëvjeçare të cilët synonin krijimin dhe zhvillimin e përgatitjes profesionale të punonjësve të policisë.

Më 20.01.1954, krijohet për herë të parë “Shkolla e Bashkuar e Ministrisë së Punëve të Brendshme”, shkollë që arsimonte specialistë të plotë në kurse solide për kohën: 1 deri në 2-vjeçare.

Me vendim të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 184 datë 20.12.1971, u vendos krijimi i Shkollës së Lartë 3-vjeçare të Ministrisë Punëve të Brendshme e cila filloi programin e rregullt universitar në shtator 1972.

Shkolla përgatiste specialistë në fushën e sigurimit, të policisë dhe të kufirit. Përveç kësaj, funksiononte dhe sistemi i kurseve gjashtë dhe nëntëmujore. Në vitin 1973 në këtë shkollë u përfshi dhe sistemi me korrespondencë, me kohëzgjatje katërvjeçare. Në vitet 1974-1975 në programet mësimore 61% e zinte përgatitja teorike dhe 39% ajo praktike. Në maj të vitit 1979, studimet në Shkollën e Lartë u zgjatën në tre vjet pa shkëputje nga puna dhe një vit stazh në detyrë policore.

Në vendimin e Këshillit të Mbrojtjes, nr. 2 datë 16.2.1982, “Për ngritjen e mëtejshme të punës mësimore edukative të shkollave ushtarake”, Shkolla e Lartë e MPB-së merr një fizionomi të re, me program të plotë trevjeçar. Kujdes i veçantë i kushtohej forcimit të katedrave si njësi bazë të punës mësimore-shkencore dhe edukative, ngritjes së nivelit shkencor të punës së tyre, kualifikimit të pedagogëve dhe asistent pedagogëve, duke u angazhuar plotësisht në punën studimore e shkencore, si kusht i rëndësishëm për ngritjen

cilësore të procesit mësimor edukativ të shkollave ushtarake dhe të SHL të MPB-së. Ndërkohë, sipas nevojave, hapeshin dhe kurse pasuniversitare specializimi për kuadrot me arsim të lartë.

Në shtator **1984**, Shkolla e Lartë u përfshi në një proces ndryshimi të programeve mësimore, aktivitetit kërkimor shkencor, trupit pedagogjik dhe bazës didaktike. Shkolla filloi të funksionojë me sistem 4-vjeçar me shkëputje nga puna dhe 5-vjeçar me pa shkëputje nga puna.

Me VKM nr. 281, datë **2.6.2000**, Shkolla emërohet “Akademia e Policisë”. Në gusht të vitit 2005, me mbështetje të programit ICITAP dhe PAMECA, filloi procesi i reformimit të sistemit të edukim trajnimit policor shqiptar dhe në shtator **2006** fillon programi i parë për trajnimin bazë policor (Shkollimi Bazë Policor).

Akademia e Sigurisë është një institucion, i pavarur dhe laik i arsimit të lartë licencuar në prill të vitit **2004**, nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës; ajo hapi dyert në vitin akademik **2004-2005**, me kursin e parë të studimeve me rreth njëqind studentë.

Koha kërkonte krijimin e Akademisë së Sigurisë, konceptimin e saj organizativ, infrastrukturor, me programe ku ndërthurej arsimimi bazë policor me trajnimet, kualifikimet institucionale dhe arsimimi i lartë në të tre ciklet sipas Kartës së Bolonjës. AS-ja e rifilloi aktivitetin e saj si institucion i arsimit të lartë bazuar në VKM nr. 185, datë **25.2.2015**, “Për organizimin dhe funksionimin e Akademisë së Sigurisë”.

Akademisë së Sigurisë, iu dha *Statusi i veçantë* me VKM nr. 881, datë **28.10.2020**, e ndryshuar me VKM nr. 320 datë **2.6.2021** “Për dhënien e statusit të veçantë Akademisë së Sigurisë, si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e rendit dhe sigurisë publike, si dhe organizimi e funksionimi i saj”.

Në strukturën e saj, Akademia e Sigurisë përmban dy njësi kryesore: Fakultetin e Sigurisë dhe Hetimit, dhe Kolegjin e Lartë Policor. Në përbërje të saj është edhe Qendra Kërkimore Shkencore si dhe disa njësi të tjera bazë.

Gjithashtu nga QKSH-ja janë realizuar mbi 12 projekte kërkimore shkencore, 6 konferenca shkencore ndërkombëtare e dy kombëtare si dhe janë publikuar 24 vëllime të revistës shkencore “Policimi dhe siguria”.

Akademia e Sigurisë në 50 vjet (**1971-2021**) ka diplomuar/certifikuar 5283 oficerë nga të cilët 4770 meshkuj (90.298%) dhe 513 femra (9.710%); ndërsa në Kolegjin e Lartë i Formimit Policor ka certifikuar 10655 kursantë që kanë shërbyer e shërbejnë në të gjitha nivelet e Policisë së Shtetit.

Vizioni dhe misioni

Pavarësisht vështirësive, Akademia e Sigurisë po punon fort për përmbushjen e misionit dhe të vizionit të saj. Veprimtaria e saj në fushën e edukimit dhe kërkimit shkencor është vlerësuar në vazhdimësi nga publiku dhe autoritetet më të larta të ekzekutivit e legjislativit.

Misioni: Misioni kryesor i Akademisë së Sigurisë është zhvillimi dhe transmetimi i dijeve me anën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, në fushën e rendit dhe sigurisë për përmirësimin e vazhdueshëm të kapaciteteve të Policisë së Shtetit dhe të strukturave të tjera ligj zbatuese.

Vizioni: Akademia e Sigurisë ka për vizion një qasje moderne dhe një konceptim bashkëkohor të arsimimit, trajnimit dhe kualifikimit policor, për një arsimim dhe zhvillim profesional të qëndrueshëm në fushën e policimit dhe sigurisë publike.

Vetëvlerësimi përkundrejt fushave të vlerësimit për Akreditimin Institucional *

Në momentin e paraqitjes së raportit të vetëvlerësimit të IAL-së, lutemi referojuni Fushave të Vlerësimit për Akreditimin institucional dhe të gjithë standardeve të parashikuara në VKM nr. 824, dt. 24.12.2021, për miratimin e “Kodit të cilësisë së arsimit të lartë”.

Shtjellimi përkundrejt çdo standardi do të ndihmojë GVB të vlerësojë se në çfarë shkalle IAL-ja i përmbush standardet. Grupi i vlerësimit të brendshëm duhet të paraqesë tekst përshkrues sesi IAL i përmbush standardet, me referencë në evidencat përkatëse. Vlerësimi duhet të mbështetet me fakte dhe evidenca si dhe i shoqëruar me dokumentacionin e përkthyer në anglisht, sipas listës së paraqitur në Shtojcën 6.

Në fund të tekstit, për çdo fushë vlerësimi, GVB duhet të konkludojë, duke cituar vlerësimin përkatës, se në çfarë shkalle IAL-ja i përmbush standardet për atë fushë, duke deklaruar nëse standardet përmbushen plotësisht, kryesisht, pjesërisht ose nuk përmbushen. Udhëzimet e mëtejshme mbi gjykimin përkundjet fushave të vlerësimit, gjenden në Shtojcën 11.

Bazuar në gjykimet për çdo fushë vlerësimi, GVB do të konkludojë/arrijë në gjykimin e përmblendhur të vetëvlerësimit, duke identifikuar dhe parashikuar masat që do të ndërmerren nga IAL-ja për përmirësimin në vijim. Më tepër detaje për gjykimin e përmblendhur gjenden në Shtojcën 6.

Aty ku parashikohet dokumentacion mbështetës, duhet të referohet në tekst dhe/ose të lidhet me adresën përkatëse web. Të gjitha dokumentet mbështetëse të referuara dhe/ose lidhura me adresën web duhet të paraqiten si pjesë e dokumentacionit të vetëvlerësimit.

* Udhëzimet e ASCAL-it për formulimin dhe formatin e raportit të grupeve të vlerësimit të brendshëm të IAL-ve

I – INSTITUCIONI I ARSIMIT TË LARTË, MENAXHIMI, AUTONOMIA DHE SIGURIMI I CILËSISË

Standardi I.1 Institucioni dhe strukturat e tij funksionojnë në përputhje me statutin e institucionit.

AS-ja ka hartuar statutin në përputhje me ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar, dhe në përshtatje me misionin dhe objektivat që ka Policia e Shtetit për arsimimin policor e kërkimin shkencor [Evidenca 1.1]. AS-ja ka të hartuar një rregullore të brendshme, “Rregulloren e brendshme të AS-së”, për cilën është diskutuar në njësitë bazë dhe më pas është miratuar me vendim senati [Evidenca 1.2, 1.3]. AS-ja ka ndjekur një proces vijues përshtatjeje dhe përmirësimi në mënyrë të vazhdueshme, të statudit dhe të rregullores së saj. Këto ndryshime kanë ardhur si rezultat përshtatjes me ristrukturimet, ndryshimet e ndryshme ligjore dhe nevojave akademike të AS-së [Evidenca 1.4, 1.5, 1.6]. AS-ja ka të përcaktuar shprehimisht dhe qartë në statutin dhe në strategjinë e saj zhvillimore misionin, vizionin si dhe përgjegjësitë institucionale në të cilat mbështetet. Misioni është përdorur gjatë gjithë kohës si udhërrëfyes në drejtim të zhvillimit akademik, në drejtim të shpërndarjes e përdorimit të burimeve, si dhe për vendimmarrjen e politikave të zhvillimit [Evidenca, 1.7, Evidenca 1.1, neni 5].

Standardi I.2 Institucioni organizohet në mënyrë të tillë që të sigurojë eficiencë në menaxhim.

Organet drejtuese ushtrojnë efektivisht menaxhimin e AS-së. Organi më i lartë drejtues i Akademisë së Sigurisë është Senati Akademik, ndërsa organi më i lartë drejtues administrativ është Bordi i Administrimit. Bordi i Administrimit përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë të punësuar me kohë të pjesshme 4 (katër) anëtarë janë të emëruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, [Evidencë 1.,8, neni 6, Evidencë 1.9] ndërsa 3 (tre) anëtarë janë të zgjedhur nga personeli akademik i AS-së të emëruar nga Senati Akademik i AS-së për një mandat 5-vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje [Evidencë 1.10]. Bordi i Administrimit të AS-së ka të miratuar rregulloren e tij të funksionimit [Evidencë 1.11]. Në përmbushje të funksioneve të tij BA ka miratuar mënyrat e zgjedhjes së administratorit të AS-së, zgjedhje e cila është bërë me procedurë publike konkurrimi. Bordi i Administrimit ka zgjedhur dhe emëruar administratorin e AS-së, sipas vendimit të senatit për miratimin e listës së kandidatëve të cilët plotësojnë kriteret [Evidencë 1.12, Evidenca 1.13].

Senati akademik është organi më i lartë drejtues akademik në AS. Ai siguron përmbushjen e misionit të institucionit dhe funksionon si organ kolegjal vendimmarrës. Senati i AS-së miraton veprimtarinë akademike dhe kërkimore-shkencore vjetore të institucionit [Evidencë 1.14]. BA miraton veprimtarinë ekonomike vjetore të AS-së. Të dyja këto struktura miratojnë raportin vjetor të veprimtarisë së AS-së. Procedura e miratimit të projektbuxhetit dhe të buxhetit të AS-së i nënshtrohet fillimisht diskutimit në senat dhe më pas i dërgohet për miratim Bordit të Administrimit; ky i fundit miraton

buxhetin vjetor dhe atë afatmesëm të institucionit dhe mbikëqyr zbatimin e tyre.[Evidencë 1.8, neni 7].

Rektorati i AS-së në mbështetje të vizionit e misionit institucional, nxit promovimin e personelit akademik të AS-së: organizon konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, në bashkëpunim me universitete të njohura ku punimet janë pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe janë botuar në “Proceedings” me numër ISBN-je; promovimi i anëtarëve të stafit akademik, nëpërmjet mbështetjes financiare në aktivitete të ndryshme shkencore [Evidencë 1.15]. Këshilli i etikës trajton çështjet e etikës së aktivitetit të AS-së, si një institucion i arsimit të lartë. Ky këshill funksionon mbi bazën e rregullores së tij, e cila është e miratuar në senat [Evidencë 1.16]. Dekanati i Fakultetit të Sigurisë dhe Hetimit (FSH) të AS-së është organ kolegjal vendimmarrës, që programon e përcakton, në bazë të propozimeve të departamenteve, planin vjetor të veprimtarisë akademike të njësish kryesore. Dekanati i FSH-së funksionin i bazuar në “Rregulloren e FSH-së”, që është e miratuar nga senati [Evidencë 1.17].

AS-ja në funksion të zhvillimit të aktivitetit të saj si një IAL, ka ngritur komisione të përhershme si organe kolegiale, si p.sh. Këshilli i Etikës, Komisioni i Kontrollit të Cilësisë, i cili funksionon sipas fushës specifike në statutin e AS-së etj. [Evidencë 1.18]. Dekani është autoriteti drejtues i FSH-së dhe përfaqësuesi ligjor i tij. Ai zgjidhet me votim të fshehtë dhe pas votimit emërohet nga instancat përkatëse [Evidencë 1.19]. Përgjegjësi i departamentit/qendrës së kërkimit shkencor zgjidhet me votim të fshehtë nga i gjithë personeli akademik respektiv [Evidencë 1.19, po aty]. Në statutin e AS-së dhe në rregulloren e saj, përcaktohet organizimi i brendshëm dhe mënyrat e funksionimit institucional si IAL [Evidencë 1.1, kreu 2].

Standardi 1.3 Institucioni harton një strategji zhvillimi.

AS-ja ka një strategji zhvillimore të ndërtuar sipas një procesi këshillimor me komunitetin akademik të institucionit, me strukturat më të larta policore dhe të sigurisë publike në vend, me agjenci të ndryshme ligjzbatuese që kanë interesa të përbashkëta në fushën e arsimit e të kërkimit shkencor për sigurinë publike, si dhe me këshillimin e ekspertëve nga IAL-të policore e civile të BE-së [Evidencë 1.20]. “Strategjia zhvillimore e AS-së” ka qëllime dhe objektiva që përputhen me buxhetin dhe programin buxhetor të institucionit. Në planin afatmesëm, nëse është e nevojshme, mundësohen edhe rishikimet përkatëse që lidhen me: burimet e nevojshme financiare për zhvillimin e aktiviteteve; afatet kohore për realizimin e secilit objektivi; aktivitetet konkrete për realizimin e objektivave, etj. [Evidencë 1.21].

Zbatimi i strategjisë zhvillimore arrihet përmes realizimit të objektivave strategjike, objektivave specifike dhe aktiviteteve të parashikuara në “Planin e veprimit” dhe monitorohet në një kuadër afatmesëm, duke përfshirë dhe vlerësimin e rezultateve. Monitorimi dhe vlerësimi i realizimit të objektivave dhe përmbushjes së aktiviteteve përkatëse të kësaj strategjie shërben për të ndjekur ecurinë e saj, dhe për të matur realizimin e objektivave. Procesi i zbatimit të strategjisë zhvillimore monitorohet e vlerësohet çdo vit nga Bordi i Administrimit të AS-së [Evidencë 1.8, neni 7, pika b].

Standardi 1.4 Institucioni respekton kufijtë e autonomisë së tij.

AS-ja i ka kushtuar një rëndësi të veçantë përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë

dhe të formimit të kulturës së cilësisë në institucion [Evidencë 1.22]. Për këtë qëllim, ka instaluar struktura të mbikëqyrjes dhe vlerësimit të brendshëm; në AS është ngritur struktura e cilësisë: Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Kjo njësi është ngritur që në vitin 2017 me vendim të Senatit Akademik [Evidencë 1.18], sipas udhëzimeve të APAAL dhe Standardeve Shtetërore të Cilësisë në Arsimin e Lartë dhe ajo është përgjegjëse për të gjitha çështjet e lidhura me cilësinë e brendshme të cilat kanë si qëllim përmirësimin dhe ruajtjen në nivel të lartë të shërbimeve akademike e administrative të AS-së.

AS-ja është organizuar në mënyrë të tillë që të përfitojë financime nga programet evropiane dhe me gjerë. Për këtë qëllim, në institucion angazhohet Qendra e Kërkimeve Shkencore në bashkëpunim me strukturat e tjera. Konkretisht, njësitë bazë informohen dhe motivohen për të marrë pjesë në aktivitetet e organizuara në kuadër të projekteve kombëtare e ndërkombëtare, si dhe mbështeten në pjesëmarrjen konkrete në projekte. Gjatë 2 viteve të fundit, AS ka fituar projekte kombëtare ose ndërkombëtare nga BE-ja, dhe është në proces të zbatimit të tyre [Evidencë 1.23]. Institucioni zbaton kodin e etikës dhe të integritetit akademik nëpërmjet të cilit mbron vlerat e lirisë akademike, autonominë institucionale dhe integritetin etik. Në Strategjinë zhvillimore të AS-së, theksohet rëndësia e përmbushjes së misionit, me etikë dhe integritet [Evidencë 1.7, pika 5].

Standardi 1.5 Institucioni favorizon debatin konstruktiv.

Në AS, vendimmarrja në organet kolegjiale bëhet sipas një procedure të caktuar, duke respektuar të drejtën e kujtdo, që është anëtar i këtyre strukturave. Para marrjes së vendimeve, materialet për diskutim në këto organe kolegjiale përgatiten dhe vihen në dispozicion të anëtarëve të tyre [Evidencë 1.24]. Organe të tilla vendimmarrëse të AS-së, si senati, bordi i administrimit ose komisionet e përhershme, mbledhen periodikisht dhe në AS ka një praktikë konkrete të dokumentimit së të dhënave gjatë takimeve përkatëse; procesverbalet e takimeve dhe vendimet përkatëse protokollohen, ruhen dhe arkivohen në AS [Evidencë 1.25]. Duke synuar efikasitetin në zbatimin e vendimeve të organeve kolegjiale, AS-ja e monitoron këtë proces hap pas hapi përmes strukturave institucionale përkatëse [Evidencë 1.26].

Standardi 1.6 Institucioni publikon veprimtarinë kryesore të organeve kolegjiale, raportin vjetor dhe aspekte të tjera të lidhura me transparencën.

AS në përfundim të çdo viti akademik harton raportin vjetor, në përputhje me udhëzimin nr. 5 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dt. 19.2.2018 për “Për caktimin e elementëve përbërës të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të institucioneve të arsimit të lartë”, e miraton në një mbledhje të senatit dhe e dërgon në MASR [Evidencë 1.27, 1.28]. Raporti paraqet interes jo vetëm për MASR-n, e cila verifikon përmbushjen e detyrimeve ligjore, por njëkohësisht edhe për të gjithë studentët dhe personelin akademik, duke u ofruar një panoramë të qartë që i vjen në ndihmë për zhvillimet e ardhshme e më gjerë [Evidencë 1.29].

Me qëllim njohjen dhe transparencën AS-ja i bën publike vendimet e senatit dhe të bordit të administrimit, si dhe projektbuxhetin e institucionit, në njësitë kryesore, njësitë bazë dhe i shpërndan në rrjetin e brendshëm të institucionit [Evidencë 1.30, Evidencë

1.31]. Institucioni publikon të dhëna të detajuara mbi shpenzimet financiare, duke dhënë informacionin e duhur për prokurimet publike [Evidencë 1.32].

Standardi 1.7 Institucioni harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë në programe e studimit që ofron.

AS-ja harton dhe zbaton politika të cilat garantojnë sigurimin e brendshëm të cilësisë. Procedurat e zbatimit të këtyre politikave janë transparente dhe mbështeten në “Rregulloren brendshme të sigurimit të cilësisë” dhe në “Manualin e sigurimit të cilësisë”, të cilat janë të miratuara nga senati. Sigurimi i brendshëm i cilësisë në AS kryhet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi [Evidencë 1.33, Evidencë 1.34].

AS-ja ka të ngritur dhe ka funksionale njësinë e sigurimit të cilësisë. AS-ja e ka të përcaktuar si objektiv kryesor të strategjisë së saj zhvillimore institucionale përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë [Evidencë 1.7, pika 6]. Në këtë proces hartimi, zbatimi dhe monitorimi përfshihen edhe studentë e bashkëpunëtorë dhe ekspertë të brendshëm, të jashtëm, të huaj e vendas [Evidencë 1.35].

Në AS përdoren instrumente të cilat mbështeten në të dhëna konkrete dhe synojnë matjen e sigurimin e cilësisë përmes përdorimit të metodave sasiore e cilësore të analizës [Evidencë 1.36]. Pjesë e sigurimit të jashtëm të cilësisë për AS-në, janë edhe vlerësimet, analizat e takimet me drejtuesit kryesorë të Policisë së Shtetit dhe të agjencive të tjera ligjzbatuese të cilat kanë interesa të përbashkëta në fushën e arsimit, me qëllim promovimin dhe përmirësimin e cilësisë [Evidencë 1.37]. AS-ja, sigurimin e jashtëm të cilësisë synon që ta realizojë përmes procesit të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, për të cilin ka bërë edhe kërkesë institucionale pranë Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) [Evidencë 1.38].

Standardi 1.8 Institucioni monitoron dhe vlerëson në mënyrë të vazhdueshme programet e studimit për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxëniet.

Në përfundim të çdo viti akademik, AS-ja ndjek procedura periodike të përcaktuara qartë, nëpërmjet analizave, raporteve, anketimeve, kërkesave të studentëve, kërkesave të PSH-së dhe agjencive të tjera ligjzbatuese etj., të cilat lidhen me përmirësimin e programeve të studimit që ajo ofron [Evidencë 1.39]. Lidhur me shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e programeve të studimit që zhvillon AS-ja, njësitë bazë kryejnë procesin e përmirësimeve të vazhdueshme të syllabuseve, bazuar në ecurinë dhe kërkesat e nevojat e fushës. Ky proces është i dokumentuar dhe zhvillohet në mënyrë periodike [Evidencë 1.40]. Krahas indikatorëve dhe treguesve që ndodhen në “Manualin e sigurimit të cilësisë”, AS-ja zhvillon analiza e takime periodike në njësitë bazë e ato kryesore, lidhur me vlerësimin e cilësisë [Evidencë 1.41].

Monitorimi i realizimit të programeve si pjesë e objektivave zhvillimore të AS-së që lidhen me formimin dhe nxënien, ka çuar në përmirësimin e tyre të vazhdueshëm. Këto vlerësime dhe ndryshime të dokumentuara u janë bërë të njohura organeve më të larta vendimmarrëse të AS-së dhe të PSH-së; këto ndryshime u janë bërë të njohura edhe instancave përkatëse në MASR [Evidencë 1.42, Evidencë 1.43]. Në mënyrë të vazhdueshme, raportet vjetore të AS-së pasqyrojnë rezultatet e arritura, pritshmërinë dhe sugjerojnë masa dhe orientojnë njësitë drejt trajtimit të mangësive, me qëllim

përmirësimin e cilësisë [Evidencë 1.44].

Standardi I.9 Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës.

Krahas vlerësimeve periodike të kryera nga njësitë kryesore të AS-së, aktualisht jemi në proces të zhvillimit të vetëvlerësimit të brendshëm në kuadër të akreditimit institucional [Evidencë 1.45]. Meqenëse AS-ja është institucion unik në ofrimin e arsimit në fushën e sigurisë publike, procedurat dhe metodologjinë vlerësuese të lidhur me hapjen, zhvillimin, ecurinë, përmirësimin dhe riorganizimin e programeve të studimit si dhe procesin e diplomimit, e mbështet tërësisht të kërkesat dhe nevojat që ka Policia e Shtetit dhe agjencitë e tjera ligjzbatuese, të cilat përfitojnë nga shërbimet arsimuese e trajnuese të AS-së [Evidencë 1.46]. AS-ja në kuadër të vlerësimit, të realizimit e të mbarëvajtjes së cilësisë së programeve të studimit që ka zhvilluar, krahas metodave të përmendura përdor edhe metoda të drejtpërdrejta të vlerësimit të cilësisë. Këto metoda bazohen në të dhëna statistikore dhe në analiza të detajuara [Evidencë 1.47].

Si pjesë plotësuese për përmirësimin e vlerësimit të cilësisë së programeve, AS-ja përdor edhe metoda të tërthorta të cilat lidhen me studentët, stafin akademik, kërkuesit shkencorë, bashkëpunëtorët në projekte, programe e aktivitete të ndryshme shkencore si dhe me partnerë të ndryshëm. Këto metoda mbështeten në instrumente matëse të tillë si, sondazhe, intervista etj. [Evidencë 1.48].

Programet trajnuese dhe arsimuese që ofron AS-ja për palët e tjera dhe institucionet e interesuara përmirësohen në mënyrë të vazhdueshme. Të dhënat e nxjerra nga trajnimet e vazhduara si dhe kërkesat në rritje nga institucionet dhe agjencitë ligjzbatuese të fushës së sigurisë, që përfitojnë shërbime trajnuese e arsimuese nga AS-ja, shërbejnë si mekanizëm i vlerësimit në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm të programeve për to [Evidencë 1.49].

Standardi I.10 Institucioni përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e mara në vijim të tyre.

Politikat dhe procedurat për sigurimin e cilësisë së brendshme që ndjek AS-ja, shohin të gërshetuara përfshirjen e brendshme të njësive me strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, të cilat janë pala kryesore e interesuar për përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit të zhvilluara në AS [Evidencë 1.50].

Në procesin e sigurimit të brendshëm të cilësisë ka angazhim të së gjitha niveleve: njësitë, individët si dhe studentët; nuk mungojnë në këtë proces vlerësues edhe struktura të tjera të Policisë së Shtetit. Për këtë proces merren detyra konkrete nga individët dhe strukturat e angazhuara, si: kryerja e anketimeve, intervistave, analizave etj., të cilat i shërbejnë përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së programeve [Evidencë 1.51].

Njësitë bazë dhe ato kryesore të AS-së janë strukturat me përgjegjësinë më të madhe për realizimin e procesit të vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë së brendshme. Njësitë bazë bëjnë vlerësimet e syllabuseve të cilat janë objekt i ndryshimeve të vazhdueshme vjetore. Ndryshimet bazohen te nevojat profesionale të lidhura risitë e fushës që ndryshojnë vit pas viti. Një rol të rëndësishëm dhe kontribut konkret jep edhe përfshirja e studentëve

në këtë proces ndryshues [Evidencë 1.52].

Një ndihmesë të veçantë vlerësuese, japin strukturat e Policisë së Shtetit që presin studentët e diplomuar, të cilat mbajnë kontakt të vazhdueshëm me AS-në duke sugjeruar edhe ide për përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit. Krahas kësaj, mundet të përmendet si pjesë e këtij procesi vlerësues, edhe praktika që studentët kryejnë në strukturat përkatëse [Evidencë 1.53].

Standardi I.11 Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Në kuadër të transparencës, AS-ja ndjek politika dhe ka hartuar edhe një strategji zhvillimore ku transparenca cilësohet si një prej vlerave kryesore institucionale [Evidencë 1.7]. Programet e studimit janë transparente dhe të publikuara në faqen e internetit të AS-së me qëllim që të vihen në dispozicion të studentëve dhe të palëve të interesuara [Evidencë 1.54]. Vlerësimi i programeve shoqërohet me një plan masash konkret të njësisë kryesore, i cili trajton dhe synon përmirësimin e mangësive dhe dobësive të evidentuara në procesin vlerësues [Evidencë 1.55]. Me qëllim që vlerësimi të jetë sa më efikas, AS-ja përmes njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë monitoron cilësinë e përmirësimit të programeve, bazuar te indikatorët dhe instrumentet e tjera matëse [Evidencë 1.34, pika 8.6].

Si pjesë e objektivave të AS-së është edhe ndërgjegjësimi dhe informimi transparent i ndryshimeve, përmirësimeve dhe rezultateve të programeve të studimit, përmes analizave, takimeve periodike me personelin akademik e studentët [Evidencë 1.56], me qëllim përmirësimin afatgjatë të cilësisë së këtyre programeve; ky përmirësim është edhe një nga objektivat strategjikë të AS-së [Evidencë 1.7, pika 6].

Përfundimi dhe vlerësimi

Akademia e Sigurisë e ka të garantuar me ligj autonominë e funksionimit të saj si IAL, bazuar në kuadrin ligjor të arsimit të lartë, por njëkohësisht edhe te kuadri ligjor i Policisë së Shtetit, si një institucion arsimor me status të veçantë. Mësimdhënia dhe kërkimi shkencor zhvillohen duke në përputhje me të gjitha të drejtat që burojnë nga liria dhe autonomia akademike.

GVB arrin në përfundimin se AS-ja në bazë të statutit të saj, ka ngritur struktura që zbatojnë plotësisht misionin dhe qëllimet për të cilat ky institucion i arsimit të lartë policor është organizuar. Të gjitha strukturat e ngritura i rregullojnë marrëdhëniet e tyre me rregullore përkatëse, të cilat janë miratuar në zbatim të *Statutit të AS-së* dhe në përputhje me legjislacionin e arsimit të lartë. Krahas detyrave individuale që ato realizojnë rezultojnë gjithashtu, se bashkëpunimi mes tyre zhvillohet plotësisht në përmbushje të misionit të AS-së.

E gjithë veprimtaria e AS-së udhëhiqet nga “Strategjia zhvillimore e AS-së”, e cila mishëron misionin dhe vizionin që ka ky institucion arsimor. Kjo strategji është në përputhje edhe me strategjinë e Policisë së Shtetit. Ajo është transparente për të gjithë personelin akademik të AS-së, dhe është formuluar e bazuar edhe në orientimet e këshillimet e ekspertëve të BE-së.

NJSBC, është një pikë kyçe në institucion e cila në përputhje me aktet ligjore në fuqi,

standardet shtetërore të cilësisë si dhe manualin për “Procedurat dhe afatet për vlerësimin e cilësisë në kuadër të akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të studimit” të ASCAL-it, ushtron funksionin e saj duke siguruar të dhëna objektive dhe duke kontribuar në ruajtjen e përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në institucion.

Duke u mbështetur te analiza e bërë dhe te të gjithë evidencat e sjella në këtë raport, GBV-ja arrin në përfundimin se AS-ja i përmbush *plotësisht* standardet e fushës së parë, e cila trajton organizimin, menaxhimin, autonominë dhe sigurimin e cilësisë.

II – BURIMET DHE PARTNERITETI

Standardi II.1 Institucion ndjek një politikë të hapur të punësimit dhe të rekrutimit të burimeve njerëzore.

AS ndjek politika e procedura transparente për punësimin me kohë të plotë të personelit të saj akademik dhe ndihmësakademik. Nevojat institucionale dhe kërkesat për punësim personeli bëhen publike në faqen e internetit të AS-së si dhe shpërndahen me mjete të tjera të informimit publik [Evidencë 2.1]. Në fillim të çdo vitit akademik në senatin e AS-së miratohet me vendim të veçantë lista e personelit akademik të ftuar, të jashtëm e të brendshëm; kjo listë përfshin edhe ekspertë të ndryshëm të fushës së sigurisë publike [Evidencë 2.2]. Në kuadër të transparencës institucionale dhe të procedurave të ndjekura, AS publikon kriteret e punësimit për të gjitha vendet e lira në dispozicion [Evidencë 2.3].

Standardi II.2 Institucion ndjek një politikë integruese të personelit akademik, personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ.

Në përputhje me ligjin nr. 80/2015 dhe akteve të tjera nënligjore të dala për zbatimin e tij, AS-ja kryen aktivitete të ndryshme për promovimin dhe kualifikimin e vazhdueshëm të personelit akademik me kohë të plotë dhe personelit akademik me kohë të pjesshme, të ftuar apo me kontratë. Pjesë e këtyre aktiviteteve kualifikuese janë edhe trajnimet e shumta me partnerë ndërkombëtarë nga vendet e BE-së ose të tjera, si dhe trajnimet përmes programeve të ndryshme ekspertë të huaj [Evidencë 2.4, 2.5]. Strategjia zhvillimore e AS-së dëshmon për politika të hartuara, sh. cilat janë në funksion të përmirësimit të ndërveprimit të brendshëm të strukturave ekzistuese, në funksion të integritetit të personelit në veprimtari të ndryshme institucionale [Evidencë 1.7, pika 6].

Në procesin vendimmarrës që ndjek AS-ja, zbatohen procedura të tilla ku përfshihet marrja gjerësisht e mendimit të personelit akademik, ndihmës ose administrativ, para se të merren vendime përfundimtare institucionale; vendime të tilla si p.sh. miratimi i rregulloreve, Statutit të AS-së, strategjive të ndryshme etj. [Evidencë 2.6].

Politikat institucionale të cilat rrjedhin nga strategjia e AS-së, përparësitë e nevojat strategjike të Policisë së Shtetit që lidhen me arsimimin, si dhe nga dokumente të tjera kryesore mbështetëse, zërthehen në rregullore e plane të cilat garantojnë që në veprimtaritë e ndryshme institucionale të ketë një gjithëpërfshirje të personelit. Kështu, grupet e ndryshme të punës që janë ngritur për hartimin e dokumentacionit bazë apo për qëllime të tjera, janë mbështetur në procedura transparente [Evidencë 2.7].

AS ndjek një ecuri aktiviteteve periodike të cilat synojnë integrimin e personelit të saj në jetën sociale, kulturore dhe në veprimtari të tjera të cilat janë me karakter promovues, si p.sh. promovimet e librave; vizitat e ndryshme të personaliteteve të artit, humorit, shkencës, kinematografisë; aktivitete festive me rastin e festave kombëtare; realizimi i ceremonive festuese e vlerësuese për pjesëtarë të ndryshëm të personelit si dhe ceremonitë në respekt të mbylljes së karrierës kur dikush largohet apo del në pension [Evidencë 2.8].

Standardi II.3 Institucion ndjek një politikë të vlerësimit të aftësive të personelit të tij dhe fokusohet në zhvillimin e mëtejshëm të tyre.

AS-ja vlerëson performancën e personelit të vet, në mënyrë periodike, përmes vlerësimeve vjetore të njësive dhe të administratës, vlerësimeve individuale të personelit akademik e ndihmës prej studentëve si dhe përmes kontrolleve të ndryshme periodike që zhvillohen për të monitoruar proceset akademike [Evidencë 2.9]. Në programin vjetor të AS-së përfshihen edhe trajnimet për personelin akademik, të cilat lidhen më së bashku me zhvillimin. Ato planifikohen në bazë të nevojave dhe prioriteteve që dalin nga analizat periodike të njësive [Evidencë 2.4]. Mbështetur në arritjet që personeli shfaq, AS-ja vlerëson dhe motivon personelin akademik nëpërmjet formave të ndryshme si: certifikata vlerësimi, falënderimi, mirënjohje ose edhe shpërblimeve të tjera me karakter financiar, etj. [Evidencë 2.10]. AS-ja ka një bashkëpunim të gjerë me organizma e institucione të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare në favor të sjelljes së ekspertëve të ndryshëm në kuadër të trajnimeve specifike për studentët dhe personelin, me qëllim rritjen e cilësisë [Evidencë 2.11].

Standardi II.4 Institucion ndjek një politikë të zhvillimit social.

AS-ja zhvillon një program të pasur vjetor me aktivitete sociale, të karakterit kulturor e sportiv. Këto aktivitete shohin të përfshirë të gjithë personelin e saj [Evidencë 2.12].

AS-ja ka organizuar disa aktivitete sociale me pjesëmarrjen vullnetare të studentëve në bashkëpunim dhe me partnerë të tjerë si p.sh. Kryqin e Kuq Shqiptar si dhe aktivitete me organizata të ndryshme në ndihmë të fëmijëve dhe familjarëve të policëve të rënë në krye të detyrës, të fëmijëve jetimë, apo grave edhe të dhunuara, duke inkurajuar dialogun social në mbrojtje të këtyre kategorive sociale [Evidencë 2.13].

AS-ja e shikon të lidhur ngushtë favorizimin e dialogut social, jo vetëm në planin kombëtar, por edhe në atë ndërkombëtar. Kështu, marrëveshjet e bashkëpunimit me akademi, organizata e agjenci të huaja, të fushës së sigurisë publike apo të fushave që kanë lidhje me të, AS-ja i vlerëson si një mjet të domosdoshëm për njohjen e ndërsjellë të kulturave, për zhvillimin shkencor të njohurive dhe për shpërndarjen e tyre [Evidencë 2.14].

Në funksion të zhvillimit të një politike sociale AS e trajton marrëdhënien e punës së çdo anëtarë të stafit/personelit të saj, si një të drejtë sociale, nga e cila burojnë të drejtat e tjera – ato për sigurimin e jetës dhe të shëndetit. Kështu, çdo kontratë pune është e deklaruar pranë organeve shtetërore përkatëse, dhe çdo person i punësuar në AS, përfiton në bazë të ligjit nr. 7703/1993, ndryshuar “Për sigurimet shoqërore në RSH” të drejtat që rrjedhin nga ky ligj, parashikuar shprehimisht në kontratën individuale të punës [Evidencë 2.15].

Akademia e Sigurisë,
institucion
në progres
(Akreditimi
institucional)

Standardi II.5 Institucioni siguron qëndrueshmëri afatgjatë të personelit akademik gjatë periudhës midis dy akreditimeve.

AS-ja si punëdhënës respekton dhe përmbush të gjitha kërkesat dhe detyrimet kontraktuale (financiare, sigurimet shoqërore dhe kodin e punës) për të gjithë personelin. Personeli akademik i AS-së, pas përfundimit të periudhës së provës, punësohet me ose pa afat, në përputhje me të gjitha aktet ligjore në fuqi që normojnë punësimin [Evidencë 2.15, po aty]. Në AS, personeli akademik i angazhuar është i gjithi në përputhje me drejtimin që kanë njësitë. Kjo gjë është një specifikë, pasi AS-ja është institucion unik në ofrimin e programeve të arsimit në fushën e sigurisë publike, duke pasur edhe një status të veçantë mes institucioneve të tjera të arsimit të lartë [Evidencë 2.16].

Meqenëse AS-ja vlerëson si një nga objektivat e saj kryesore strategjike zhvillimin e kapaciteteve profesionale, ajo ka favorizuar, ndërtuar e siguruar raporte brezash moshë-eksperiencë, mes personelit akademik, të cilat kanë garantuar që ajo pjesë e personelit që ka eksperiencë të spikatur në mësimdhënie apo kërkim shkencor, të vijojë aktivitetin edhe pas daljes në pension [Evidencë 2.17]. Në përputhje me kriteret ligjore, AS-ja përmbush dhe siguron raportin student/staf akademik. Këtë gjë e favorizon edhe natyra e veçantë e studimeve që kryhen në të si dhe statusi i veçantë si një institucion i arsimit të lartë; në Fakultetin e Sigurisë dhe Hetimit, raporti është 1 pedagog për 10 studentë [Evidencë 2.18].

Standardi II.6 Institucioni vlerëson dhe mbështet personelin e vet në përmbushjen e detyrimeve vjetore-akademike e administrative.

AS në përputhje me përmbushjen e detyrimeve vjetore që ka personeli akademik, ka miratuar procedura të caktuara të vlerësimit të personelit, mbi bazën e ngarkesës vjetore që miratohet nga njësitë [Evidencë 2.19]. Nëpërmjet njërive kryesore, AS-ja monitoron dhe vlerëson përmbushjen e këtyre detyrimeve, duke përdorur instrumente të tillë ndihmës për matjen si, raportime, analiza, sondazhe të studentëve, etj. [Evidencë 2.20]. Në mënyrë periodike, kryesisht në përfundim të semestrave dhe vitit akademik, njësitë organizojnë kryerjen e analizave që kanë synim gjithëpërfshirjen dhe marrjen e mendimit nga personeli akademik, lidhur me përmbushjen e detyrimeve të tyre. Krahës këtyre analizave përdoren për marrjen e mendimit të tyre, lidhur me këto detyrime, edhe mekanizma të tjerë, si: intervista, takime, pyetësorë etj. Nëpërmjet analizave semestrale që zhvillohen në departamente e njësi kryesore, diskutohet nga personeli pedagogjik në lidhje me ngarkesën [Evidencë 2.21]. AS krijon të gjitha kushtet e nevojshme që i nevojiten personelit akademik në funksion të përmbushjes së detyrimeve të tija akademike; vihen në dispozicion salla, pajisje elektronike, laboratorë, biblioteka, automjete, palestra etj., si dhe krijon kushte për publikimin e veprimtarisë së tyre shkencore në konferenca apo në revistën shkencore të AS-së [Evidencë 2.22].

Standardi II.7 Institucioni disponon dhe menaxhon pasuritë e paluajtshme dhe fokusohet në zhvillimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të tyre.

AS e ushtron veprimtarinë e saj në një hapësirë territoriale dhe në godina të cilat përmbushin standardet dhe kriteret funksionale të kërkuara për një kampus universitar.

Ajo shtrihet në një sipërfaqe prej 8.4 ha , ka 20 godina, ka këtu mjedise si: mensa, biblioteka, hotele e fjetore, godina për mësim, ambiente administrative, palestra, fusha sporti, parkime automjete, laboratorë, poligon, kabinete etj. [Evidencë 2.23]. AS vërteton ligjërisht përmes një dokumentacioni të plotë se infrastruktura ku ajo ushtron aktivitetin e saj është pasuri e paluajtshme e tij [Evidencë 2.24].

Ekziston masterplani (ndërtimi i korpusit të ri të Policisë së Shtetit; ky prek edhe objektet e AS-së) i zhvillimit të institucionit, i cili parashihet një zgjerim me ndërtesa të reja dhe një sistemim përmirësues të territorit të AS-së. Në këtë kuadër do të rikonstruktohen disa objekte, do të bëhen ndërtesa të reja dhe do të shtohen mjedise të cilat do të përmirësojnë cilësinë e jetës akademike dhe të proceseve të zhvillimit të programeve studimore [Evidencë 2.25]. Mirëmbajtja, menaxhimi i infrastrukturës dhe i territorit e mjediseve të AS-së, bëhen të mbështetura në një financim të përcaktuar në mënyrë të detajuar sipas buxhetit vjetor [Evidencë 2.26].

Standardi II.8 Institucioni siguron infrastrukturë të përshtatshme për veprimtarinë akademike-shkencore.

AS ndodhet e pozicionuar në periferi të Tiranës, në Sauk, dhe zhvillon veprimtarinë e vet larg zonave të zhvillimit industrial apo zonave me ndotje mbi normat e lejuara sipas standardeve përkatëse [Evidencë 2.27]. Normativa e sipërfaqes së shfrytëzueshme prej 3.8–4.0 m²/student (minimumi) dhe 7.5–8.0 m²/student (maksimumi), plotësohet në mënyrë të kënaqshme nga AS-ja [Evidencë 2.22]. Ambientet në të cilat zhvillohet veprimtaria mësimdhënëse kanë një lartësi jo më të vogël se 3.0 m (tavan-dysheme), e cila përmbush standardet e kërkuara për një zhvillim sa më normal të kësaj veprimtarie.

Normativat teknike të ndriçimit natyral, sipërfaqja e dritareve e cila mbulon minimalisht (15–20)% të sipërfaqes së dyshemesë, si dhe ndriçimi optimal i studentit, janë standarde të cilat AS-ja i përmbush të gjitha në mënyrë të plotë [Evidencë 2.28].

Godinat ku zhvillohet procesi mësimor si dhe ambientet e akomodimit të studentëve kanë dalje dhe shkallë emergjence [Evidencë 2.29]. Në AS gjendet i instaluar sistemi i mbrojtjes kundra zjarrit dhe sistemi i mbrojtjes kundër shkarkesave atmosferike [Evidencë 2.30]. Sistemi i ajrimit (me ngrohje-ftohje) i godinave të AS-së është funksional dhe modern [Evidencë 2.31]. Krahas këtyre sistemeve AS ka edhe burime alternative për furnizimin me energji elektrike (motogenerator etj.), si edhe rezerva të mjaftueshme të ujit të përdorshëm (depozita uji) [Evidencë 2.32].

Standardi II.9 Institucioni siguron mjedise komode pune - mësimore - laboratorike të përshtatshme për personelin akademik dhe studentët dhe personat me aftësi të kufizuara.

AS është një institucion i arsimit të lartë që diplomon efektivë të cilët janë në shërbim të Policisë së Shtetit. Të gjithë punonjësit e Policisë së Shtetit, kur hyjnë në këtë institucion, kalojnë një sërë testesh fizike dhe kontrole të imta shëndetësore. Është detyrim i përcaktuar me akte ligjore e nënligjore, që çdo individ i cili punon si efektiv i Policisë së Shtetit, të jetë në gjendje shëndetësore shumë të mirë dhe pa kufizime aftësish mendore, psikologjike e fizike. Për këtë arsye në AS nuk ka mjedise të cilat të jenë të përshtatura për personel akademik apo studentë me aftësi të kufizuara [Evidencë 2.33].

Akademia
e Sigurisë,
institucion
në progres
(Akreditimi
institucional)

Standardi II.10 Për programet e studimit të fushave mjekësore, inxhinierike institucioni siguron laboratorë të standardeve të larta profesionale e shkencore.

Programet e studimit të fushës së sigurisë publike kanë një natyrë të veçantë, kështu që AS ka siguruar mjedise jo vetëm të natyrës laboratorike, por edhe të tjerë që janë në përshtatje me praktikën mësimore të studentëve. Kjo infrastrukturë e cila konsiston në disa ambiente si: Poligon, Shtëpi Taktike, STAZ-i (Simulator për qitje, ushtrime etj.) etj., përmbush kriteret e përdorimit, funksionimit e të sigurisë si dhe vlerësohet rregullisht nga ana teknike. Poligoni i AS-së dhe Shtëpia Taktike, në të cilën kryhet përgatitja operacionale e studentëve, plotësojnë kushtet për natyrën e trajnimit që ofrohet dhe aktiviteti i tyre zhvillohet sipas parametrave të larta të sigurisë e të mësimdhënies [Evidencë 2.34].

Ekzistojnë plane të sakta masash dhe procedura standarde për mbrojtjen, sigurinë e personelit e të studentëve që veprojnë në këto mjedise speciale. Veprimtaria mbështet në rregullore e manuale të caktuara që lidhen me përdorimin e armëve dha natyrën operacionale të policisë [Evidencë 2.35]. Personeli akademik që mbikëqyr punën e studentëve në Poligon dhe në Shtëpinë Taktike është i certifikuar, i trajnuar dhe me një përgatitje të veçantë profesionale; ata janë të specializuar e të certifikuar në këtë drejtim, nga ekspertë kombëtare e ndërkombëtarë [Evidencë 2.36].

Standardi II.11 Institucioni siguron mjedise të përshtatshme pushimi, sportive dhe argëtimi për personelin akademik dhe studentët e vet.

AS disponon mjedise të shumta pushimi. Aty gjenden një kafe-bar, dy mensa me kapacitet prej rreth 200 vendesh në të cilat kryhet trajtimi me ushqim i studentëve, i personelit akademik dhe i të gjithë atyre që trajnohen ose që kryejnë programe të ndryshme ditore apo më të gjata [Evidencë 2.37]. Në AS gjenden një sërë mjedisesh të jashtme të cilat shërbejnë për zhvillimin e veprimtarive sportive; ka 2 palestër, infrastrukturë sportive të hapur dhe të mbyllur (fusha futbolli, voleybolli, basketbolli) në dispozicion të personelit akademik dhe të studentëve të saj [Evidencë 2.38].

AS ka mjedise të përshtatshme të cilat përdoren në mbështetje të veprimtarive promovuese-artistike, konferencave, ekspozitave të ndryshme etj. Në AS gjendet një sallë e madhe kinemaje e cila shërben për këto aktivitete, e cila ka një kapacitet 300 vendesh dhe është e pajisur me sistem audio, ndriçim shumë të mirë, sistem ajrimi, ngrohje dhe ftohje. Kjo sallë është në dispozicion të personelit akademik dhe të studentëve për aktivitete të ndryshme [Evidencë 2.39]. AS ofron dhe siguron për personelin akademik dhe për studentët njësi dhe shërbime të ndryshme strehuese që lidhen me transportin, hapësira për parkim, 4 godina që shërbejnë si hotele, fjetore për studentët etj. Në AS gjenden 5 hapësira parkimi të mëdha e të mjaftueshme për personelin e AS-së, për studentët dhe për të gjithë ata që kryejnë aktivitete të tjera në institucion. Kapaciteti strehues i AS-së për fjetje dhe jetesë të studentëve brenda ambienteve, është prej 500 vetash [Evidencë 2.40].

Brenda mjedisëve të AS-së funksionon edhe Qendra Shëndetësore e AS-së, e pajisur me infrastrukturën e duhur mjekësore dhe me një personel mjekësor 5 vetë (mjekë, ndihmësmjekë dhe laborant), e cila ofron shërbim të posaçëm të ndihmës së shpejtë, kryerje analizash, dhe vizitash të ndryshme mjekësore, për personelin akademik dhe studentët. Mjediset e AS-së janë plotësisht në përputhje me standardet e kërkuara

higjenosanitare që duhet të ketë një institucion universitar dhe, AS zotëron *Akt-miratimin higjenosanitar* të lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Shëndetësor i Ministrisë së Shëndetësisë [Evidencë 2.41].

Standardi II.12 Institucioni monitoron në mënyrë të vazhdueshme gjendjen e infrastrukturës fizikë dhe angazhohet në përmirësimin e saj.

Në strukturën e AS-së, ekziston një njësi e veçantë për mbarëvajtjen dhe sigurimin e infrastrukturës mbështetëse. Kjo njësi ka në përbërje specialistë të funksioneve të ndryshme, si; hidraulik, kopshtar, elektrikist, marangoz etj.[Evidencë 2.42]. Çdo vit, AS-ja vlerëson gjendjen e infrastrukturës së saj që ka në shërbim të studentëve dhe të personelit. Ajo e kryen këtë proces vlerësimi përmes analizave të specialistëve të njësisë mbështetëse si dhe nëpërmjet pyetësorëve e sondazheve me studentët dhe personelin e akomoduar në mjediset e saj. AS angazhohet në përmbushjen e pritshmërisë dhe kërkesave të tyre, sipas standardeve që ajo ka deklaruar se përmbush [Evidencë 2.43]. AS siguron mbarëvajtjen shërbimeve dhe të mirëmbajtjes së infrastrukturës edhe me palë të treta, duke lidhur kontrata e marrëveshje bashkëpunimi për ushqimin, pijet e ofruara përmes automateve, heqjen e mbeturinave, kopshtarinë etj.[Evidencë 2.44].

Standardi II.13 Institucioni disponon dokumentacion të plotë të veprimtarisë akademike në letër (hardcopy) dhe në formë elektronike.

Në AS ekzistojnë disa struktura që përgjigjen për ruajtjen e dokumentacionit në letër. Sekretaria qendrore e AS-së, mban korrespondencën me njësitë kryesore dhe eprore si dhe kryen arkivimin e dokumentacionit. Çdo njësi kryesore ka sekretarinë mësimore [Evidencë 2.45, Evidencë 1.14, neni 44-46]. Krahas ruajtjes së dokumentacionit në formë fizike (letër), nga të njëjtat struktura kryhet edhe digjitalizimi i të dhënave dhe ruajtja e dokumentacionit në formë elektronike [Evidencë, po aty].

AS disponon një bazë të dhënash të pasur në lidhje me regjistrimin e studentëve, numrin e matrikullimit etj., në përputhje me aktet nënligjore në fuqi. Në këtë bazë të dhënash gjendet një informacion shumë i hollësishëm e i pasur, i shtrirë në dekada [Evidencë, po aty]. Sekretariatë mësimore zotërojnë të dhëna të përgjithshme për programin, formën, planin e tij mësimor, shoqëruar me kreditet e detyrueshme të studimeve [Evidencë 1.14, neni 44-46]. AS disponon regjistrin bazë të studentëve, në të cilin regjistrohen të dhënat personale të tyre, sipas standardeve të kërkuara [Evidencë 2.45, Evidencë 1.14, neni 44-46].

AS ka një regjistër bazë të studentëve (në formë të shkruar dhe elektronike i cili mbahet në ruajtje të përhershme), me vlerësimet e marra gjatë ndjekjes së programit të studimit, të dhëna për diplomën ose diplomat e marra bashkë me suplementin e diplomës etj.[Evidencë 2.45, Evidencë 1.14, neni 44-46].

Standardi II.14 Institucioni ve në përdorim sisteme të informimit dhe të menaxhimi në nivel institucional.

Në infrastrukturën kompjuterike të AS-së gjenden të instaluar për përdorim programe të ndryshme; aty ka të ngritura sisteme menaxhimi dhe rrjete të brendshme

komunikimi që mundësojnë komunikim në nivel institucional. Njësia e IT-së i përditëson ato në mënyrë të vazhdueshme [Evidencë 2.46]. Sistemet e informacionit të AS-së sigurojnë qasje të dedikuar dhe shërbime për stafin, studentët, partnerët dhe bashkëpunëtorët që kryejnë programe të caktuara arsimim e trajnimi në AS [po aty].

AS është pjesë e rrjetit të PSH-së dhe sistemet e saj të informacionit e të menaxhimit sigurojnë statistika dhe informacione, në kohë reale për veprimtari; sigurojnë statistika për indikatorët dhe treguesit në nivel institucional, si dhe për programet e aktivitetet e ndryshme që u nevojiten këto statistika [po aty]. Në faqen zyrtare të internetit të AS-së publikohen të gjitha të dhënat statistikore për numrin e studentëve sipas programeve, thirrjet e ofertat e ndryshme akademike, struktura dhe ndërtimi e funksionimi i AS-së sipas njësive, si dhe statuti e rregulloret e funksionimit të AS-së dhe njësive kryesore [Evidencë 2.47].

Standardi II.15 Institucioni bashkërendon veprimtaritë në fushën e teknologjisë së informacionit.

Në AS ka një angazhim konkret, të gërshetuar edhe me sistemet e IT të policisë, për përdorimin e gjithanshëm të teknologjisë së informacionit dhe për informatizimin e dokumentacionit, proceseve dhe procedurave në funksion të veprimtarive të tij [Evidencë 2.46]. Në ambientet e AS-ë ka në dispozicion të personelit dhe të studentëve shërbime interneti, dhe laboratorë informatike [Evidencë 2.46, Evidencë 2.48].

AS përdor me efikasitet teknologjinë e informacionit në funksion të edukimit në distancë, trajnimeve etj. Për këtë qëllim janë bërë trajnime të ndryshme, edhe me ekspertë ndërkombëtarë të cilët operojnë me sisteme të avancuara të edukimit në distancë, si Estonia dhe Finlanda [Evidencë 2.49]. Sektori i IT-së së AS-së, si dhe ai i Policisë së Shtetit, trajnon në mënyrë të vazhdueshme personelin e AS-së për shërbimet e teknologjisë së informacionit që ofrohen [Evidencë 2.46].

Standardi II.16 Institucioni harton buxhetin në përputhje me procedurat e përcaktuara dhe transparente.

Shpërndarja e burimeve financiare dhe përdorimi i tyre në AS, bëhet në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe me standardet e programimit buxhetor dhe të menaxhimit financiar. Programimi vjetor buxhetor i AS-së është pjesë e programimit buxhetor të Policisë së Shtetit [Evidencë 2.50]. Struktura e hartimit të buxhetit për AS-në bëhet sipas strukturës së Buxhetit të Shtetit për Policinë e Shtetit, të përcaktuar me udhëzim të ministrit të Financave dhe Ekonomisë për institucionet publike [Evidencë 2.51]. Buxheti vjetor i propozuar i AS-së, është objekt diskutimi në Bordin e Administrimit të AS-së. Mendime për buxhetin japin edhe njësitet kryesore [Evidencë 2.52, Evidencë 1.8].

Niveli i pagesës për ngarkesën suplementare të zhvilluar nga personeli akademik, me kontratë ose i ftuar, bëhet sipas kritereve e standardeve të Policisë Shtetit, kurse për personelin akademik civil, të jashtëm e të brendshëm, pagesa bëhet në përputhje me udhëzim nr. 29, datë 10.9.2018 të ministrit të MASR “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë” [Evidencë 2.53].

Standardi II.17 Institucioni siguron mjetet e nevojshme për të zbatuar politikën financiare.

AS ka në funksionim një sektor finance i cili shërben për menaxhimin financiar të tij dhe për zbatimin e politikës financiare [Evidencë 2.54]. Në mënyrë të përvitshme e periodike në AS analizohen treguesit e monitorimit të zbatimit të politikës financiare [Evidencë 2.55]. Institucioni është transparent në lidhje me shlyerjen e detyrimeve financiare përkundrejt palëve të treta [Evidencë 2.56]. AS përmes përfitimit të mjeteve financiare nga buxheti i shtetit, dëshmon për indikatorë financiarë që tregojnë qëndrueshmëri për të gjithë periudhën e akreditimit [Evidencë 2.57].

Standardi II.18 Institucioni ndjek një politikë të kontrollit buxhetor dhe financiar.

Çdo vit akademik, AS-ja i nënshtrohet auditit financiar të kryer nga strukturat e auditit të Policisë së Shtetit dhe raportet bëhen publike [Evidencë 2.58]. Raportet e auditit të Policisë së Shtetit, për AS-në, shqyrtohen në Bordin e Administrimit [Evidencë 1.8].

Standardi II.19 Institucioni ndjek një strategji të hapur për bashkëpunimin dhe partneritetin në nivel rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar.

AS-ja në strategjinë e saj zhvillimore ka të përcaktuara qartë prioritetet strategjike të politikës së saj të bashkëpunimit [Evidencë 1.7]. Pjesë e objektivave strategjike që gjenden në strategjinë zhvillimore të AS-së si dhe në planin e zbatimit të kësaj strategjie, është edhe përcaktimi i qartë i profilit të lidhur me ndërkombëtarizimin dhe me nivelin e kërkimit që synon të zbatojë [po aty]. Në strategjinë e vet AS-ja, merr parasysh nevojat e PSH dhe të agjencive të tjera ligjzbatuese për hapjen e programeve të reja ose për hartimin e projekteve kërkimore shkencore [po aty]. AS-ja përmes sektorit të bashkëpunimit ndërkombëtar, bashkëpunon me partnerë në kuadër të zbatimit të strategjisë zhvillimore [Evidencë 2.59]. AS-ja organizon dhe kryen marrëveshje bashkëpunimi me institucione homologe të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit [Evidencë 2.60].

Standardi II.20 Institucioni bashkëpunon me institucionet të tjera në mbështetje të veprimtarisë së tij akademike, administrative, kërkimore-shkencore/artistike dhe praktikave profesionale.

AS realizon aktivitete të ndryshme arsimore e kërkimore përmes bashkëpunimit me institucione të tjera arsimore, kërkimore e me interesa në fushën e sigurisë publike, brenda dhe jashtë vendit [po aty]. Duke synuar plotësimin e nevojave që AS-ja ka për realizimin e programeve të studimeve, ajo bashkëpunon me organizma të ndryshme kombëtare e ndërkombëtare, institucione të tjera të arsimit të lartë policor në rajon e më gjerë, ose me universitete, agjenci të ndryshme ligjzbatuese etj. [po aty].

AS bashkëpunon me institute kërkimore shkencore si p.sh Instituti i Policisë

Shkencore, Instituti i Mjekësisë Ligjore, etj., për të mundësuar aftësim praktik të studentëve dhe lidhjen e tyre me fushën profesionale në të cilën do të zhvillojnë aktivitetin e tyre profesional pas diplomimit [Evidencë 2.61].

Nisur nga specifika e trajnimit dhe e arsimit që ka fusha e sigurisë, AS-ja zotëron dhe vë edhe në dispozicion infrastrukturën e saj trajnuese të Poligonit e të Shtëpisë Taktike etj., në bashkëpunim me palë të treta [Evidencë 2.62].

Standardi II.21 Institucioni ndjek politika favorizuese për mobilitetin e personelit akademik dhe të studentëve në nivel ndërkombëtar.

AS dhe personeli i saj akademik merr pjesë në aktivitete ndërkombëtare, prezanton kumtesa në konferenca, kongrese kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe organizon vetë aktivitete ndërkombëtare, si p.sh. konferenca shkencore, simpoziume, etj. AS-ja mbi bazën e kuotave të përcaktuara nga Ministria e Brendshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, u jep të drejt studimi studentëve për ndjekjen e studimeve jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë [Evidencë 2.63]. Gjithashtu, AS-ja ndjek një politikë për integrimin e personelit akademik të ftuar dhe të studiuesve të huaj, e cila është në harmoni me kërkesat dhe nevojat si të institucionit ashtu edhe të tyre. AS-ja mirëpret në kuadër të marrëveshjeve institucionale profesorë të huaj për realizimin e procesit mësimor, kryesisht për programe trajnimesh profesionale [Evidencë 2.64].

Standardi II.22 Institucioni kryen studimin e tregut për realizimin e misionit dhe qëllimit të tij.

Në AS për çdo program studimi të ofruar realizohet analiza e brendshme e nevojave të Policisë së Shtetit. Ky studim realizohet nga grupet e ngritura në nivel institucional, të Policisë së Shtetit e AS-së, dhe synon të evidentojë nevojat që ka policia (dhe institucionet e tjera për të cilat ajo ofron shërbime), për efektivë të diplomuar në ciklet e studimit e trajnimit që ofron AS [Evidencë 2.65]. Vlen të theksohet fakti që në kuadër të nismës së ndërmarrë nga Këshilli i Ministrave për punësimin e studentëve të ekselencës në administratën shtetërore, ka nisur prej tre vjetësh një program i ri i arsimit profesional. Ky program u ofron shansin studentëve të ekselencës që kanë kryer ciklin e pare dhe të dytë të studimeve (fushat: jurisprudencë, ekonomik, teknologji informacioni) që në përfundim të tij, të punësohen në strukturat e Policisë së Shtetit si oficer policie. Deri tani e kanë përfunduar (2019-2022) këtë program dhe janë emëruar në struktura të ndryshme të policisë 135 studentë të ekselencës [Evidencë 2.66].

Përfundimet dhe vlerësimi

Në AS menaxhimi i burimeve njerëzore është në përputhje me legjislacionin në fuqi, jo vetëm të arsimit të lartë, por edhe me bazën ligjore që rregullon rekrutimin dhe punësimin e personelit në Policinë e Shtetit. Ka përpjekje serioze në zbatim të politikave të cilat do të përmirësonin bashkëpunimin ndërmjet personelit akademik, joakademik, me uniformë e civil, në funksion të procesit mësimor. AS vlerëson në mënyrë periodike arritjet e personelit të saj, përmes vënies në dukje të arritjeve në analizat vjetore mësimore e kërkimore-shkencore, si në nivel departamenti, njësie kryesore dhe akademie. Në

AS, favorizohet dialogu, mendimi kritik e konstruktiv në ngritjen e diskutimeve në favor të zgjidhjes së problemeve në strukturat përkatëse.

Shpërndarja e burimeve financiare dhe përdorimi i tyre si një institucion i arsimit të lartë, bëhet në përputhje me standardet e programit buxhetor të Policisë së Shtetit. Dokumentacioni i lidhur me të dhënat financiare është i rregullt dhe dëshmohet edhe nga rezultatet e kontroleve periodike të cilave u është nënshtruar AS-ja e që janë dokumentuar me evidenca të bollshme. Përdorimi i burimeve financiare është subjekt i rishikimit dhe i monitorimit të vazhdueshëm. Do të ishte në interes të AS-së, përmirësimi i akteve nënligjore për përdorimin e të ardhurave nga të tretët, në interes të mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor. AS-ja punon për ruajtjen, vlerësimin, zhvillimin dhe mirëmbajtjen e fondit dokumentar dhe arkivor të trashëgimisë së vet akademike, kulturore, shkencore si dhe muzeore, edhe në rrugë elektronike, si një pasuri që duhet të trashëgohet. Institucioni ofron një infrastrukturë moderne dhe bashkëkohore në funksion të programeve të studimit që ofron. Në AS gjenden një numër i madhe sallash leksioni me pajisje moderne, bibliotekë, laboratorë, palestra, mjedise sportive, parkime, mensa, poligone, kabinete, zyra informimi për studentët etj. Ekziston edhe një plan transformimi përmirësues, i cili do të sjellë rritjen e kapaciteteve infrastrukturore të AS-së. Kushtet higjienosanitare, sistemet, gjelbërimi, sipërfaqja m² për student, etj., janë pikë e fortë e AS-së pasi i plotëson të gjitha kriteret e kërkuara në këtë drejtim, duke siguruar edhe materiale e mjete moderne për mësimdhënien.

Për sa i përket të dhënave të studentëve, AS-ja disponon një regjistër me të dhënat personale të tyre, i cili ruhet fizikisht dhe elektronikisht në sekretaritë mësimore të njësive kryesore dhe institucionit.

AS-ja harton dhe zbaton një politikë shumë të zgjeruar bashkëpunimi, duke kryer një sërë marrëveshesh me institucione të ndryshme arsimore, policore e civile, kombëtare e ndërkombëtare si dhe, me organizata të tjera të ndryshme. Bashkëpunimi me akademi të ndryshme arsimore policore evropiane, është një pikë e fortë e AS-së, pasi mundëson shkëmbimin e përvojave më të mira pedagogjike dhe kërkimore. Bazuar te analiza e bërë dhe te evidencat e sjella, GBV-ja arrin në përfundimin se AS-ja i përmbush plotësisht standardet e fushës së dytë, e cila trajton burimet dhe partneritetin.

III – PROGRAMET E STUDIMIT, MËSIMDHËNIA DHE VLERËSIMI

Standardi III.1 Institucioni ofron programe në përputhje me misionin, strategjinë e tij të zhvillimit dhe kërkesat e tregut.

AS-ja ka të përcaktuara qartë programet e studimit, mbi të cilat ka krijuar profilin e vet si institucion unik në Shqipëri për arsimin e lartë në fushën e sigurisë publike [Evidencë 3.1]. AS-ja harton dhe zbaton një politikë të qartë për sigurimin e vazhdimësisë dhe të qëndrueshmërisë së programeve të studimeve të ofruara nga njësitë e tij kryesore, meqenëse kjo akademi është furnizuesja e vetme e policisë me të diplomuar [Evidencë 3.2]. Në hartimin e programeve të studimit që ofron AS-ja, objektivat e çdo programi përputhen me misionin e organizimit të saj si institucion i arsimit të lartë policor [Evidencë 3.3].

Programet e studimeve të ciklit “Bachelor” të ofruar nga AS-ja, janë në përputhje

me komponentët e strategjisë zhvillimore të AS-së [Po aty]. AS në programet e saja të studimit përputhet me politikat Perëndimore dhe linjat e zhvillimit kombëtar e rajonal, të cilat kanë si prioritet sigurinë dhe integrimin euroatlantik [Evidencë 3.4].

Standardi III.2 Programet e studimeve ofrohen në përputhje me objektivat kombëtarë dhe ndërkombëtarë.

Në politikat arsimore që AS-ja ka hartuar merret për bazë zhvillimi i tyre brenda kuadrit të politikave kombëtare, shumëdisiplinëshe dhe të mësuarit në gjuhë të huaj etj. [Evidencë 3.5, Evidencë 3.3]. Për hapjen, rishikimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, AS merr gjithnjë parasysh strategji të caktuara kombëtare si: “Strategjia e sigurisë kombëtare”, “Strategjia ndërsektoriale e sigurisë në komunitet”, “Strategjia kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda”, etj. [Evidencë 3.6, Evidencë 3.4].

Gjatë proceseve të ndryshme të rishikimit, përmirësimit ose hapjes së programeve të reja të studimit, AS-ja bashkëpunon dhe merr në konsideratë edhe programe të ndryshme të avancuara nga institucione të tjera homologe ndërkombëtare [Evidencë 3.7]. Në drejtimin e trajnimeve profesionale nga të cilat studentët përfitojnë aftësim specifik për njohuri të veçanta, ekzistojnë procedura dhe marrëveshje-kuadër të qarta, mbi të cilat ndërtohet bashkëpunimi me institucione të tjera, të huaja ose kombëtare. Në përfundim të këtyre trajnimeve lëshohen dëshmi/certifikata të përbashkëta [Evidencë 2.60, Evidencë 3.8].

Standardi III.3 Programet kanë objektiva të përcaktuar qartë dhe rezultatet e tyre të të nxënit përputhen me nivelin e profilin kualifikimit që ofrojnë.

AS-ja dëshmon përmes programeve të saja se rezultatet e të nxënit përputhen me nivelet e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve [Evidencë 3.9, Evidencë 3.4]. AS-ja ofron programe studimi të cikleve të parë e të dytë të studimit, që i përshtaten profilin të saj si institucion i arsimit të lartë policor [Evidencë 3.4]. Rezultatet e të nxënit të programeve që ofron AS-ja, përputhen me kërkesat që ka Policia e Shtetit dhe agjencitë e tjera ligjzbatuese përfituese [Evidencë 3.10]. Një nga prioritetet e AS-së është hartimi dhe zbatimi i procedurave të qarta dhe transparente në lidhje me matjen dhe vlerësimin e rezultateve të së nxënit në programet e studimit [Evidencë 1.3, Kreu 2; Evidencë 1.17 Kreu 3]. Bazuar te analiza e matjeve të rezultateve të së nxënit, AS-ja e vendos këtë analizë në dispozicion të përmirësimit të kurrikulës dhe të palëve të interesit, duke ndryshuar e përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme programet e studimit [Evidencë 1.49].

Standardi III.4 Institucioni përcakton qartë dhe ndjek procedurat për miratimin e programeve të reja.

Bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, për arsimin e lartë, AS-ja ka hartuar dhe zbaton në mënyrë rigorozë një procedurë të qartë mbi propozimin dhe miratimin e programeve të reja që ajo ndryshon dhe hap [Evidencë 3.11]. Njësia bazë është tërësisht e angazhuar me procesin e hartimit të përmbajtjes, të objektivave, të strukturës dhe të burimeve të programit. Me qëllim hartimin sa më efikas të programeve të reja të studimit, njësitet bazë të AS-së mbanë lidhje të vazhdueshme me ato struktura në Policinë

e Shtetit, të cilat janë të profilizuara në drejtimet përkatëse që ka aktiviteti arsimues i këtyre njësive bazë të AS-së [Evidencë 3.12].

Në bashkëpunim me Policinë e Shtetit dhe kapacitetet që zotëron AS-ja, hartohen në mënyrë analitike kriteret e pranimit dhe miratohen kuotat e pranimit të studentëve, duke u bazë tërësisht te nevojat që ka Policia e Shtetit dhe agjencitë e tjera ligjzbatuese [Evidencë 3.13].

Standardi III.5 Programet e studimeve ofrohen në përputhje me kapacitetet e institucionit.

Në bashkëpunim të ngushtë me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, AS-ja ka burime njerëzore të mjaftueshme dhe të kualifikuara për zhvillimin e programeve të studimit [Evidencë 3.14]. Në AS personeli akademik i punësuar me kohë të plotë përbën 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të parë [Evidencë 3.15]. Ngarkesa mësimore e pedagogëve caktohet në përputhje me kërkesat dhe udhëzimet MASR-së: udhëzim nr. 29, dt. 10.9.2018 [Evidencë 3.16, Evidencë 2.19]. Në rekrutimin e personelit akademik të ftuar dhe me kohë të pjesshme, që bën AS-ja, i jepet përparësi personelit akademik me grada e tituj shkencorë, që angazhohet në veprimtari kërkimore-shkencore të cilat lidhen drejtpërdrejt me profilin e programeve të studimit në fushën e sigurisë publike [Evidencë 3.15]. Aktiviteti kërkimor i njësive bazë reflektohet në ecurinë e programeve që ofron AS-ja [Evidencë 3.16].

Standardi III.6 Programet e studimit janë të organizuar në cikle studimi.

Programet e studimit të ofruara nga AS-ja janë në përputhje me ciklet e miratuara në profilin e saj si institucion i arsimit të lartë. Nga tre cikle studimi për të cilat AS-ja ka mundësinë ligjore që t'i zhvillojë, ajo realizon vetëm programe të ciklit të parë dhe të ciklit të dytë [Evidencë 3.17, Evidencë 3.3]. Programet e studimit të AS-së, organizohen në kredite dhe detajohen në plane mësimore sipas elementëve të kërkuar në VKM-në nr. 41, dt. 24.1.2018 i ndryshuar [Evidencë 3.18].

Standardi III.7 Programet e studimeve nga cikli në cikël hartohen me qëllim mirëorientimin dhe përfitim gradual të njohurive nga studentët.

Studimet e kryera në AS, për të gjithë studentët ose efektivistët e PSH-së kalojnë nëpër tre etapa: studimet e formimit bazë në Kolegjin Profesional të Formimit Policor; studimet “Bachelor”, dhe studimet “Master”. Në fazën e parë, studentët orientohen për kërkesat e “Bachelor”-it dhe mundësitë e ecurisë së tyre në karrierë përmes arsimimit. Në fazën e dytë ata këshillohen për kërkesat që duhet të sigurojnë që të vijnë arsimimin në ciklin e dytë të studimeve në AS [Evidencë 3.19]. Ecuria e studentëve për karrierën policore lidhet me kalimin progresiv nga cikli në cikël dhe përcaktohet nga ligji “Për Policinë e Shtetit” [Evidencë 3.20]. Programet e formimit profesional të “Bachelor”-it synojnë përfitim të njohurive gjithëpërfshirëse të specializuara teorike dhe praktike në fushën e sigurisë publike dhe hetimit të krimit. Këto programe synojnë pajisjen e studentëve me një sërë aftësish njohëse dhe praktike që nevojiten për të zgjidhur në mënyrë krijuese probleme të karakterit praktik të profesionit që ushtron një punonjës

policie [Evidencë 3.3].

Programet e studimeve të ciklit të parë pajisin studentët me njohuritë bazë, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme dhe formimin e shprehive të veçanta të fushës së sigurisë publike dhe hetimit të krimit [Evidencë 3.3]. Programet e ciklit të parë japin njohuri të përparura në fushën e sigurisë publike dhe hetimit të krimit me qëllim të kuptuarit kritik të teorive dhe të parimeve akademike që lidhen e gërshetohen me aktivitetin e kësaj fushe [Evidencë 3.3]. Programet e studimeve të ciklit të dytë synojnë formimin e kompetencave të avancuara në fushën e sigurisë publike dhe hetimit të krimit, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse të paparashikueshme në një këtë fushë [Evidencë 3.3].

Programet e studimeve të ciklit të dytë synojnë zgjerimin dhe mbështetjen më të madhe të kërkimi shkencor, dhe për realizimin e tyre institucioni bashkëpunon me aktorë të ndryshëm të fushës së sigurisë publike [Evidencë 3.3]. Programet e studimeve të hartuara nga AS-ja reflektojnë politikat studimore dhe kërkimore që AS-ja i zhvillon në përputhje me nevojat e kërkesat që ka Policia e Shteti dhe agjencitë e tjera ligjzbatuese të fushës së sigurisë publike [Evidencë 3.10]. Të gjitha programet në AS reflektojnë vijueshmëri të studimeve e kërkimeve në fushën e sigurisë publike dhe hetimit të krimit, nga cikli në cikël [Evidencë 3.3].

Standardet III.8 Institucioni ofron programe të të nxëniet gjatë gjithë jetës.

Programet e formimit të vazhduar në AS, miratohen nga AS-ja në bashkëpunim me Policinë e Shtetit, duke u mbështetur në të njëjtën në linjë me nevojat e përparimit në karrierë e të gradimit, të cilat lidhen me arsimimin e lartë policor [Evidencë 3.10]. AS-ja detajon format e zhvillimit të këtyre programeve, në rregullore dhe në plane të miratuara nga dy departamentet e formimit të vazhduar, të FSH-së dhe të KLFP-së në bashkëveprim me drejtoritë përkatëse në Policinë e Shtetit [Evidencë 1.17, neni 22]. Programet e formimit dhe të trajnimit të vazhduar, shqyrtohen dhe përmirësohen në mënyrë periodike vjetore [Evidencë 3.10]. Ndjekja e procedurave të vlerësimit dhe të sigurimit të cilësisë së këtyre programeve, është e përcaktuar në mënyrë të qartë në rregulloret e departamenteve të formimit të vazhduar dhe të njësisë kryesore [Evidencë 3.21].

Standardi III.9 Programet e studimeve mbështeten në profilin kërkimor dhe profesional të njësisë dhe realizohen në bashkëpunimin me aktorë të fushës.

Programet e studimit synojnë zgjerimin e njohurive, thellimin më të plotë në kompetencat drejtuese dhe realizimin e detyrave/projekteve kërkimore shkencore. Programet e studimeve hartohen nga grupe të ngritura në nivel departamenti, në bashkëpunim me drejtoritë respektive të Policisë së Shtetit, të cilat përbëhen nga anëtarë të sigurimit të cilësisë në nivel departamenti, personel akademik me arritje të rëndësishme në fushën e kërkimit shkencor, personel akademik i lidhur ngushtë me fushën e hetimit apo sigurisë publike, apo edhe përfaqësues të agjencive të tjera ligjzbatuese [Evidencë 3.22]. Duke pasur si qëllim përditësimin e kualifikimit shkencor të personelit akademik që do të angazhohet në programet e ciklit të parë, AS-ja kryen vlerësime periodike të stafit të brendshëm e të jashtëm, duke pasur një orientim të përzgjedhjes së personelit me gradat e titujt më të lartë shkencore (gradat policore të larta) [Evidencë 3.15].

AS synon të angazhojë në mësimdhënie në ciklet e studimeve, personel akademik me kohë të pjesshme dhe personel të ftuar, të cilët janë specialistë të fushave përkatëse dhe përfaqësues të agjencive të tjera të sigurisë, si p.sh. në rastin e angazhimit në programe ku pjesë e stafit janë specialistë të angazhuar në Institutin e Policisë Shkencore, etj. [po aty].

Standardi III.10 Programet e studimeve monitorohen në mënyrë periodike.

Procedurat dhe afatet e rishikimit periodik të programeve të studimit në AS, janë të përcaktuara qartë në rregulloret e programeve [Evidencë 3.23]. Në procesin e monitorimit përfshihen edhe drejtoritë përkatëse të Policisë së Shtetit, agjenci të tjera ligjzbatuese të fushës së sigurisë si dhe studentët, ose ekspertë të tjerë të jashtëm nga institucione simotra ndërkombëtare [Evidencë 3.24]. AS përcakton qartë kriteret e vlerësimit të performancës akademike të stafit të saj, duke përfshirë këtu realizimin e saktë të ngarkesës mësimore, etikën e komunikimit, përditësimin periodik të përmbajtjes dhe literaturës së lëndës/modulit, reflektimin e kërkimit shkencor individual në kurrikul, vlerësimin e mendimin e studentëve etj. [Evidencë 3.25, Evidencë 1.17].

Standardi III.11 Programet e studimeve janë objekt i përmirësimit të vazhdueshëm të tyre në funksion të rritjes së cilësisë.

AS-ja përditëson kurrikulën, literaturën dhe shërbimet mbështetëse në përputhje me përditësimin e nevojave dhe kërkesave që ka Policia e Shtetit dhe agjenci të tjera ligjzbatuese të fushës së sigurisë [Evidencë 1.49]. Programet e studimeve në AS përmirësohen në mënyrë të vazhdueshme e periodike, duke marrë për bazë rezultatet e vlerësimit të tyre nga personeli akademik dhe nga studentët [Evidencë 1.51]. Duke u mbështetur në rezultatet e monitorimit janë kryer disa herë ripunime të programeve të ciklit të parë, duke ndryshuar ngarkesën dhe formën e vlerësimit të studentëve, si dhe duke përmirësuar shërbimet mbështetëse në funksion të rezultateve të së nxënit. Këto ndryshime pasqyrohen periodikisht në raportet vjetore të AS-së [Evidencë 1.14].

Standardi III.12 Institucioni ndjek një politikë të qartë për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies.

AS-ja është përgjegjëse për rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe e shpreh këtë synim si një objektiv të strategjisë së saj zhvillimore [Evidencë 1.7]. Promovimi i përmirësimit të vazhdueshëm të mësimdhënies pasqyrohet në programet e njëjësive kryesore [Evidencë 3.26, prioriteti 4]. AS-ja i kushton një vëmendje të veçantë kualifikimit e trajnimit të personelit akademik në fushën e kërkimit shkencor, në bashkëpunim edhe me homologë ndërkombëtarë të kërkimit, për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies [Evidencë 3.27].

Standardi III.13 Programet e studimeve të shpallura zbatohen sipas strukturave të miratuara në nivel institucional dhe kombëtar.

AS-ja ka hartuar, në përputhje me udhëzimet e MASR dhe VKM-të përkatëse të fushës, programe studimi të organizuara në lëndë dhe module të vlerësuara me kredite,

në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) [Evidencë 3.1, Evidencë 3.3]. Programet dhe të gjithë elementët përbërës të strukturës kanë të përcaktuara qartë veprimtaritë formuese sipas kategorive dhe ngarkesës përkatëse [po aty]. AS-ja organizon dhe dokumenton në mënyrë periodike e efikase planin mësimor të programit të studimeve të ciklit “Bachelor”, të cilat i bën publike për transparencë duke i hedhur edhe në faqen e vet të internetit [Evidencë 3.28].

Në AS-ja i jepet rëndësi bashkërendimit të punës së personelit akademik për të siguruar koherencë të përmbajtjes dhe akademia e monitoron këtë proces në mënyrë periodike; ndryshimet dhe përmirësimet e programeve u nënshtrohen diskutimeve periodike dhe miratimit të tyre [Evidencë 3.24]. AS-ja i ka kushtuar një rëndësi të veçantë organizimit të praktikës profesionale, duke i mundësuar studentëve realizimin e saj në mënyrë korrekte, brenda afatit të caktuar në kalendarin akademik, në sajë të bashkëpunimit me strukturat e Policisë së Shtetit [Evidencë 1.53]. Studentët ndiqen në vijimësi nën drejtimin e një pedagogu të përcaktuar nga departamenti përkatës. Institucioni pritës bazuar në politikat e tij cakton një punonjës policie i cili mbikëqyr studentët gjatë orarit të praktikës profesionale [po aty].

AS-ja vë në dispozicion të studentëve literaturën e nevojshme, e cila pasurohet çdo fillim viti akademik me tituj bashkëkohor në syllabusin përkatës [Evidencë 3.29]. Pedagogët orientojnë studentët për shfrytëzimin e literaturës në bibliotekën e AS-së [Evidencë 3.30] si dhe në libraritë “online” [po aty]. Në bibliotekën e AS-së gjenden, në format fizik (letër), titujt e librave kryesorë të literaturës së detyruar në syllabuset e lëndëve [po aty], si dhe tekste e dispensa të përgatitura nga pedagogët në gjuhën shqipe, bazuar në një literaturë të pasur. Çdo fillim viti akademik, në përputhje edhe me rishikimet e syllabuseve, departamentet bëjnë kërkesat e tyre për shtimin e librave në bibliotekë, si në tituj edhe në numër [Evidencë 3.31]. Në ambientet e bibliotekës, vihen në dispozicion të studentëve kompjuterë, duke mundësuar kërkimin në internet dhe qasjen e librarive elektronike në internet [Evidencë 3.30], të këshilluara nga departamenti përkatës.

Standardi III.14 Programet e studimeve mundësojnë aplikimin në praktikë të njohurive dhe aftësive të fituara nga studentët në kurset teorike.

Programet e studimeve të AS-së në fushën e sigurisë publike dhe të hetimit të krimit, organizohen në mënyrë të tillë që të mundësojnë zbatimin në praktikë të aftësive teorike të fituara nga studentët gjatë ciklit studimor [Evidencë 3.1, Evidencë 3.3]. Në programet e ciklit të dytë, “Master Profesional”, parashikohet që studentët të përfshihen dhe të thellohen në veprimtari të karakterit kërkimor-shkencor, bazuar te rregullorja e programit. Ata duhet të jenë në gjendje të realizojnë tema ose teza diplome [Evidencë 3.32]. AS-ja ndjek politika mbështetëse për veprimtari studentore që reflektojnë veprimtari mësimore në funksion të formimit praktik profesional si, punët laboratorike, ushtrimet, detyrat/projektet kërkimore, si dhe praktikatat profesionale në terren [Evidencë 1.53].

Standardi III.15 Programet zhvillohen me qëllim përfshirjen aktive të studentëve në përftimin e kompetencave.

Programet e zhvilluara në AS u japin hapësirë formave të reja të mësimdhënies të

cilat e vendosin studentin në qendër. Këto metoda mësimdhënieje, në përputhje me standardet më të mira evropiane, janë përmirësuar nga stafi i AS-së edhe falë bashkëpunimit me ekspertë të huaj [Evidencë 3.33]. Vitet e fundit ka përpjekje të vazhdueshme për rritjen e kapaciteteve të mësimdhënësve në përputhje me standardet që u përmendën. Stafi pedagogjik në AS është certifikuar përmes trajnimeve e takimeve që ka ofruar Projekti i Binjakëzimit të AS-së me institucione arsimore simotra dhe IAL jopolicore, nga Finlanda dhe Estonia, i ofruar nga BE-ja. Ky projekt synon krahas të tjerave, edhe rritjen e kapaciteteve mësimdhënëse të AS-së; përmendet edhe në Progres-Raportin e BE-së për Shqipërinë, 2021 [po aty].

Monitorimi i vazhdueshëm i efikasitetit të zbatimit të kësaj metodologjie të programit të studimit, kryhet përmes diskutimeve, analizave dhe shkëmbimit të ideve, në takime që zhvillohen në njësitë bazë dhe ato kryesore [Evidencë 3.34]. Krahas këtij monitorimi që u përmend, AS mbledh në mënyrë të vazhdueshme edhe mendimin e studentëve, përmes pyetësorëve për cilësinë e mësimdhënies dhe ndërmerr i bazuar te këto monitorime, procedura që kanë si qëllim përmirësimin e metodës 2021 [Evidencë 3.35].

Standardi III.16 Programet e studimeve synojnë përgatitjen e studentëve për punësim.

Programet e studimeve ofrojnë lëndë dhe module të veçanta me karakter të mirëfilltë profesional dhe njohuri nga fusha e sigurisë publike. Të gjitha programet e studimit të ofruara në AS kanë për qëllim të formojnë specialistë në fushën e sigurisë publike përmes së cilës ata do të kontribuojnë në funksione të ndryshme në Policinë e Shtetit dhe agjencitë ligjzbatuese, për një zhvillim të qëndrueshëm në organizatë [Evidencë 3.1, Evidencë 3.3]. Programet e studimit që ofrohen nga AS-ja përfshijnë njohuri për sigurinë publike, hetimin e krimit dhe praktikë profesionale, të cilat janë të shtrira për gjatë gjithë vitit në programe të caktuara ose të grumbulluara në fund të semestrit, e që zhvillohen pranë institucioneve të përcaktuara nga departamenti [po aty].

Programet e studimit kanë të parashikuar veprimtari mësimore në funksion të formimit praktik profesional si punët laboratorike, ushtrimet, detyrat/projektet kërkimore si dhe praktikat profesionale në terren [po aty]. Praktika profesionale zhvillohet në bashkëpunim me sektorë të ndryshëm të Policisë së Shtetit, në të cilët këta studentë do të punojnë pas diplomimit [Evidencë 1.53]. Rregulloret e programeve të studimit në AS, përcaktojnë qartë profilet dhe mundësitë e punësimit në përfundim të tyre. Studentët profilizohen në drejtim të sigurisë publike dhe të hetimit të krimit [Evidencë 3.23]. AS-ja mbështetet gjerësisht në informacionin e vlerësimet e marra nëpërmjet Alumnit për të përditësuar kurrikulat, me qëllim përshtatjen me nevojat dhe detyrat funksionale që ata do të marrin në Policinë e Shtetit [Evidencë 3.36].

Standardi III.17 Programet e studimeve synojnë të nxisin mobilitetin e studentëve shqiptarë dhe të huaj.

Të gjitha programet e ofruara në AS janë të organizuara në përputhje me procesin e Bolonjës, duke realizuar ndarjen në module me përmbajtje të detajuar dhe vlerësuar me kredite (ECTS). Programet e studimit hartohen dhe rishikohen në mënyrë që të

kenë ngjashmëri me programe brenda dhe jashtë vendit duke bërë të mundur njëkohësisht njohjen dhe transferimin e studimeve. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin përkatës, i cili ofrohet në dy gjuhë (shqip dhe anglisht) [Evidencë 3.1]. AS-ja publikon në faqen e internetit informacion të plotë mbi programet e studimit të ofruara, kurrikulat dhe kriteret e pranimit, në gjuhë shqipe dhe angleze. Gjuha angleze është pjesë e planit mësimor që në vitin e parë në programet “Bachelor” në siguri publike dhe hetim [Evidencë 3.37, Evidencë 3.1]. Studentët kanë mundësi të transferojnë studimet në AS si dhe kreditet e fituara në programe të së njëjtit cikël, në RSH apo jashtë saj, në fusha studimi të njëjta ose të përafërta, në përputhje me rregulloren përkatëse të studimit [Evidencë 1.1, neni 55].

Standarde III.18 Institucionet pajisin studentët që kanë shlyer të gjitha detyrimet e një programi studimi, me diplomën përkatëse, e cila është dokument zyrtar.

Organizimi i provimeve bëhet në përputhje me “Rregulloren e FSH-së” [Evidencë 1.17], “Rregulloren e AS-së” [Evidencë 3.76] dhe rregulloret e programeve të studimeve [Evidenca 1.2, 1.3]. Institucioni informon studentët diplomantë me procedurat e mbrojtjes së diplomës me provim formimi apo me temë diplome, bazuar në përcaktimet e rregulloreve përkatëse të programeve të studimit [Evidencë 3.23]. Studentëve diplomantë, u vihet në dispozicion baza e pyetjeve të provimit të formimit. Studentët që diplomohen me temë diplome, duhet të aplikojnë pranë strukturës përgjegjëse të programit të studimit për zgjedhjen e temës/projektit të diplomës [Evidencë 3.38]. Diplomati që jepen në përfundim të programeve të studimeve të ciklit të parë ose të ciklit të dytë në AS, shoqërohen me shtojcën (suplementin) e diplomës, e cila është në dy gjuhë: shqip dhe anglisht [Evidencë 3.1].

Standardi III.19 Institucioni siguron laboratorë të dedikuar në mbështetje të programeve të studimit dhe kërkimi shkencor/artistik.

AS-ja disponon laboratorë dhe mjedise të mjaftueshme për zbatimin e njohurive që lidhen me profilin e studimeve të fushës së sigurisë publike dhe hetimit të krimit, të tilla si: poligoni, shtëpia taktike, STAZ-i, mjedise të hapura, laboratorë për punën shkencore të Policisë së Shtetit etj. [Evidencë 2.34]. AS-ja përmbush standardet dhe detyrimet që përcaktojnë raportin mes numrit të studentëve dhe vendeve në laborator. Laboratorët dhe mjediset e lartpërmendura përmbushin nevojat sipas numrit të studentëve [Evidencë 2.48]. Në AS ekziston një masterplan i cili synon ngritjen e laboratorëve të rinj me qëllim që të ndihmohet aftësimi profesional dhe zhvillimi i kompetencave të studentëve [Evidencë 2.25].

AS-ja bashkëpunon me Institutin e Policisë Shkencore, të Policisë së Shtetit, i cili e ushtron aktivitetin e tij në të njëjtat hapësira që zotëron AS-ja. Ky bashkëpunim mbështetet në prioritetet e AS-së për forcimin e kërkimit shkencor në fushën e sigurisë publike dhe hetimit të krimit [Evidencë 2.61, Evidencë 3.10].

Standardi III.20 Institucioni siguron pajisje laboratorike, infrastrukturë dhe shërbime në mbështetje të programeve të studimit.

Infrastruktura në mbështetje të programeve përputhet me objektivat dhe rezultatet

e të nxëniet të programeve “Bachelor”. Ajo siguron kushte dhe pajisje të mjaftueshme për studentët [Evidencë 3.34].

Një pjesë e mësimdhënies dhe provimeve zhvillohen duke përdorur infrastrukturën e TIK-ut, laboratorëve, poligoneve, mjediseve të jashtme e të brendshme të forcës dhe aktiviteteve fizike si dhe shërbime të ngjashme që mundësojnë zhvillimin e programeve të studimit në fushën e sigurisë publike dhe hetimit [Evidencë 2.38, Evidencë 2.39].

Për përdorimin efikas të pajisjeve, në AS kryhen trajnime, certifikime, diskutime etj., që lidhen me përditësimin dhe rifreskimin e njohurive në mbështetje të kualifikimit të stafit akademik dhe atij mbështetës. Një pjesë e shtuar e këtyre trajnimeve, janë edhe trajnimet për zhvillimin e mësimin “online” dhe përdorimin e infrastrukturës në këtë drejtim [Evidencë 2.46, Evidencë 2.48, Evidencë 2.49]. Përmes investimit të infrastruktura dhe rritja e kapaciteteve, AS-ja siguron vazhdimësi të funksionimit të këtyre pajisjeve dhe monitoron gjithashtu edhe cilësinë e mësimdhënies që i shfrytëzon këto pajisje e mjedise. Në AS mbetet prioritet përfshirja e studentëve në përdorimin e infrastrukturës që lidhet me profilin e programeve të tyre të studimit [Evidencë 2.25, Evidencë 2.26].

Standardi III.21 Biblioteka, infrastruktura dhe shërbimet e saj sigurojnë akses në literaturë bashkëkohore të lidhur me fushat e studimit dhe kërkimit në programe.

Në fund të çdo viti mësimor, mbledhen mendimet e departamenteve në lidhje me literaturën e re që duhet futur në përdorim. Ky përditësim i vazhdueshëm i literaturës u vihet në dispozicion studentëve të profileve të ndryshme [Evidencë 3.31]. Biblioteka e AS-së me personelin e saj është në shërbim të vazhdueshëm të stafit dhe të studentëve duke ofruar literaturë cilësore të lidhur me profilet e programeve të studimit të AS-së [Evidencë 3.39]. Biblioteka e AS-së dhe shërbimet e saj sigurojnë një shërbim cilësor dhe të shpejtë përmes përdorimit të skedarëve digjitalë të cilët ofrohen për kërkim përmes internetit, duke ndihmuar në aktivitetin kërkimor e profesional në kuadër të programeve të studimit [Evidencë 3.40].

Për blerjen e literaturës së specializuar në fushën e kërkimit shkencor dhe të profileve që lidhen me fushën e studimit, AS-ja parashikon fonde për blerjen e literaturës. Pasurimi i literaturës së bibliotekës së AS-së, bëhet edhe përmes dhurimeve të ndryshme [Evidencë 3.41]. AS-ja vlerëson në mënyrë periodike cilësinë e shërbimit të bibliotekës nëpërmjet marrjes së mendimeve të stafit e të studentëve, lidhur me literaturën dhe cilësinë e shërbimit të ofruar [Evidencë 1.51].

Përfundimet dhe vlerësimi

AS-ja ofron programe studimi e trajnimi të vazhduar, në përputhje me misionin institucional arsimor që ka, për përmbushjen e nevojave të Policisë së Shtetit dhe të agjencive të tjera ligjzbatuese përfituese në këtë drejtim. AS-ja ka në përbërje personel akademik të punësuar me kohë të plotë, i cili shkon deri në rreth 70%. Ky personel mbulon realizimin e programeve të studimeve dhe të trajnimeve të vazhduara.

AS-ja e zhvillon veprimtarinë e saj arsimore në përputhje të plotë me nevojat dhe strategjitë e ndryshme të Policisë së Shtetit e agjencive të tjera kombëtare ligjzbatuese, duke siguruar programe arsimore të cilat janë në përmirësim periodik e të vazhdueshëm.

Kjo akademi, në përputhje edhe me prioritetet kombëtare për thithjen e studentëve ekselentë në institucione, ka hapur një program të veçantë për arsimimin e këtyre studentëve. Përmirësimi i programeve të AS-së bëhet në funksion të rritjes profesionale të specialistëve të fushës së hetimit e të sigurisë, duke marrë në konsideratë edhe mendimin strukturave përgjegjëse të policisë së Shtetit si dhe mendimin e studentëve. Rishikimi i vazhdueshëm i programeve ka ardhur edhe falë bashkëpunimit me institucione arsimore policore të BE-së. Pavarësisht statusit të veçantë që gëzon AS-ja, programet e saj janë në përputhje të plotë me standardet e kërkuara nga MASR-ja. Këto programe janë publikuar edhe elektronikisht në faqen e internetit të AS-së, duke zbatuar kriterin e transparencës e të informimit publik.

AS-ja ofron kapacitete të shumta infrastrukturore dhe mbështetëse, në shërbim të mësimdhënies, të cilat sigurojnë kryerjen e këtij procesi nga personeli akademik. Ky personel trajnohet në mënyrë të vazhdueshme për mësimdhënien, me strukturat e brendshme të njësive kryesore të AS-së si dhe në bashkëpunim me partnerë ndërkombëtarë. Një element i cili duhet përmirësuar, është ai që ka të bëjë me lëvizjet e shpeshta të personelit akademik me uniformë, i cili për arsye të karrierës policore dhe organizimit institucional, herë pas here lëviz dhe zëvendësohet nga personel i ri mësimdhënës. GVB-ja pasi vërejtë gjithë dokumentacionin mbi programet e studimit të ofruara në AS, organizimin dhe zbatimin e tyre në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore, vlerëson se standardet për fushën e tretë, e cila trajton mësimdhënien, mësimnxënien, vlerësimin dhe kompetencat, janë të përmbushura *plotësisht*.

IV- AKTIVITETI SHKENCOR / ARTISTIK DHE INOVACIONI

Standardi IV.1 Institucioni përcakton fushat parësore të aktiviteteve kërkimore, shkencore/artistike.

AS-ja ka të përcaktuara qartë në dokumentet e saja kryesore strategjike (“Strategjia zhvillimore e AS-së” dhe “Strategjia e AS-së për veprimtari kërkimore dhe zhvillimore”) prioritetet e veprimtarisë së saj kërkimore-shkencore, në përputhje me fushën e sigurisë publike, me kapacitetet burimore që ka, me llojin dhe profilin që kërkohet [Evidencë 4.1, Evidencë 1.7, pika 6]. AS-ja i ka të harmonizuara prioritetet e veta strategjike të kërkimit dhe zhvillimit në përputhje me prioritetet afatgjata rajonale, kombëtare e ndërkombëtare. Përcaktimi i prioritetëve mbështetet në dokumentet kryesore strategjike të Policisë së Shtetit, në prioritetet kombëtare të strategjive të ndryshme, në dokumentet strategjike të vetë AS-së si dhe në tematikën e përcaktuar në mënyrë vjetore nga njësitë e saj [Evidencë 4.2].

Çdo fillim viti, njësitë kryesore dhe ato bazë informojnë dekanin dhe rektorin miratojnë prioritetet respektive të tyre në përputhje me prioritetet institucionale për kërkimin shkencor. [Evidencë 4.3]. Në AS kërkimi shkencor dhe zhvillimi bazohet edhe në ide të cilat vijnë nga aktorë të tjerë si Policia e Shtetit, agjenci të tjera ligjzbatuese të fushës së sigurisë, institucione të arsimit të lartë, brenda e jashtë vendit etj. [Evidencë 4.4]. Përcaktimi i prioritetëve dhe i dokumenteve strategjike të kërkimit shkencor në AS, në fushën e sigurisë publike, kryhet nëpërmjet një diskutimi të hapur dhe gjithëpërfshirës me njësitë bazë e njësitë kryesore si dhe, me strukturat e Policisë së Shtetit e me agjenci të tjera ligjzbatuese të fushës së sigurisë [Evidencë 4.1, Evidencë 1.7].

Standardi IV.2 Institucioni zbaton prioritetet e aktivitetit kërkimor shkencor.

Politikat prioritare të hartuara në fushën e kërkimit shkencor të sigurisë publike në AS, zbatohen nga njësitë bazë dhe ato kryesore në mënyrë të vazhdueshme. AS-ja ka mekanizmat dhe mjetet e nevojshme për zbatimin e prioritetëve të përcaktuara në dokumentet e saja strategjike për kërkimin shkencor [Evidencë 4.5]. AS monitoron dhe merr në konsideratë nevojat e shoqërisë, dhe të Policisë së Shtetit apo të agjencive të tjera ligjzbatuese që kryejnë aktivitet në fushën e sigurisë, duke i pasqyruar këto nevoja në planifikimin që ajo bën për veprimtaritë kërkimore shkencore të fushës së sigurisë publike, si: konferenca, simpoziume, takime, projekte kërkimore, botime shkencore etj. [Evidencë 4.2]. AS-ja nxit kërkimin shkencor përmes rekrutimeve të reja të personelit akademik të kualifikuar në kërkim shkencor, në funksion të strategjisë zhvillimore e të kërkimit shkencor të AS-së dhe në përputhje me profilin e sigurisë publike, hetimit të krimit, jurisprudence, etj., që kanë njësitë bazë e ato kryesore [Evidencë 2.1].

Strukturat e njësive bazë janë të organizuara në grupe kërkimore të cilat përputhen me profilin kërkimor të fushës së sigurisë dhe hetimit [Evidencë 4.6]. AS-ja në funksion të zbatimit të prioritetëve kërkimore shkencore, siguron infrastrukturën e duhur që nevojitet për realizimin e projekteve kërkimore, konferencave, botimeve shkencore, përdorimit të instrumenteve kërkimore që lidhen me anketime/intervista/sondazhe, etj. [Evidencë 4.23, Evidencë 2.39].

AS-ja në bashkëpunim me Policinë e Shtetit krijon një sistem efikas mbështetës për kërkimin dhe transferimin e njohurive dhe për aplikimin e teknologjive të reja. Pranë rektoratit, si njësi koordinuese në funksion të procesit kërkimor-shkencor funksionon Qendra e Kërkimeve Shkencore (QKSH) [Evidencë 4.6]. QKSH-ja promovon veprimtarinë kërkimore-shkencore të akademisë, brenda dhe jashtë vendit. Institucioni ka një praktikë të mirë në veprimtarinë kërkimore-botuese, duke botuar të gjithë materialet e konferencave përmes sektorit të botimeve të QKSH-së, i cili ka atributet e shtëpie botuese për marrje ISBN-je [Evidencë 4.7].

Standardi IV.3 Institucioni inkurajon zhvillimin, dinamizmin e veprimtarive kërkimore / artistike dhe shkencore.

AS-ja bashkëpunon me struktura kombëtare dhe ndërkombëtare në kuadër të kërkimit shkencor me qëllim aplikimin dhe zhvillimin e projekteve të përbashkëta. AS mbështet dhe inkurajon stafin akademik dhe departamentet, në drejtim të kërkimit shkencor dhe projekteve, edhe përmes informimit dhe trajnimit [Evidencë 4.8, Evidencë 4.4].

AS-ja mbështet dhe nxit me të gjitha mjetet zbatimin, zhvillimin dhe zgjerimin e fushave prioritare të përcaktuara nga departamentet dhe nga prioritetet institucionale të fushës së sigurisë publike që ka Policia e Shtetit përmes financimeve, zgjerimit dhe forcimit të bashkëpunimeve në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar; përmes rekrutimeve të reja të personelit akademik të kualifikuar në kërkim shkencor, në funksion të strategjisë zhvillimore të AS-së, përmes organizimit të aktiviteteve orientuese mbi programet evropiane të kërkimit shkencor dhe, përmes organizimit të konferencave, mbledhjeve të punës, leksioneve të hapura, trajnimeve shkencore,

Akademia
e Sigurisë,
institucion
në progres
(Akreditimi
institucional)

etj. [Evidencë 4.9, Evidencë 4.10].

Institucioni bashkëpunon me organizma shkencorë kombëtarë e ndërkombëtarë. Vlen për t'u përmendur këtu Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Akademia e Studimeve Albanologjike, AKKSHI, Akademia e Forcave të Armatosura, Akademia e Kosovës për Siguri Publike, Universiteti "Tor Vergata" i Romës, Universiteti i Tiranës, Universiteti UAMD i Durrësit dhe universitete të tjera kombëtare e të huaja; me institucionet akademike homologe të rajonit dhe evropiane si, akademitë e universitetet policore të: Finlandës, Estonisë, Italisë, Turqisë, Austrisë, Gjermanisë etj. [Evidencë 2.60]. AS-ja ka kryer bashkëpunime shkencore edhe me organizata ndërkombëtare të rëndësishme në nivel global si: BE, OSBE, NATO, OBSH etj., si dhe me misione të huaja bashkëpunimi policor si PAMECA, FRONTEX, MAPE, ICITAP, CEPOL etj. [Evidencë 4.10]. AS-ja përmes qendrës së saj të kërkimeve shkencore, harton dhe zbaton politikën e vet të etikës në kërkimin shkencor dhe monitoron zbatimin e saj, duke u mbështetur në dokumentet kryesore mbi të cilat zhvillohet kërkimi shkencor në AS [Evidencë 4.1, Evidencë 4.11].

Standardi IV.4 Institucioni dhe njësitë përgjegjëse për kërkimin shkencor/artistik dhe inovacionin vlerësojnë performancën e tyre në nivel institucional.

AS-ja ka hartuar dhe miratuar mekanizma tregues për vlerësimin e performancës së kërkimit të njërive kryesore, të atyre bazë dhe të grupeve kërkimore e të kërkuesve shkencorë të veçantë. AS-ja zotëron një bazë të dhënash, në QKSH, e cila dokumenton të gjithë aktivitetin shkencor. Bazuar te këto të dhëna të AS-së, sektori i kurrikulave dhe i kontrollit të cilësisë, kryen raportime të vazhdueshme në institucionet përkatëse lidhur me ecurinë e aktivitetit shkencor në AS, që nga niveli institucional deri te ai individual [Evidencë 4.12, Evidencë 2.65]. AS-ja ka të përcaktuar në strategjinë e vet të kërkimit shkencor aktivitete në fushën shkencore të sigurisë publike. Përmes analizave, monitorimeve dhe treguesve sasiorë e cilësorë, AS-ja kryen vlerësimin e arritjeve dhe të performancës së vet në fushën e kërkimit shkencor për çdo vit akademik, dhe i bën ato publike [Evidencë 4.13]. AS-ja vlerëson dhe stimulon ecurinë e studimeve dhe të kërkimeve shkencore të personelit akademik përmes raporteve vjetore nga njësitë bazë [Evidencë 3.16]. Mbi bazën e tyre NJSBC-ja harton raportin vjetor në nivel institucioni [Evidencë 2.65]. Në kuadër të këtij raporti, çdo anëtar i personelit akademik deklaron veprimtarinë kërkimore shkencore si: botime kombëtare apo ndërkombëtare, konferenca dhe projekte të fituara etj. [Evidencë 3.16].

Standardi IV.5 Institucioni garanton pronësinë intelektuale të arritjeve dhe rezultateve në fushën e kërkimit shkencor dhe i përdor ato me qëllim zhvillimin ekonomik dhe financiar të tij.

AS-ja në bashkëpunim me partnerët e ndryshëm, rezultatet e kërkimeve të fundit shkencore që ajo kryen, prirjet dhe gjetjet që dalin nga aktivitetet shkencore (konferenca, projekte etj.), ua vë në dispozicion për zbatim institucioneve të interesuara: Policia e Shtetit, agjencitë ligjzbatuese në fushën e sigurisë si dhe institucione të tjera ndryshme [Evidencë 4.14]

AS-ja ka një praktikë të mirë në veprimtarinë kërkimore-botuese, duke publikuar të gjitha materialet e konferencave, projekteve, kërkimeve etj., përmes sektorit të botimeve të QKSH-së, i cili ka atributet e shtëpie botuese për marrje ISBN-je, si dhe në

revistën e indeksuar me ISSN, "Policimi dhe siguria". Këto publikime shkencore ndjekin një politikë të qartë për mbrojtjen e pronësisë intelektuale, si në versionin fizik edhe në atë elektronik [Evidencë 4.12, Evidencë 4.15]. Arritjet teorike në fushën e kërkimit shkencor, AS-ja ua ofron dhe i vë në dispozicion të palëve të interesuara të fushës së sigurisë publike, pa synuar përfitime financiare. AS-ja bashkëpunon me agjenci dhe organizata vendase e të huaj, duke rritur ndikimin shoqëror të veprimtarive të tij kërkimore-shkencore. [Evidencë 4.10, Evidencë 4.16].

Duke qenë se AS-ja është institucioni i vetëm në Shqipëri që ofron dhe kryen kërkim shkencor në fushën e sigurisë publike, ajo ka ekskluzivitetin e aktiviteteve shkencore të kësaj fushe dhe për këtë arsye, mbështete me një buxhet të përvitshëm të përcaktuar nga PSH-ja, duke mos u varur nga sigurimi i të ardhurave financiare përmes punës kërkimore të saj [Evidencë 2.50, Evidencë 2.55].

Standardi IV.6 Në zbatim të prioriteteve të kërkimit shkencor/artistik, institucioni kanalizon veprimtaritë e kërkimit në nivel departamenti.

Departamenti është njësi bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe të punës kërkimore-shkencore. Departamenti përfshin fusha kërkimi të përafërta dhe grupon disiplinat mësimore respektive [Evidencë 4.17, Evidencë 1.18]. Departamenti është i organizuar në grupe mësimore e kërkimore. Grupet mësimore e kërkimore janë të përhershme, por ato mund të jenë edhe të përkohshme. Grupi mund të jetë edhe vetëm kërkimor [Evidencë 4.6]. Misioni i departamentit, si njësi bazë e fakultetit, është të nxisë, të bashkërendojë dhe të administrojë veprimtarinë e mësimdhënies dhe atë kërkimore, duke respektuar liritë akademike të personelit akademik dhe të drejtën e tij për të shfrytëzuar burimet materiale e financiare në dispozicion të tij [Evidencë 1.18].

Departamenti dhe grupet kërkimore në AS janë promotorë të veprimtarive të kërkimit shkencor, studimeve, botimeve dhe projekteve. Pranë rektoratit, si njësi koordinuese në funksion të procesit kërkimor-shkencor funksionon QKSH-ja [Evidencë 4.17, Evidencë 4.18]. Përgjatë dhe në fund të çdo viti akademik, QKSH-ja raporton për veprimtarinë kërkimore-shkencore pranë rektoratit dhe senatit akademik, ku dhe kryhen vlerësimet përkatëse [Evidencë 4.19]. QKSH-ja promovon veprimtarinë kërkimore-shkencore të akademisë, brenda dhe jashtë vendit [Evidencë 4.16, Evidencë 4.20]. Përgjegjësi i departamentit harton programin vjetor dhe planin financiar të veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore, duke ia paraqitur atë njësisë kryesore, e cila e dërgon për miratim [Evidencë 4.21]. Departamentet dhe grupet kërkimore të AS-së, bashkëpunojnë me organizma shkencorë kombëtarë e ndërkombëtarë. Vlen për t'u përmendur Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Akademia e Studimeve Albanologjike, AKKSHI, Akademia e Forcave të Armatosura, Akademia e Kosovës për Siguri Publike, Universiteti "Tor Vergata" i Romës, Universiteti i Tiranës, Universiteti UAMD i Durrësit dhe universitete të tjera; me institucionet akademike homologe të rajonit dhe evropiane si, akademitë e universitetet policore të Finlandës, Estonisë, Italisë, Turqisë, Austrisë, Gjermanisë etj. [Evidencë 2.60].

Standardi IV.7 Institucioni miraton objektiva të qarta për njësitë, krupet kërkimore / artistike dhe personelin akademik.

Në AS të gjitha njësitë kryesore, ato bazë dhe grupet kërkimore, kryejnë diskutime

Akademia e Sigurisë, institucion në progres (Akreditimi institucional)

të hapura në të cilat rrihen mendimet me personelin akademik, për të hartuar e miratuar objektivat vjetore kryesore të kërkimit shkencor. Këto objektiva kryesore mbështeten në objektivat strategjike afatgjatë që janë të shprehur në dokumentet strategjike kryesore të AS-së dhe të zbërthyer në planin zhvillimor të AS-së [Evidencë 1.7, Evidencë 4.22].

Objektivat dhe nënobjektivat specifike të zbërthyer dhe të miratuar nga njësia kryesore, merren për zbatim nga departamentet, të cilët nëpërmjet planit vjetor të kërkimit shkencor përcaktojnë detyrimet e tyre për stafin akademik [Evidencë 4.23].

AS-ja përmes planifikimit vjetor të njësive bazë dhe kryesore, përcakton qartë se sa do jetë raporti mes veprimtarisë mësimore e asaj kërkimore shkencore, administrative etj., dhe ofron infrastrukturën e duhur për realizimin e tyre në mënyrë të vazhdueshme [Evidencë 4.24]. Në përmbushje të objektivave në fushën e kërkimit, AS-ja ngre grupe pune për hartim projektesh, studimesh, konferencash etj. [Evidencë 4.25]. Për dhënien e kontributit, të ekspertizës dhe të përvojës së tyre, janë kryer bashkëpunime shkencore edhe me organizata ndërkombëtare të rëndësishme në nivel global, si: BE, OSBE, NATO, OBSH etj., si dhe me misione të huaja të bashkëpunimit policor, si: PAMECA, FRONTEx, MAPE, ICITAP, CEPOL etj. [Evidencë 4.10].

Standardi IV.8 Institucioni synon rritjen e vazhdueshme të veprimtarive kërkimore/artistike e shkencore dhe garanton gjithëpërfshirjen e personelit akademik dhe studentëve të ciklit të dytë dhe të tretë.

Përmes aktivitetit vjetor kërkimor shkencor të shtatë viteve të fundit, AS ka dëshmuar se synimin e saj për rritjen e vazhdueshme të numrit dhe të nivelit të veprimtarive kërkimore-shkencore e ka arritur. Përmirësimi i reputacionit të AS-së në drejtim të kërkimit shkencor në fushën e sigurisë publike, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, mund të matet në mënyrë sasiore e cilësore, duke u bazuar te numri i aktiviteteve, numri i kërkuesve të përfshirë dhe të aktorët me të cilët nga bashkëpunuar [Evidencë 4.26]. AS ka organizuar dhe është bërë pjesë e projekteve e konferencave të ndryshme shkencore kombëtare e ndërkombëtare, në fushat që kanë rëndësi të veçantë prioritare për të [Evidencë 4.27, Evidencë 4.10]. Studentët kanë një pjesëmarrje relativisht të mirë në veprimtarinë kërkimore-shkencore të AS-së, jo vetëm në kuadër të cikleve të tyre të studimit, por gjithashtu, edhe në projekte, konferenca e botime shkencore, në të cilat institucioni është i përfshirë [Evidencë 4.28].

Në vitet e fundit, AS-ja ka organizuar shtatë konferenca ndërkombëtare, gjashtë konferenca kombëtare, ku janë botuar punimet e plota ("proceedings"); në total AS-ja ka 25 vëllime botimesh të indeksuara me ISBN dhe ISSN (përfshirë këtu revista "Policimi dhe siguria"), të cilat në punimet e tyre kanë rreth 600 persona, me mbi 5 mijë faqe botimesh shkencore. AS-ja ndjek një politikë shumë nxitëse për sa i përket botimeve shkencore [Evidencë 4.29].

Standardi IV.9 Institucioni bën të njohura rezultatet në fushën e kërkimit shkencor/artistik.

AS-ja zotëron infrastrukturën dhe logjistikën e nevojshme për botimin dhe publikimin e veprimtarive të kërkimit shkencor në gjuhën shqipe dhe në atë angleze. Botimet e AS-së kryhen në formatin fizik, por hidhen edhe në formatin elektronik në

faqen e AS-së, e cila është ndërtuar qysh me hapjen e akademisë dhe mirëmbahet dhe pasurohet me informacion nga QKSH-ja [Evidencë 4.30, Evidencë 4.31]. Në AS ekzistojnë prioritetet të shprehura qartë në formë strategjish e politikash, që lidhen me publikimin e rezultateve kërkimore-shkencore dhe të veprimtarive të ndryshme si: projekte apo konferenca shkencore kombëtare ose ndërkombëtare [Evidencë 4.1, Evidencë 1.7].

AS-ja ka revistën e saj shkencore, “Policimi dhe siguria”, të regjistruar e të pajisur me ISSN, e cila siguron cilësinë dhe gjithë mjetet e duhura për vazhdimësinë e botimeve të punimeve shkencore të personelit akademik, studentëve dhe kërkuesve nga institucione të tjera me të cilat AS bashkëpunon. Botimet në këtë revistë shkencore, AS-ja i stimulon dhe nxit duke mos kërkuar asnjë detyrim financiar për artikujshkruesit dhe duke garantuar një cilësi të lartë botimi [Evidencë 4.32]. AS-ja zotëron një bazë të dhënash elektronike të botimeve shkencore të personelit akademik dhe këtë ua vë në dispozicion stafit pedagogjik, studentëve, bashkëpunëtorëve shkencorë etj. [Evidencë 4.31, Evidencë 4.12]. Përmes sektorit të botimeve të QKSH-së, AS-ja realizon përditësimin e arkivit të bibliotekës së saj me botimet shkencore të personelit akademik. Ky përditësim me botime bëhet duke i shpërndarë këto botime të reja edhe në Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë, në Bibliotekën e Akademisë së Forcave të Armatosura, në Arkivin Qendror të Shtetit etj. [Evidencë 4.16, Evidencë 4.33].

Standardi IV.10 Institucioni është përgjegjës për garantimin e cilësisë së punimeve shkencore/artistike dhe integritetin e tyre në nivel institucional.

AS-ja, përmes QKSH-së kryen një veprimtari rigoroze për kontrollin e cilësisë së kërkimit shkencor. QKSH-ja ka të miratuar një rregullore të posaçme e cila trajton standardin e cilësisë së veprimtarive kërkimore e shkencore. Kjo njësi e kërkimit shkencor, siguron edhe mekanizma të tjerë të vlerësimit që kanë lidhje me cilësinë e botimeve, publikimeve dhe punimeve shkencore në nivel institucional. Këto mekanizma vlerësimi punojnë në mënyrë transparente dhe sipas rregullave e standardeve të shkruara [Evidencë 4.34, Evidencë 4.11].

Në QKSH të AS-së, ngrihen sipas nevojave komisione, borde editoriale, grupe vlerësimi edhe me pjesëmarrje të personaliteteve të huaja të fushës për garantimin e cilësisë së punimeve shkencore të botuara apo publikuara prej saj. Revista periodike shkencore e AS-së “Policimi dhe siguria” e zhvillon veprimtarinë e saj botuese, bazuar në rregulloren e botimit; kjo revistë ka bord editorial në të cilin përfshihen edhe profesorë të huaj. Për çdo konferencë kombëtare e ndërkombëtare të AS-së, janë ngritur komitetet organizative dhe komitetet shkencore me personalitete akademike të huaja e nga vendi. Për botime monografish të ndryshme bëhen vlerësime në nivel departamenti përmes grupeve të vlerësimeve [Evidencë 4.35, Evidencë 4.11]. Në AS është ngritur dhe funksionon Këshilli i Etikës, veprimtaria e të cilit bazohet në rregulloren e brendshme të tij [Evidencë 1.16]. AS-ja ndjek një politikë të promovimit të kulturës kërkimore në nivel rajonal dhe kombëtar. Pjesë e kësaj politike është edhe ndërtimi i bordeve shkencore editoriale me personalitete të fushës së sigurisë publike që kanë tituj akademikë, nga vendet e rajonit dhe të BE-së [Evidencë 4.29].

AS-ja gjatë procesit parapërgatitor e vlerësues të botimit të materialeve shkencore që sillen në revistë, konferenca apo aktivitete të tjera shkencore, përdor sisteme

Akademia
e Sigurisë,
institucion
në progres
(Akreditimi
institucional)

elektronike antiplagjiaturë, si dhe mekanizma të tjerë të vetëkontrollit për eliminimin e plagjiaturës dhe respektimin e të drejtës së pronësisë intelektuale. Në çdo botim fizik dhe në çdo publikim elektronik shkencor, AS-ja vendos të shkruar për kërkuesit dhe hulumtuesit e ndryshëm, një lajmërim që lidhet me cilësinë e botimeve, plagjiaturën, të drejtën e autorit dhe përgjegjësitë ligjore që ka secila palë e individ [Evidencë 4.36].

Standardi IV.11 Institucioni i llojit universitet/akademi përcakton qartë detyrimet për personelin akademik në kuadër të pjesëmarrjes në veprimtari kërkimore, studime, publikime e botime dhe i mbështet për përmbushjen e tyre.

Personeli akademik i AS-së ka marrë pjesë dhe ka botuar apo referuar punën e vet në të paktën një veprimtari kombëtare me karakter kërkimor (seminar, konferencë, mbledhje pune, simpozium) gjatë një viti akademik. Në AS-së zhvillohen konferenca të ndryshme vjetore, nga vetë institucioni ose duke marrë pjesë në aktivitete të përbashkëta me institucione të tjera arsimore, në të cilat personeli akademik i AS-së paraqet punimet e veta shkencore [Evidencë 4.12]. Në AS personeli akademik është i angazhuar edhe në hartimin e botimit si autor i parë ose si bashkautor i teksteve mësimore ose cikleve të leksioneve, bazuar në një proces të miratuar nga njësia bazë [Evidencë 4.37]. AS-ja, duke qenë se gëzon statusin e veçantë si institucion, i përcakton edhe vetë në aktet saj rregulluese të aktivitetit kërkimor shkencor, kriteret që duhen ndjekur nga personeli akademik i AS-së dhe ecurinë e veprimtarisë së tyre kërkimore [Evidencë 4.23, Evidencë 1.17].

Standardi IV.12 Institucioni që ka përcaktuar në strategjinë e vet si prioritet kryesor kërkimin shkencor, fokusohet në ndërkombëtarizimin e kërkimit dhe veprimtarive që lidhen me të.

AS-ja ka lidhur një sërë marrëveshesh partneriteti dhe ka realizuar bashkëpunime në fushën e kërkimit shkencor, në lëmin e sigurisë publike dhe të sigurisë në tërësi, me institucione të huaja homologe të arsimit të lartë, institute kërkimore, agjenci e organizata ndërkombëtare me rëndësi (OSBE, OBSH, NATO, BE, etj.) të vendeve të OECD-së, BE-së e G20-s [Evidencë 4.10, Evidencë 2.60]. AS-ja ka realizuar edhe pjesëmarrje në thirrjet ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor në bashkëpunim me institucionet e tjera; bashkëpunimi rajonal në këtë drejtim është i anasjelltë [Evidencë 4.38].

AS-ja ka organizuar në partneritet me bashkëpunëtorët e vet ndërkombëtarë, konferenca dhe aktivitete ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor. Për çdo vit AS-ja organizon një konferencë vjetore shkencore ndërkombëtare, në bashkëpunim me partnerët e saj. Krahas saj ka edhe aktivitete të realizuara nga QKSH me vende të BE-së në kuadër të binjakëzimit me universitetet policore të Finlandës e të Estonisë [Evidencë 4.29, Evidencë 4.39, Evidencë 4.40]. Personeli akademik i AS-së ka një pjesëmarrje të vazhdueshme aktive në konferenca dhe aktivitete ndërkombëtare kërkimore-shkencore të fushës së sigurisë [Evidencë 4.29].

Një nga objektivat kryesorë strategjikë zhvillimorë të institucionit është kërkimi shkencor dhe inovacioni [Evidencë 1.7, pika 6]. Institucioni mbështet zhvillimin e kërkimit shkencor në fushat prioritare, të përcaktuara edhe në funksion të kapaciteteve infrastrukturore dhe njerëzore të tij [po aty].

Standardi IV.13 Institucioni ka prioritet përfshirjen në veprimtaritë mësimore e shkencore/artistike të personelit të huaj akademik dhe diasporës.

AS-ja i kushton një rëndësi të veçantë rritjes së cilësisë dhe ndërkombëtarizimit të studimeve. Kjo akademi fton, për veprimtari kërkimore dhe mësimdhënieje (kryesisht në fushën e trajnimeve afatshkurtra), personel akademik të huaj të specializuar në drejtime specifike si: kibernetikë, kriminalistikë, antiterrorizëm, balistikë etj., për periudha të kufizuara kohore [Evidencë 2.11]. Personeli akademik i AS-së është i përfshirë në grupe pune dhe zbatimin e projektit me institucionet homologe të Finlandës e të Estonisë në kuadër të një projekti të BE-së; ka pasur edhe përfshirje me programe specifike në vende të ndryshme partnere [Evidencë 4.41].

Standardi IV.14 Institucioni ka prioritet mobilitetin e personelit akademik dhe studentëve dhe siguron mekanizmat për përfshirjen sa më shumë të tyre.

AS-ja dhe personeli i saj akademik merr pjesë në aktivitete ndërkombëtare, prezanton kumtesa në konferenca, kongrese kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe organizon vetë aktivitete ndërkombëtare, si p.sh. konferenca shkencore, simpoziume, etj. [Evidenca 4.38, Evidencë 4.29]. AS mbi bazën e kuotave të përcaktuara nga Ministria e Brendshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, u jep të drejtë studimi studentëve për ndjekjen e studimeve jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë [Evidenca 4.42]. Gjithashtu, AS ndjek një politikë për integrimin e personelit akademik të ftuar dhe të studiuesve të huaj, e cila është në harmoni me kërkesat dhe nevojat si të institucionit ashtu edhe të tyre. AS-ja mirëpret në kuadër të marrëveshjeve institucionale profesore të huaj për realizimin e procesit mësimor, kryesisht për programe trajnimesh profesionale [Evidenca 4.43].

Standardi IV.15 Institucioni siguron vazhdimësi dhe rritje të impaktit të tij në fushën e kërkimit shkencor/artistik.

Prioritetet e kërkimit shkencor të AS-së janë të mbështetura te objektivat afatgjata strategjike institucionale kërkimore. Këto prioritate të zbrërthyera në nënobjektiva konkrete, përditësohen në përputhje me zhvillimet e reja të fushës së sigurisë publike, me nevojat që ka policia e Shtetit dhe agjencitë ligjzbatuese që bashkëpunojnë me AS-në si dhe te nevojat e sfidat e fushës, që ka vendi e rajoni [Evidencë 4.1, Evidencë 1.7].

AS-ja i zhvillon veprimtaritë e kërkimit shkencor në funksion të zhvillimit institucional dhe përmirësimit të kapaciteteve të tij. Kjo veprimtari orientohet përmes dokumenteve të saj kryesore strategjike dhe ecuria e cilësisë së vlerësohet në mënyrë periodike, me qëllim që të shihet efikasiteti i zbatimit të strategjisë [Evidencë 1.33, Evidencë 1.34]. AS-ja ka vendosur partneritete me institucione arsimore dhe akademitë simotra policore që të bashkëpunojnë për zhvillimin e kapaciteteve të nevojshme në drejtim të studimit e të kërkimit shkencor, duke promovuar iniciativat e reja dhe të shkëmbimit kulturor e profesional. AS-ja ka nënshkruar një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione të arsimit të lartë kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe me institucione të ndryshme të arsimit policor, me qëllim rritjen e reputacionit institucional, rritjen e kapaciteteve të personelit akademik, si dhe në funksion të

Akademia
e Sigurisë,
institucion
në progres
(Akreditimi
institucional)

përmirësimit të aktivitetit akademik [Evidencë 4.10, Evidencë 2.60].

Standardi IV.16 Institucioni siguron transferimin e rezultateve të veprimtarive kërkimore e shkencore në funksion të zhvillimit të vendit, ekonomisë dhe shoqërisë.

Në AS, nëpërmjet QKSH-së dhe departamenteve të tjera, kryhet vlerësimi i vazhdueshëm i ecurisë së rezultateve në fushën e kërkimit shkencor. Për këtë gjë përdoren metoda e mekanizma sasiorë të pasur më të dhëna, si dhe metoda cilësore analizash periodike për kërkimin shkencor [Evidencë 4.13, Evidencë 4.19, Evidencë 4.44]. AS-ja ka ndjekur e zbatuar politika promovuese të rezultateve të kërkimit shkencor në fushën e sigurisë. Ajo ka marrë pjesë në diskutime të ndryshme shkencore duke u angazhuar përmes ekspertëve ose duke kryer rolin e koordinimit të aktiviteteve kombëtare e ndërkombëtare shkencore. Angazhimi i AS-së përmes QKSH-së, si organizatore e konferencave, ka prodhuar përfundime shkencore e rekomandime politikash, që u janë ofruar për zbatim institucioneve të interesuara.

Këto politika kanë pasur orientimin e zhvillimit social-ekonomik-shkencor të vendit e më gjerë. Mund të përmendim rekomandime në drejtim të vetëvrasjeve, sigurisë rrugore, sigurisë mjedisore, sigurisë kibernetike etj. [Evidencë 4.45]. AS-ja kryen një aktivitet shkencor ku këshillon, orienton ose kryen kërkime e studime për institucione e organizma vendase dhe të huaja. Mund të përmendim disa aktivitete shkencore të ndryshme të fushës së sigurisë publike, ku palët e interesuara si Trans-Adriatic Pipeline (TAP), SHELL Albania, OSBE-ja etj., kanë mbështetur financiarisht botimet shkencore ose konferencat ndërkombëtare të AS-së, duke sjellë edhe ekspertë të tyre në këto diskutime [Evidencë 4.46].

Standardi IV.17 Institucioni garanton pronësinë intelektuale të arritjeve dhe rezultateve në fushën e kërkimit shkencor dhe i përdor ato me qëllim zhvillimin ekonomik dhe financiar të tij.

AS-ja në bashkëpunim me partnerët me të cilët ka realizuar edhe një pjesë të aktivitetit të saj kërkimor e shkencor, i ka vënë rezultatet e kërkimeve më të fundit, tendencat dhe gjetjet e aktiviteteve shkencore e studimeve, në zbatim të Policisë së Shtetit dhe të agjencive të tjera ligjzbatuese të fushës së sigurisë si p.sh.: mbështetja me përfundimet e nxjerra nga konferenca ndërkombëtare për sigurinë rrugore, që zhvilloi AS-ja, për aktivitetin ndërkombëtar të Ministrisë së Punëve të Brendshme, i cili synonte përmirësimin e teknologjisë dhe të masave që do të ndikonin te siguria rrugore [Evidencë 4.47].

AS-ja promovon arritjet e veta të kërkimit shkencor si në mënyrë fizike, edhe në mënyrë elektronike. Ajo ndjek një politikë të qartë e të shkruar në strategjitë e kërkimit e të zhvillimit, dhe rregulloret që normojnë kërkimin shkencor ose procesin e botimit, e cila mbron pronësinë intelektuale të autorëve [Evidencë 4.1, Evidencë 1.7, Evidencë 4.11, Evidencë 4.18].

Meqenëse AS-ja ka fituar një reputacion të mirë e të besueshëm në drejtim të zhvillimit të aktiviteteve shkencore, ajo ka arritur që të sigurojë edhe të ardhura e financime nga palë të treta, përmes arritjeve të kërkimit shkencor [Evidencë 4.46, Evidencë 4.25].

Përfundimet dhe vlerësimi

AS-ja, duke i dhënë prioritet e vëmendje të veçantë kërkimit shkencor, ka të ngritur si strukturë funksionale, Qendrën e Kërkimeve Shkencore. Misioni i kësaj qendre është zhvillimi dhe publikimi i studimeve, konferencave shkencore, projekteve kërkimore etj., në funksion të objektivave strategjikë të AS-së dhe prioriteteve të Policisë së Shtetit.

AS-ja mbështet, inkurajon dhe vlerëson zhvillimin e punës kërkimore-shkencore, duke lidhur marrëveshje bashkëpunimi e duke krijuar partneritete me institucione vendase e të huaja të arsimit të lartë policor e jopolicor; zhvillimit të punës kërkimore të personelit akademik; organizimit të aktiviteteve të ndryshme kërkimore-shkencore, si dhe publikimit të rezultateve të kërkimit. Aktualisht, AS-ja është e angazhuar në zgjerimin e bashkëpunimeve dhe zhvillimin e projekteve të përbashkëta me partnerë ndërkombëtarë. AS-ja inkurajon stafin akademik për pjesëmarrje në aktivitete të ndryshme kërkimore-shkencore, si brenda edhe jashtë vendit, duke u krijuar atyre kushte favorizuese për botimin e materialeve të tyre. Akreditimi institucional do të fuqizonte dhe do të mundësonte pjesëmarrjen e AS-së në projekte të përbashkëta ndërkombëtare, pasi akreditimi shërben si standard aplikimi në to. Bazuar në analizën dhe evidencat e sjella, GVB arrin në përfundimin se standardet për fushën e katërt, e cila trajton kërkimin shkencor dhe inovacionin, janë të përmbushura plotësisht.

V – STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1 Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin dhe përzgjedhjen e studentëve.

Pranimi i studentëve të rinj në AS realizohet bazuar te kërkesat dhe te politikat e Policisë së Shtetit për personel, punësim e rekrutim; te ligji 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; te kërkesat e veçanta dhe specifike të miratuara me vendim të Senatit Akademik të AS-së, si dhe te udhëzimet e tjera ligjore në fuqi, në funksion të arsimit të lartë në RSH [Evidencë 5.1, Evidencë 3.13]. Informacioni për kriteret, kuotat dhe procedurën e aplikimit publikohet në faqen zyrtare të internetit të AS-së [Evidencë 5.2]. Para fillimit të vitit akademik Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit në bashkëpunim me Bordin e Administrimit miratojnë kuotat e pranimi për çdo program studimi si dhe për trajnimet e kualifikimet vjetore [Evidencë 5.3, Evidencë 2.11]. AS-ja merr parasysh dhe zbaton raportin numerik të personelit akademik me studentët, me qëllim që të garantojë një proces mësimdhënieje cilësor, në përputhje me synimet që ka për të ndërtuar një institucion arsimor cilësor. Ky raport është me përafërsi nga 1 (personel akademik) me 20 (studentë), në 1 me 30 [Evidencë 5.4].

Standardi V.2 Institucioni u ofron mbështetje nëpërmjet shërbimeve universitare për të lehtësuar ecurinë e tyre.

AS-ja ofron për studentët udhëheqje dhe kujdestari (tutoriat) nëpërmjet departamenteve përkatëse. Kjo realizohet gjatë gjithë periudhës së studimeve. Që në

Akademia e Sigurisë,
institucion
në progres
(Akreditimi
institucional)

fillim të vitit akademik AS-ja ndihmon dhe orienton studentin për kurrikulën e programit të studimit, rëndësinë e frekuentimit, mënyrën e sigurimit të literaturës gjatë viteve akademike nëpërmjet:

- programit të lëndës, i cili i vihet në dispozicion çdo studenti që orën e parë në auditor nga pedagogu i lëndës;
- pedagogët e tutoriatit;
- pedagogët, në mentorim për orientimin dhe mbështetjen në përgatitjen e temës së diplomës;
- personelit të bibliotekës;
- sekretaritë mësimore.

Pedagogët e përcaktuar për kujdestari (tutoriat) ndihmojnë studentët gjatë fazës së përzgjedhjes të temave të diplomës, dhe nëpërmjet mentorimit deri në përfundim të ciklit të studimeve [Evidencë 5.5].

AS-ja ka parashikuar procedura të qarta të shpërndarjes së udhëheqjeve të temave të diplomës në përputhje me rregulloret e programeve të studimit [Evidencë 1.17].

Standardi V.3 Institucioni përdor sistem efikas informimi për studentët.

AS-ja ka një strukturë të mirëorganizuar që siguron këshillimin e studentëve, orientimin e tyre si dhe komunikimin në nivele të ndryshme me personelin akademik. Në nivel institucional, mbështetjen, orientimin dhe komunikimin e studentëve për çdo program studimi, e kryejnë departamentet dhe sekretaritë mësimore. Për komunikimin dhe informimin përdoren edhe rrjetet elektronike: faqja e internetit e Akademisë së Sigurisë; rrjetet sociale të AS-së si dhe rrjeti i Policisë së Shtetit (*asp.gov.al*). Për sa i përket logjistikës, këtë mbështetje e ofron në nivel institucional “Sektori ekonomik dhe i shërbimeve” [Evidencë 5.6, Evidencë 4.31].

AS-ja ofron lehtësira të komunikimit të brendshëm të personelit akademik dhe studentëve të tij. Realizimi i këtij komunikimi në nivel njësie bazë mundëson kontaktin e drejtpërdrejtë të studentit me pedagogët e tij [po aty]. Përdorimi i internetit është një mundësi më shumë për komunikim të brendshëm midis pedagogut dhe studentit, pasi studentët zotërojnë adresa imeili në rrjetin e brendshëm të Policisë së Shtetit; në këtë rrjet funksion edhe AS-ja. Krahas këtij rrjeti janë në sistem edhe numrat e telefonave individuale që përdorin efektivat dhe studentët e policisë [Evidencë 5.7]. Për sa i përket komunikimit të jashtëm, AS-ja ofron mjete të ndryshme komunikimi si përdorimi i faqes së internetit të institucionit, rrjeti social FB, adresa imeil, telefon, postë etj. [Evidencë 4.31, Evidencë 5.7]. Mjetet dhe mënyrat kryesore të informimit dhe komunikimit me studentët në AS janë:

- faqja zyrtare e institucionit të AS-së;
- faqja zyrtare në FB;
- numrat e telefonit;
- adresat e imeilit;
- banderolat (posterat) e afishuara në kënde informimi,
- fletëpalosjet;
- sekretaria mësimore;
- adresa e postës fizike [po aty].

Institucioni disponon adresën elektronike dhe numrin e telefonit të çdo studenti si dhe dosjen e plotë personale të studentit që menaxhohet nga sekretaritë mësimore dhe

pas diplomimit të studentit arkivohet, duke respektuar parashikimet ligjore të vendosura nga ligji nr. 9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat në RSH, i ndryshuar” [Evidencë 5.8].

Gjithashtu studentët mund të komunikojnë me stafin administrativ të AS nëpërmjet adresave elektronike të brendshme të stafit administrativ, të cilat gjenden të publikuara në rrjetin e brendshëm që përdor policia.

Standardi V.4 Institucioni inkurajon pjesëmarrjen e studentëve në jetën institucionale.

Studentët janë të organizuar zyrtarisht në organin përfaqësues të Këshillit Studentor bazuar në nenet 54 dhe 55 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë” si dhe statutit të AS-së. Këshilli Studentor i AS-së është një organizim i pavarur i studentëve, i cili nuk zhvillon veprimtari politike dhe ekonomike; anëtarë e këtij këshilli, zgjidhen sipas një procedure të caktuar. Ky këshill promovon pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinon përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të AS-së, në strukturat mësimore-kërkimore dhe të shërbimeve si dhe funksionon sipas një akteve rregullatorë të AS-së [Evidencë 1.17, Evidencë 1.1].

Akademia, mbështet në mënyrë të vazhdueshme veprimtari të veçanta të studentëve si: pjesëmarrje në konferencat shkencore brenda dhe jashtë vendit, që ajo organizon vetë apo në bashkëpunim; dhe në aktivitete kulturore, të organizuara me institucione partnere ose me individë të ndryshëm, në AS [Evidencë 5.9, Evidencë 4.28]. AS-ja inkurajon pjesëmarrjen e studentëve në vendimmarrje, organizimin e lirë dhe shprehjen e mendimit të tyre, parashikuar kjo shprehimisht në dispozitat e statuti të AS-së dhe të “Rregullorja e FHS-së” etj. [Evidencë 1.1, Kreu V, Evidencë 1.17]. Këshilli Studentor i AS-së shpreh mendime dhe propozime për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm të AS-së, si për planet dhe programet e studimeve, rregulloret për veprimtaritë mësimore, të drejtën për të studiuar, cilësinë e shërbimeve, zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kulturore, artistike, sportive etj. Përfaqësuesit e tij janë pjesë e organeve kolegjiale të AS-së [Evidencë 5.10].

AS-ja në përbërje të saj ka dy njësi kryesore (fakulteti dhe koleggi). Çdo njësi e AS-së ka këshillin studentor të saj. Çdo këshill studentor në nivel fakulteti ka përfaqësuesit e tij [Evidencë 5.11]. Senati akademik ka një përfaqësues të studentëve, i cili zgjidhet me votim të fshehtë nga vetë studentët. Përfaqësuesi i studentëve në senatin e AS-së shpreh mendimet dhe propozimet për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm, si: për planet mësimore edhe për programet e studimeve, rregulloret e studimeve etj. Ky mendim merret drejtpërdrejt nga takimet me studentët dhe nëpërmjet ankesave të paraqitura pranë sekretarive mësimore [Evidencë 5.12].

Standardi V.5 Institucioni ndjek një politikë të orientimit dhe këshillimit të studentëve.

AS-ja në bashkëpunim me departamentet, sekretaritë mësimore dhe me sektorin ekonomik dhe të shërbimeve, organizon aktivitetet e përgjithshme dhe të ndara sipas programeve të studimit për njohjen e studentëve me ambientet e akademisë, stafin, mjediset, rregulloret, të drejtat dhe detyrimet e studentit [Evidencë 5.8, Evidencë 5.13, Evidencë 5.14].

Në akademi funksionon edhe sektori i disiplinës dhe sigurisë, i cili u vjen në ndihmë

studentëve gjatë aktivitetit 24-orësh, pasi një pjesë e studentëve janë të strehuar në ambientet e AS-së; ky personel i njeh ata me rregulloret dhe elementët e disiplinës gjatë përdorimit 24-orësh të mjedisve [Evidencë 5.13].

Kontaktet e drejtuesve dhe zyrave të institucionit vendosen në shërbim të studentëve, së bashku me adresat elektronike. Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes ndaj Studentëve vë në dispozicion të studentëve materiale dhe broshura informuese për t'i orientuar ata për të njohur organizimin e institucionit si dhe të drejtat e tyre të miratuara në statutin e AS-së dhe në rregulloret përkatëse të njësive kryesore [po aty].

Standardi V.6 Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për kategori sociale të veçanta dhe aktivitete jashtëkurrikulare.

AS-ja i kushton rëndësi të vazhdueshme mbështetjes së kategorive sociale dhe bursave të studimit, si pjesë e përgjegjësisë ndaj komunitetit që ka lidhje me policinë (bursa për fëmijët jetimë të policëve të rënë në krye të detyrës) [Evidencë 5.15]; gjithashtu AS-ja zbaton politikat e Policisë së Shtetit, lidhur me favorizimin dhe inkurajimin e shtimit të femrave në radhët e policisë [Evidencë 5.16].

Politika të veçanta barazie dhe antidiskriminuese ndiqen edhe për pranimin si student nga radhët e pakicave të ndryshme [Evidencë 5.17]. AS-ja ndjek një politikë mbështetëse për studentët nga komuniteti rom dhe egjiptian sipas ligjeve në fuqi dhe udhëzimeve të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit [po aty].

Standardi V.7 Institucioni ofron literaturë bazë dhe ndihmëse për studentët.

AS-ja ofron një bibliotekë të pasur me tekste mësimore dhe literaturë plotësuese. Tekstet mësimore që AS-ja ofron për studentët janë të miratuara nga njësitë bazë përkatëse të AS-së dhe përdoren edhe në universitete të tjera në vend apo dhe jashtë saj. Në mjediset e AS-së është vendosur një bibliotekë, e cila shërben edhe si sallë studimi për studentët. Në të përfshihet literaturë me tituj të librave universitarë dhe botime artistike. Në këtë bibliotekë ka një numër të konsiderueshëm titujsh; rreth 7000 tituj [Evidencë 5.18]. Informacione të tjera merren nga studentët nëpërmjet materialeve të dërguara “online” nga pedagogët, materialeve të botuara nga vetë AS-ja. Kjo literaturë pasurohet e pasqyrohet periodikisht në syllabyset përkatëse të lëndëve si dhe nëpërmjet botimeve në revistën shkencore të AS-së “Policimi dhe siguria”, abonimeve në biblioteka dhe revista “online”, kërkimit shkencor të pedagogëve dhe botimeve në kuadër të projekteve ndërkombëtare [Evidencë 3.3, Evidencë 4.12].

AS-ja përdor fonde të veçanta për blerjen e literaturës së re që del në tregun e librave universitarë, duke pasuruar kështu bibliotekën dhe duke u krijuar lehtësira studentëve në përdorimin e saj. AS-ja parashikon çdo vit fonde për blerjen e literaturës së specializuar në fushën e kërkimit shkencor sipas propozimeve që vijnë nga departamentet e fakultetit. Krahas këtyre, përdoret pasurimi edhe përmes dhurimeve të librave dhe marrëveshjeve të bashkëpunimit; një e tillë ishte ajo me Akademinë e Shkencave e cila dhuroi një sërë titujsh literature shkencore për bibliotekën e AS-së [Evidencë 2.60, Evidencë 3.41]. Orari i punës së bibliotekës në AS, gjatë të cilit punonjësit u përgjigjen nevojave të studentëve, shpallet në mjediset dhe në ueb-in e AS-së. Studentët regjistrohen në kartelat që iu lejojnë të marrin librat në ambientet e sallave të studimit brenda AS-së.

Biblioteka, që shërben edhe si sallë studimi, ka të skeduar 41 522 kopje librash: libra mësimorë, artistikë dhe revista të ndryshme. Koleksioni i librave përmban po ashtu, manuale, artikuj simpoziumesh, fjalorë si dhe artikuj të ndryshëm gazetash. Përkatësisht 367 tituj janë literaturë në gjuhë të huaj, ndërsa rreth 6000 tituj janë literaturë në gjuhën shqipe; tituj total periodikësh janë 125 [Evidencë 5.18].

Në këtë bibliotekë gjenden gjithashtu dhurime nga profesorë të shquar shqiptarë e të huaj si dhe nga shumë institucione të ndryshme, përfshirë këtu edhe dhurimet që i janë bërë AS-së nga Akademia e Shkencave të RSH-së. Pasurim tjetër të literaturës përbën edhe lidhja përmes internetit me bibliotekat ndërkombëtare. Studentët orientohen drejt përdorimit të bibliotekave falas në internet përmes trajnimeve që u bëhen në orët mësimore; ata praktikojnë përdorimin e këtyre bibliotekave “online” [Evidencë 3.3, Evidencë 5.19].

Standardi V.8 Institucioni favorizon punësimin e studentëve.

AS-ja, në dallim nga institucionet e tjera të arsimit të lartë në RSH, ka si veçanti sigurimin e punësimit të studentëve të saj që përfundojnë arsimimin e lartë policor, në masën 100%. Këta studentë duhet që të përfundojnë me sukses ciklin e arsimimit, në përputhje me detyrimet ligjore të arsimit të lartë, ashtu si në çdo IAL tjetër në RSH. Që të punësohen në strukturat e Policisë së Shtetit, studentët e kanë kusht të patjetërsueshëm, të diplomohen në përfundim të studimeve të tyre. Statistikat në lidhje me këtë arsimim që ofron punësim janë të larta, po t'i krahasosh me tregun në të cilin veprojnë IAL-të në Shqipëri. Nga viti 2015 deri në vitin 2021 janë diplomuar në “Bachelor” dhe janë punësuar njëkohësisht, 416 studentë [Evidencë 5.4].

Standardi V.9 Institucioni ruan lidhje të vazhdueshme me ish-studentët e tij.

AS-ja përdor forma bashkëpunimi me studentët e diplomuar/Alumni në të mirë të rritjes së cilësisë në programet aktuale. Ata bëhen pjesë e aktiviteteve të ndryshme kërkimore ose angazhohen edhe në procesin e mësimdhënies [Evidencë 5.20]. Në AS studentët e diplomuar përfshihen në proceset e rishikimit dhe riorganizimit të kurrikulave, ose edhe hapjes së programeve të reja, duke u marrë mendimin dhe duke i ftuar në procesin e këshillimit e të vlerësimit për përmirësimin e kurrikulave [po aty]. Në mënyrë periodike organizohen anketime me studentë të diplomuar, me qëllim matjen e cilësisë së arsimimit që ofron AS-ja dhe përputhjes që ka niveli i tyre profesional me organizatën e policisë, në të cilën ata ushtrojnë aktivitetin e tyre pas diplomimit [Evidencë 5.21]. Akademia e Sigurisë ka marrë pjesë në vitin 2015 në “Sondazhin kombëtar të studentëve për institucionet e arsimit të lartë”, organizuar nga ASCAL-i, rezultatet e të cilit flasin qartë për nivelin e arsimimit që studentët e programit “Bachelor” kanë marrë AS-ja [Evidencë 5.22].

Përfundimet dhe vlerësimi

AS-ja ndjek një politikë transparente dhe korrekte, nga regjistrimi deri tek emërimi i studentëve si oficerë policie duke u bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për regjistrimin dhe ruajtjen e të dhënave të studentëve. Nisur nga ky qëllim, para fillimit të çdo viti akademik, bazuar te nevojat e Policisë së Shtetit, shpallen kriteret dhe thirrjet e

aplikimit në faqen e internetit të AS-së ose rrjetet sociale zyrtare, për fillimin e studimeve në AS. Një nga pikat më të forta të AS-së është punësimi 100% i studentëve që diplomohen si dhe fakti se të gjithë studentët në AS, trajtohen me pagë dhe u ofrohen kushtet të mira strehimi e trajtimi ushqimor. Në AS-ja ndiqet një politikë e mirë e informimit të studentëve dhe sigurohet komunikimi ndërmjet tyre dhe personelit akademik përmes një sistemi të mirëorganizuar tutoriati dhe mentorimi, si dhe falë mbështetjes së strukturave përkatëse të ngritura në këtë akademi.

AS-ja u kushton vëmendje të veçantë politikave mbështetëse ndaj komuniteteve të pakicave, përfaqësimit të femrave dhe bursave të studimit për fëmijët e policëve të rënë në krye të detyrës. Akademia ofron një bibliotekë të pasur me tekste mësimore dhe literaturë plotësuese, shfrytëzuar nga studentët për veprimtari kërkimore-shkencore. Studentët janë një zë i fortë në AS, të përfshirë zyrtarisht në organet kolegjiale të institucionit. Bazuar në analizën dhe evidencat e sjella, GVB arrin në përfundimin se AS-ja përmbush *plotësisht* standardet për fushën e pestë, e cila trajton studentët dhe mbështetjen e tyre; inkurajimin dhe informimin e vazhdueshëm të studentëve për karrierën e tyre profesionale në Policinë e Shtetit, por edhe për t'u integruar në tregun e punës, nëse largohen nga policia, për shkak se diploma e tyre e Bachelor, përmbush të gjitha standardet e një të diplomuari të ciklit të parë të studimeve. Mbetet si objektivi kryesor i AS-së, përmirësimi i mëtejshëm i debatit konstruktiv dhe mendimit kritik të studentëve, si shprehje e lirisë së institucioneve arsimore.

PËRFUNDIMET DHE VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM

Në përfundim të hartimit të Raportit të Vlerësimit të Brendshëm për akreditimin institucional periodik të Akademisë së Sigurisë, Grupi i Vlerësimit të Brendshëm paraqet përfundimet përmbledhëse, si në vijim:

a. Pika të forta:

- Struktura organizative e Akademisë së Sigurisë funksionon në përputhje me ligjin nr. dt. “Për Policinë e Shtetit”, ligjin 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, aktet nënligjore në zbatim të tyre si dhe VKM nr. dt. “Për statusin e veçantë të Akademisë së Sigurisë”. Bazuar në to janë përditësuar të gjitha aktet e tjera normative të AS-së.

- AS-ja ka angazhuar personel akademik të kualifikuar me grada shkencore dhe tituj akademikë, me eksperiencë të gjatë në mësimdhënie, si dhe në përputhje me profilin e sigurisë dhe hetimit.

- AS-ja ofron programe në të dy ciklet e studimit: “Bachelor” e “Master”, në përputhje me nevojat e Policisë së Shtetit dhe të agjencive të tjera ligjzbatuese.

- AS-ja ofron trajnime profesionale të bazuara te kërkesat dhe nevojat e punës së Policisë së Shtetit dhe të agjencive të tjera ligjzbatuese, duke angazhuar edhe ekspertë të jashtëm me përvojë në fushat përkatëse.

- Kurrikulat dhe syllabuset e lëndëve janë përditësuar në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi, me të rejat më të fundit të fushës së sigurisë publike, hetimit e policimit dhe janë pasuruar me literaturë e publikime bashkëkohore; është marrë në konsideratë edhe këshillimi me ekspertë të huaj nga akademi e institucione të ndryshme evropiane (Finlandë, Estoni, Itali, Gjermani etj.).

- AS-ja bazuar në strategjinë zhvillimore institucionale, ka hartuar edhe strategjinë për zhvillimin e kërkimit shkencor në institucion.

- AS-ja ofron një sistem të konsoliduar të sigurimit të cilësisë dhe ka bërë të mundur fuqizimin e kulturës së cilësisë në institucion; vlen të theksohet thithja e mendimeve nga studentët që kanë mbaruar programet e studimit në AS.

- AS-ja ofron një bibliotekë të pasur, me infrastrukturë të përshtatshme për studentët, të pajisur me literaturën e nevojshme, si dhe me mundësi qasjeje në bibliotekat elektronike.

- AS-ja ndjek politika të transparencës me stafin akademik, me studentët dhe me publikun e gjerë, duke ofruar informacion të vazhdueshëm përmes faqes së saj të internetit.

- Dokumentacioni dhe mekanizmat e komunikimit janë të mirëzhvilluara dhe në ndihmë të informimit të studentëve funksionojnë sekretaritet mësimore.

- AS-ja ofron struktura mbështetëse dhe ndihmëse për studentët duke i përfshirë në proceset vendimmarrëse me qëllim përmbushjen më të mirë të nevojave të tyre.

- Një nga pikat më të forta të AS-së është punësimi 100% i studentëve që diplomohen si dhe fakti se të gjithë studentët në AS, trajtohen me pagë dhe u ofrohen kushtet e strehimit/fjetjes 24-orësh, e të trajtimit ushqimor.

- Qendra e Kërkimeve Shkencore, përmes aktivitetit të saj si ent botues, ofron mundësinë e botimeve, përkthimeve dhe publikimeve të literaturës që vjen në ndihmë të procesit mësimor, si dhe mbështet botimin e revistës shkencore “Policimi dhe siguria”, librave të indeksuar me ISBN të punimeve të plota të konferencave, të projekteve, si dhe punime e tekste individuale të pedagogëve.

- Burimet financiare të institucionit mbështeten 100% te buxheti i shtetit; ato paraqiten të mjaftueshme për qëndrueshmërinë dhe besueshmërinë në të ardhmen.

- AS-ja është e pozicionuar në një hapësirë shumë të bollshme dhe plot gjelbërim, në një pozicion të favorshëm të qytetit dhe ofron mjedise e infrastrukturë nxitëse për zhvillimin e programeve të studimit.

b. Pika të dobëta (ose pikat ku ka vend për përmirësim):

- Akreditimi i programit të studimit “Bachelor në Siguri dhe Hetim” mbetet prioritet i punës së AS-së dhe është një pikë e cila duhet përmirësuar sa më shpejt.

- Përmirësimi i infrastrukturës së studimit dhe të akomodimit të studentëve, pasi një pjesë e godinave kanë nevojë për ndërhyrje ose rikonstrukcion, ngaqë janë të dëmtuara nga tërmetet.

- Vonesa në hapjen e programeve “Master Profesional” shtrën nevojën për një bashkërendim më të mirë të AS-së me PSH-në dhe agjencitë e tjera ligjzbatuese, me qëllim që ato të realizohen brenda afateve ligjore.

- Për të rritur të ardhurat e AS-së, do të ishte në interes të AS-së, përmirësimi i akteve nënligjore për përdorimin e të ardhurave nga të tretët, në interes të mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor.

- Një element i cili duhet përmirësuar, është ai që ka të bëjë me lëvizjet e shpeshta të personelit akademik me uniformë, i cili për arsye të karrierës policore dhe organizimit institucional, herë pas here lëviz dhe zëvendësohet nga personel i ri mësimdhënës.

Bazuar në përfundimet dhe vlerësimet e secilës prej fushave të mësipërme që u analizuan në këtë raport, në përputhje me “Kodin e cilësisë së arsimit të lartë”, VKM nr.

824, dt. 24.12.2021, për përmbushjen e standardeve shtetërore të cilësisë, GVB-ja gjykon se Akademia e Sigurisë, si institucioni i vetëm arsimor i sigurisë publike në Shqipëri, i përmbush *plotësisht* standardet e kërkuara.

3. Lista e evidencave mbështetëse të IAL-së

1. INSTITUCIONI I ARSIMIT TË LARTË, MENAXHIMI, AUTONOMIA DHE SIGURIMI I CILËSISË

Evidencë 1.1. Urdhër, nr. 490, 2015, MPB, MAS, “Për miratimin e Statutit të AS”.

Evidencë 1.1.1. Vendim, nr. 64, 28.6.2022, Senati Akademik, AS, “Për miratimin e Statutit të AS”.

Evidencë 1.1.2. AS për MB, 29.6.2022, “Dërgohet për miratim projektstatuti i Akademisë së Sigurisë”.

Evidencë 1.1.3. Statuti i AS.

Evidencë 1.1.4. Vendim, nr. 8, dt. 11.4.2022, Bordi i Administrimit të AS, “Për miratimin e Statutit të AS”.

Evidencë 1.2. Vendim, nr. 10, 29.1.2016. Senati Akademik, AS, “Miratimi i Rregullores së brendshme, AS”.

Evidencë 1.3. Rregullore e Akademisë së Sigurisë.

Evidencë 1.3.1. Vendim, nr. 25, 18.12.2016, Senati Akademik, AS, “Miratimi i Rregullores së re të AS”.

Evidencë 1.4. Vendim, nr. 2, 26.9.2015, “Senati Akademik, AS, “Miratimi i projektstatutit të AS”.

Evidencë 1.4.1. Vendim, nr. 24, 18.12.2016, Senati Akademik, AS, “Miratimi i projektstatutit të AS”.

Evidencë 1.4.2. Vendim, nr. 30, 26.5.2017, Senati Akademik, AS, “Miratimi i ndryshimeve të bëra në draftstatutin e ri të AS-së dhe dërgimi i tij për miratim në MAS”.

Evidencë 1.4.3. Vendim, nr. 55, 3.3.2022, Senati Akademik, AS, “Miratimin e draftit përfundimtar të Projektstatutit të ri të Akademisë së Sigurisë, duke marrë në konsideratë vërejtjet e ardhura nga Bordi i Administrimit të AS-së”.

Evidencë 1.5. Vendim, nr. 25, dt. 18.12.2016, Senati Akademik, AS, “Miratimin e Rregullores së re të Akademisë së Sigurisë”.

Evidencë 1.5.1. Urdhër, nr. 180, dt. 15.4.2016, MAS, “Për riorganizimin institucional të Akademisë së Sigurisë”.

Evidencë 1.5.2. Vendim, nr. 26, dt. 18.12.2016, Senati Akademik, AS, “Për përmirësime në strukturën e brendshme të departamenteve të Fakultetit të Sigurisë dhe Hetimit”.

Evidencë 1.6. Vendim i KM, nr. 370, dt. 26.4.2017, “Për organizimin dhe funksionimin e Kolegjit Profesional të Lartë”.

Evidencë 1.7. Vendim, nr. 57, dt. 17.5.2022, Senati Akademik, AS, “Për miratimin e draftit të Strategjisë Zhvillimore të Akademisë së Sigurisë dhe Planit të Veprimit për periudhën 2022-2025”.

Evidencë 1.7.1. Strategjia Zhvillimore e Akademisë së Sigurisë.

Evidencë 1.7.2. Vendim, nr. 29, dt. 26.5.2017, Senati Akademik, AS, “Për miratimin

e draftit të Strategjisë Zhvillimore të Akademisë së Sigurisë 2015-2020”.

Evidencë 1.7.3. Vendim, nr. 58, dt. 17.5.2022, Senati Akademik, AS, “Për miratimin e draftit të Strategjisë të Akademisë së Sigurisë për Veprimtari Kërkimore dhe Zhvillimore”.

Evidencë 1.8. Vendim, nr. 4, dt. 16.2.2022, Bordi i Administrimit të AS, “Për miratimin e rregullores së organizimit dhe funksionimit të Bordit të Administrimit të Akademisë së Sigurisë”.

Gama e informacionit mbështetës të ofruar nga institucioni, i dha mundësinë grupit të njihej me strukturën, politikat dhe procedurat e drejtimit, si dhe me natyrën e mësimdhënies dhe veprimtarisë kërkimore të ndërmarre nga institucioni. Këto dokumente përfshinin Statutin dhe Rregulloret, raportet e brendshme, raportin vjetor ndaj Ministrisë, procedurat e pranimit dhe orientimit, listën e marrëveshjeve të jashtme dhe memorandumit, shembujt e informacioneve rreth programeve, si dhe dokumentet e mbledhjeve vendimmarrëse, etj. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pranoi se evidencat, si në anglisht, po ashtu edhe në shqip, ishin të përshtatshme për të nxjerrë një gjykim, dhe kërkoi vetëm dy dokumente shtesë për të shqyrtuar evidencat mbi mënyrën në të cilën AS-ja trajton Standardet. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm zhvilloi një vizitë dyditore në Institucion, ku u takua me Rektorin, menaxherët e lartë, studentët, pedagogët, stafin administrativ dhe mbështetës, njësinë e brendshme të sigurimit të cilësisë, si dhe të diplomuarit dhe partnerët e jashtëm.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vizitoi ambientet e kolegjit për të parë sallat e leksioneve dhe seminareve, laboratorët, zyrat dhe bibliotekën. Diskutimet ndihmuan në qartësimin e procedurave, përgjegjësi dhe gjetjeve. Në të gjitha mbledhjet janë mbajtur procesverbale dhe janë referuar në këtë raport. Në veçanti, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm përgëzon punën e Grupit të Vetëvlerësimit për mundësimin e dokumentacionit dhe informacionit gjithëpërfshirës të bazuar te provat, si dhe stafin akademik e studentët për pjesëmarrjen në takime.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm gjykon se:

Standardet për institucionin e arsimit të lartë - menaxhim, autonomi dhe siguri cilësie janë përmbushur plotësisht. Në arritjen e këtij gjykimi, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi një praktikë të mirë. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstatoi se institucioni menaxhohet në mënyrë efikase në përputhje me ligjin, Statutin dhe Rregulloret shqiptare, dhe se ka bashkëpunime të mira me institucione të tjera shtetërore, si dhe me partnerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë. Pas disa riorganizimeve në profilin dhe strukturën e institucionit, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstatoi se institucioni ka një strukturë të mirorganizuar dhe efektive, që u mundëson studentëve dhe stafit akademik të japin informacion të plotë për procesin akademik dhe administrativ. Institucioni është i një rëndësie të veçantë sa i përket sigurisë civile dhe kombëtare, ndaj, në këtë drejtim, luan një rol të pazëvendësueshëm në përgatitjen e profesionistëve në vend. Standardet për burimet dhe partneritetin janë përmbushur kryesisht. Në arritjen e këtij gjykimi, grupi i vlerësimit të jashtëm identifikoi një karakteristikë të praktikës së mirë, dy pika të dobëta dhe bëri dy rekomandime. AS-ja ofron ambiente të standardeve të larta për stafin, studentët dhe partnerët e saj. Në këtë kontekst, për shkak të specifikitetit që ka, infrastruktura e institucionit konsiderohet si më e plotësuar në vend për arsimimin dhe formimin e specialistëve të sigurisë. Gjithashtu, kampusi ofron mundësi të shumta për aktivitete sportive dhe çlodhëse, ushqim, si dhe akomodim për studentët. Grupi i

Vlerësimit të Jashtëm identifikoi disa hapa të vegjël të ndërmarrë për gjenerimin e të ardhurave nga shërbimet e ofruara, që mund t'i japin institucionit mundësinë të fitojë më shumë të ardhura dhe të tërheqë investime. GVJ-ja e gjykoj keqfunksionimin e sistemeve të menaxhimit të informacionit si problematik për shkak të sulmit kibernetik që ndodhi. Ne rekomandojmë krijimin e një sistemi të pavarur nga sistemet e tjera të përdorura nga Policia e Shtetit ose strukturat e tjera. Standardet për Kurrikulën janë përmbushur plotësisht. Në arritjen e këtij gjykimi, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi karakteristika të praktikës së mirë dhe nuk dha rekomandime. U identifikua një konfirmim lidhur me përpjekjet e ndërmarra për hapjen e programeve të reja të Masterit Profesional për përparimin në karrierë të drejtuesve dhe profesionistëve të Policisë së Shtetit. Standardet për veprimtarinë shkencore/artistike dhe inovacionin janë përmbushur kryesisht.

Për arritjen e këtij gjykimi, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi një praktikë të mirë lidhur me revistën e botuar nga AS-ja, të regjistruar me numër ISSN-je, dy pika të dobëta, si dhe bëri dy rekomandime dhe një konfirmim. Pika e dobët e parë ka të bëjë me mbështetjen e ulët financiare për pjesëmarrje në konferenca, kongrese dhe simpoziume ndërkombëtare, tarifat për dorëshkrimet që do të botohen në revista kombëtare dhe ndërkombëtare dhe faktin që buxheti për projektet kërkimore nuk është i mjaftueshëm. AS-ja duhet të rrisë mbështetjen financiare dhe aplikimet për projektet kërkimore të zakonshme nga thirrjet kombëtare dhe ndërkombëtare, me qëllim rritjen e numrit të projekteve kërkimore ndërkombëtare. Pika e dobët e dytë lidhet me numrin e vogël të mobiliteteve për studentët dhe stafin akademik, përveç disa shkëmbimeve përvojash me pedagogë, me mbështetjen e projektit të BE-së. AS-ja duhet të rrisë mobilitetin e stafit akademik dhe studentëve në të ardhmen, dhe kërkuesit e rinj dhe studentët duhet të mbështeten dhe të përfshihen më shumë në projekte kërkimore dhe në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare nga stafi i nivelit të lartë. GVJ-ja konfirmon se zbatimi i projektit kërkimor kombëtar nga AS-ja, me mbështetjen e AKKSHI-t, është shumë inkurajues.

Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë përmbushur plotësisht. Në arritjen e këtij gjykimi, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dy praktika të mira dhe bëri dy rekomandime. Praktikën e mirë lidhen me kushtet shumë të mira, që u mundësojnë studentëve të kryejnë veprimtari jashtëshkollore, si dhe me normën e lartë të punësimit të studentëve. Rekomandimet lidhen me mundësinë e AS-së për të siguruar platforma për revistat dhe për të rritur fondet për përgatitjen e botimeve të librave mësimorë, dhe gjithashtu me faktin që Zyra e Alumnit duhet të organizojë më shpesh takime zyrtare, për të fuqizuar bashkëpunimin me të diplomuarit. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm gjykon se AS-ja ndjek një politikë mbështetëse për studentët dhe u kushton vëmendje studentëve, duke ofruar infrastrukturë të përshtatshme dhe bursa.

Përmbledhje e gjetjeve

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë:

- AS-ja ka një profil specifik dhe rol të rëndësishëm sa i përket arsimit dhe formimit kombëtar në fushën e sigurisë kombëtare. Strategjia e saj e zhvillimit është harmonizuar dhe hartuar në përputhje me strategjitë e tjera kombëtare të institucioneve përgjegjëse

për sigurinë kombëtare dhe publike. [Standardi I.3]

- Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vlerëson se infrastruktura dhe logjistika e institucionit në lidhje me studentët dhe programet e studimit janë të standardeve të larta sa i përket fushës së institucionit. Disa nga laboratorët, sallat e improvizimit, palestrat, etj., janë unike në nivel kombëtar për shkak të specificitetit dhe natyrës së institucionit. [Standardi II.8, II.9, II.10]

- Botimi i revistës “Policimi dhe Siguria” nga AS-ja, e regjistruar me numër ISSN, është shumë inkurajues, sepse mundëson botimin e punimeve shkencore të kryera nga stafi akademik dhe studentët [Standardi IV.9]

- Kushtet për kryerjen e veprimtarive jashtëshkollore nga studentët janë shumë të mira. [Standardi V.6]

- Norma e punësimit të studentëve që përfundojnë arsimin e lartë të policisë është 100%. [Standardi V.8]

Pikat e dobëta

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi pikat e dobëta të mëposhtme:

- Mungesa e sistemit të menaxhimit akademik të institucionit, i veçuar nga sistemet e trajnimit ose sistemet e përdorura nga Policia e Shtetit. [Standardi II.14].

- Vështirësitë e gjenerimit të të ardhurave nga shërbimet që akademia u ofron palëve të treta, si dhe mënyra e përdorimit të mundshëm të këtyre të ardhurave. [Standardi II.16, II.17, II.18].

- Mbështetja e ulët financiare për pjesëmarrje në konferenca, kongrese dhe simpoziume ndërkombëtare, tarifat për dorëshkrimet që do të botohen në revista kombëtare dhe ndërkombëtare dhe që buxheti për projektet kërkimore nuk është i mjaftueshëm. [Standardi IV.2, IV.3, IV.5].

- Numri i vogël i mobiliteteve për studentët dhe stafin akademik, përveç disa shkëmbimeve përvojash me pedagogët, me mbështetjen e projektit të BE-së. [Standardi IV.14].

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- Grupi i Vlerësimit të Jashtëm sugjeron zbatimin e një sistemi të informacionit të menaxhimit, kushtuar menaxhimit akademik, të veçantë nga sistemet e tjera që përdor Policia e Shtetit, ku studentët mund të aksesojnë të dhëna për programet e tyre të studimit, si syllabusi, plani mësimor, komunikimi, etj. [Standardi II.14]

- GVJ-ja rekomandon që AS-ja të hartojë dhe miratojë udhëzime për gjenerimin dhe përdorimin e të ardhurave financiare në funksion të statusit si institucion i arsimit të lartë. [Standardi II.16, II.17, II.18]

- AS-ja duhet të rrisë mbështetjen financiare dhe aplikimet për projektet kërkimore të zakonshme në thirrjet kombëtare dhe ndërkombëtare, me qëllim rritjen e numrit të projekteve kërkimore ndërkombëtare. [Standardi IV.2, IV.3, IV.5]

- AS-ja duhet të promovojë mobilitetin e stafit akademik dhe studentëve dhe të rrisë mbështetjen ndaj kërkuesve të rinj dhe studentëve, për t'u përfshirë më shumë në projekte kërkimore dhe në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare nga stafi i nivelit të lartë. [Standardi IV.8, IV.14]

- Mundësia e sigurimit të platformave për revistat dhe rritjes së fondeve për përgatitjen e botimit të librave mësimorë. [Standardi V.7]

- Me qëllim fuqizimin e bashkëpunimit me të diplomuarit, Zyra e Alumnit duhet të organizojë më shpesh takime zyrtare. [Standardi V.9]

Konfirmimi i veprimtimit të ndërmarrë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon veprimet aktualisht në proces si më poshtë:

- AS-ja është në procesin e hapjes së programeve të Masterit, duke bërë të mundur jo vetëm përmbushjen e misionit të institucionit, por edhe përparimin e karrierës akademike të të diplomuarve të saj. [Standardi III.17]

- Zbatimi i projektit kërkimor kombëtar nga AS-ja, me mbështetjen e AKKSHI-t, është shumë inkurajues. [Standardi IV.7]

Gjykime përmbledhëse për çdo Fushë Vlerësimi

1. Standardet për Institucionin e Arsimit të Lartë - Menaxhim, Autonomi dhe Sigurim Cilësie janë përmbushur plotësisht.

2. Standardet për Burimet dhe Partneritetin janë përmbushur kryesisht.

3. Standardet për Programet e Studimit, Mësimdhënien dhe Vlerësimin janë përmbushur plotësisht.

4. Standardet për Veprimtarinë Shkencore/Artistike dhe Inovacionin janë përmbushur kryesisht.

5. Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë përmbushur plotësisht.

Gjykim i përmbledhur

Vlerësuesit i rekomandojnë Bordit të Akreditimit se në Akademinë e Sigurisë, Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur kryesisht.

Fusha e vlerësimit 1: Institucioni i Arsimit të Lartë - Menaxhim, Autonomi dhe Sigurim Cilësie

1.1 Akademia e Sigurisë (AS) e kryen veprimtarinë akademike dhe profesionale mbështetur tek aktet ligjore në fuqi, të Statutit të saj, si dhe tek akte të tjera rregullatore të brendshme të miratuara nga organet dhe autoritetet e saj drejtuese. AS-ja është një institucion publik dhe e ka filluar veprimtarinë e saj në vitin 1946, duke ofruar kurse profesionale për oficerët e policisë dhe, në vitin 2005, u kthye në një Akademi. [BM2] Statuti përcakton misionin, strukturat e organizimit dhe të menaxhimit të brendshëm. Përgjegjësitë individuale dhe formale të bordit dhe këshillit janë përcaktuar gjithashtu në rregullore. Bordi i Administrimit dhe Senati Akademik kanë miratuar Statutin për të marrë parasysh Ligjin për Arsimin e lartë, që është konfirmuar edhe nga Ministria përgjegjëse për arsimin e lartë dhe Ministria e Punëve të Brendshme. (A1.1) [Standardi I.1]

1.2 Senati Akademik është organi akademik më i lartë i AS-së, i përbërë nga 4 anëtarë të përzgjedhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe 3 anëtarë të përzgjedhur nga Senati Akademik. AS-ja është organizuar për të siguruar menaxhim të efektshëm në përputhje me kërkesat ligjore dhe Planin e saj Strategjik. Rrjedha e informacionit nga njësitë bazë të Bordit të Administrimit dhe Senati Akademik, dhe

Akademia e Sigurisë, institucion në progres (Akreditimi institucional)

shpërndarja e vendimeve nga organet drejtuese te stafi dhe studentët, janë efikase. Organizimi i menaxhimit dhe administrimit të institucionit, dhe vendimmarrjes kolegjiale, kanë parasysh kërkesat ligjore, zbatohen dhe kuptohen nga personeli në të gjitha nivelet. (A1.8; A1.9) [Standardi I.2]

1.3 AS-ja ka një strategji zhvillimi të përshtatshme. Ajo funksionon bazuar te një strategji zhvillimi 5-vjeçare. Strategjia është përpiluar në përputhje me Misionin dhe objektivat e AS-së, dhe u mor në konsideratë nga organet drejtuese dhe këshillat në faza të ndryshme gjatë hartimit të saj. Departamentet, si njësi bazë, kanë hartuar dhe zbatuar plane veprimi për të përmbushur kërkesat e Strategjisë. Strategjia e zhvillimit e AS-së është parë në kontekstin specifik të mjedisit në të cilin institucioni operon. AS-ja ka një profil të posaçëm dhe rol të rëndësishëm sa i përket arsimit dhe formimit kombëtar në fushën e sigurisë kombëtare dhe strategjia e saj e zhvillimit është e harmonizuar dhe e hartuar në përputhje me strategji të tjera kombëtare të institucioneve përgjegjëse për sigurinë kombëtare dhe publike, që identifikohet si një karakteristikë e praktikës së mirë. (A1.20; A1.21) [Standardi I.3]

1.4 AS-ja siguron që të funksionojë brenda kufizimeve të legjislacionit dhe rregulloreve ekzistuese. Si një institucion publik, qeverisja është e dukshme në njësitë organizative akademike dhe administrative, veprimtaritë e mësimdhënies dhe ato praktike, dhe çështjet financiare dhe administrative. Institucioni ka një zyrë për mbikëqyrje dhe kontroll të brendshëm dhe për nevoja të brendshme mund të angazhojë këshilltarë të jashtëm me përvojë të gjatë, veçanërisht nga Policia e Shtetit. Institucioni është organizuar në mënyrë të atillë që të përfitojë nga financime nga programe të ndryshme dhe nga partnerë kombëtarë e ndërkombëtarë. Megjithatë, për shkak të organizimit specifik, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vërejtë se ekzistojnë vështirësi në respektimin e kufijve të autonomisë institucionale, veçanërisht autonomisë financiare, si një institucion i arsimit të lartë, por ritheksojmë se kjo vjen nga profili i institucionit. (A1.18; A1.22) [Standardi I.4]

1.5 Organet drejtuese mbledhen rregullisht dhe informacioni për pikat e agjendës i vihet paraprakisht në dispozicion të gjithë personelit. Marrëveshjet për funksionimin e këshillave dhe bordeve vendimmarrëse, dhe për të mbështetur diskutimet dhe debatet kolegjiale kuptohen nga stafi dhe studentët. Përgjegjësit e departamenteve kanë detyrë të kryejnë monitorimin vendor të zbatimit të vendimeve të marra nga bordet dhe këshillat e krijuar formalisht. (A1.24; A1.25; A1.26) [Standardi I.5]

1.6 Për paraqitjen e veprimtarive përkatëse, AS-ja përgatit raporte periodike, duke përfshirë dhe raportin vjetor. Raporti pasqyron veprimtaritë e brendshme dhe të jashtme të institucionit. Raporti i veprimtarive u dorëzohet këshillave të institucionit dhe miratohet nga Senati Akademik. Pas miratimit, dokumenti bëhet publik dhe hidhet në faqen e internetit të AS-së. (A1.27; A1.28; A1.30; A1.32) [Standardi I.6]

1.7 Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë luan një rol kyç në monitorimin dhe analizimin e efikasitetit të veprimtarive të vlerësimit të brendshëm. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është projektuar për të zhvilluar dhe zbatuar një mekanizëm, që inkurajon promovimin dhe përvetësimin e një kulture cilësie në të gjitha njësitë dhe nivelet, dhe për të zhvilluar procedura të përshtatshme për monitorimin dhe vlerësimin

e cilësisë akademike. NjSBC-ja ka akses te të gjitha të dhënat e institucionit. Kjo njësi përbëhet nga pedagogë që përfaqësojnë Departamentet e AS-së, një përfaqësues nga njësitë mbështetëse dhe një përfaqësues nga studentët. Sigurimi i brendshëm i cilësisë është një element të cilit AS-ja i ka kushtuar vëmendje të veçantë në vitet e fundit. AS-ja harton politika dhe ngre strukturat përkatëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë, si dhe krijon kushtet për kryerjen e veprimtarisë së vlerësimit dhe sigurimit të jashtëm të cilësisë. (A1.33; A1.34; A1.35) [Standardi I.7]

1.8 AS-ja vlerëson periodikisht programet e formimit dhe studimit për të monitoruar përmbushjen e objektivave të formimit dhe rezultateve të të nxënit sipas rezultateve të sondazheve dhe kërkesave të bëra nga Policia e Shtetit dhe agjencitë e tjera ligjzbatuese. Njësitë bazë, në bashkëpunim me anëtarët e departamenteve, rishikojnë programet e studimit dhe syllabuset përkatëse, në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi, aktet rregullatore të AS-së, dinamikat teknologjike, duke përfshirë vlerësimin e punësimit të studentëve si një nga treguesit matës të performancës së programeve. Në këtë kontekst, njësia bazë propozon ndryshime ndaj portofolit akademik të AS-së, duke e orientuar atë drejt programeve cilësore të kërkuara nga tregu i punës dhe nga Policia e Shtetit ose agjencitë e tjera ligjzbatuese në fushën e sigurisë publike. (A1.39; A1.40; A1.41) [Standardi I.8]

1.9 Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është një zyrë e përhershme në AS, që prej vitit 2017. Ajo ka akses te të gjitha të dhënat e institucionit. Në fillim të çdo viti, NjSBC-ja miraton një plan pune për mbikëqyrjen dhe vlerësimin periodik të veprimtarisë akademike dhe administrative të AS-së. Që prej ngritjes së saj, NjSBC-ja ka kontribuar për përmirësimin e të gjitha aspekteve të procesit mësimor, qoftë sa i përket përmirësimit të kurrikulave dhe syllabuseve, po ashtu dhe përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë vlerëson eficiencën e veprimtarive akademike të institucionit dhe harton raportet përkatëse të vlerësimit të brendshëm. Raportet diskutohen në të gjitha njësitë e institucionit, me synim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë gjatë kryerjes së këtyre veprimtarive në të ardhmen. Megjithatë AS-ja nuk ofron një numër të madh programesh, ajo ka ngritur mekanizma vlerësimi në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm. Si pjesë e strukturës së Policisë së Shtetit, përmirësimi i programit është i vazhdueshëm dhe përfshin aktorë nga shërbimet e sigurisë, palë të tjera interesi dhe institucione partnere. Sipas deklaratave, disa nga rekomandimet janë përfshirë në hartimin e programit të Masterit Profesional, ku pasqyrohen rekomandimet në dobi të njohurive, aftësive dhe kompetencave. (A1.46; A1.48; A1.49) [Standardi I.9]

1.10 Sipas AS-së, përgjegjësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë u përket strukturave organizative të AS-së, të cilat planifikojnë, organizojnë dhe garantojnë zbatimin e politikave, strategjive dhe procedurave në përputhje me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit; Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë - NjSBC, nëpërmjet vlerësimit të efikasitetit të veprimtarive akademike, administrative dhe financiare të institucionit, të ushtruara në AS, me synim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Gjatë vizitës në institucion, përfshirja e personelit dhe studentëve në të gjitha veprimtaritë që kishin të bënin me vlerësimin dhe përmirësimin e programeve të studimit ishte e dukshme. Kryesisht, kjo është realizuar nëpërmjet sondazheve të kryera nga NjSBC-ja, por edhe nëpërmjet diskutimeve në departamente dhe me studentët. Gjithashtu, përfshirja e partnerëve, si Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe

Akademia
e Sigurisë,
institucion
në progres
(Akreditimi
institucional)

partnerët nga agjencitë e tjera ligjzbatuese, është shumë e rëndësishme në këtë proces. Gjatë takimit të zhvilluar me partnerët, ata shprehën qartë se mbajnë kontakte të vazhdueshme me AS-në për hartimin e kurrikulave dhe për ndryshimet e mundshme në kuadër të një përshtatjeje më të mirë me nevojat e sigurisë publike dhe nevojat e agjencive ligjzbatuese. (A1.50-A1.53) [Standardi I.10]

1.11 Të gjitha veprimtaritë në kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë së programeve të studimit janë publike, transparente dhe të efektshme. Megjithatë gjatë periudhës së vizitës sistemet e TI-së nuk ishin të aksesueshme për shkak të sulmit kibernetik ndaj sistemeve qeveritare, institucioni publikon vazhdimisht informacione, duke përfshirë dhe informacione nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë vlerëson eficiencën e veprimtarive akademike, administrative dhe financiare të institucionit dhe harton raportet përkatëse të vlerësimit të brendshëm. Raportet diskutohen në të gjitha njësitë e institucionit, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së këtyre veprimtarive në të ardhmen dhe marrjen e masave të përshtatshme për mangësitë e identifikuar gjatë vlerësimit. AS-ja organizon veprimtari periodike me personelin akademik përgjegjës dhe studentët, për t'i informuar dhe ndërgjegjësuar për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë afatgjatë të programit të studimit. (A1.7; A1.34; A1.54-A1.56) [Standardi I.11].

Gjetje

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë:

- AS-ja ka një profil specifik dhe rol të rëndësishëm sa i përket arsimit dhe formimit kombëtar në fushën e sigurisë kombëtare. Strategjia e saj e zhvillimit është harmonizuar dhe hartuar në përputhje me strategjitë e tjera kombëtare të institucioneve përgjegjëse për sigurinë kombëtare dhe publike. [Standardi I.3]

Pikat e dobëta

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi.

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk dha asnjë rekomandim.

Konfirmimi i veprimit të ndërmarrë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk bëri asnjë pohim.

Gjykimi

Standardet për Menaxhimin, Autonominë dhe Sigurimin e Cilësisë janë përmbushur plotësisht.

Fusha e vlerësimit 2: Burimet dhe Partneriteti

2.1 AS-ja ka hartuar politika efektive për rekrutimin e personelit. Struktura organizative diskutohet dhe miratohet nga Senati Akademik dhe nga Bordi i

Administrimit. Në faqen e internetit është publikuar një seksion rreth rekrutimit [BM7, BM8]. Rolet e personelit akademik dhe administrativ janë paraqitur në detaj brenda strukturës së përgjithshme të miratuar. Rekrutimi në njësitë akademike mbështetet nga nevojat për çdo departament, programi i studimit dhe kurrikulat, dhe nëse roli është me kohë të plotë apo të pjesshme. Vendet vakante publikohen në faqen e internetit. Procesi i rekrutimit për personelin mësimdhënës dhe administrativ ndjek të njëjtin proces të përcaktuar në Statut dhe në Rregullore, që marrin në konsideratë legjislacionin përkatës. Për vlerësimin e aplikimeve të kandidatëve ngrihet një komision, që kryen vlerësim në bazë të meritave individuale dhe kontrata e punësimit nënshkruhet nga Rektori. (A2.1; A2.2; A2.3) [Standardi II.1]

2.2 AS-ja është e angazhuar ndaj zbatimit të politikave të integritetit të personelit akademik dhe administrativ, që përcaktohen në Statut, Rregullore dhe në Strategjinë e Zhvillimit. I gjithë personeli akademik përfshihet në procesin e vlerësimit. Personeli akademik merr pjesë në një sërë veprimtarish, si workshop-e, aktivitete trajnimi në terren dhe organizime sociale, krahas mësimdhënies dhe punës praktike. Në bashkëpunim me Policinë e Shtetit, studentët dhe personeli akademik marrin pjesë në veprimtari jashtëshkollore dhe aktivitete sociale. AS-ja ndjek një politikë me qasje integruese ndaj personelit, që konsiderohet si një aset kyç i veprimtarisë së përditshme të Akademisë. Në praktikë, kjo qasje mundësohet nëpërmjet organizimit të veprimtarive të përbashkëta të personelit akademik dhe atij administrativ, si: pjesëmarrja e përbashkët në trajnime personeli, workshop-e, vizita studimore, aktivitete kombëtare, etj. (A2.4-A2.8) [Standardi II.2]

2.3 Objektivat strategjike të zhvillimit të personelit përcaktohen në Strategjinë e Zhvillimit dhe AS-ja ndjek një politikë të trajnimit në vazhdimësi të personelit në përputhje me këta objektiva. Personelit akademik i ofrohet mbështetje për pjesëmarrje në veprimtari formuese në institucione të tjera ndërkombëtare të ngjashme. Vlerësimi i aftësive të personelit kryhet nga departamenti përgjegjës, nga studentët dhe nga NjSBC-ja. Ai mund të kryhet në formën e kontrolleve periodike gjatë procesit mësimor, si dhe në formën e shqyrtimit të raporteve të punës kundrejt syllabuseve. Opinioni dhe vlerësimi nga studentët konsiderohen si aspekte shumë të rëndësishme. Ky vlerësim shprehet nëpërmjet formularëve të përgatitur në kuadër të vlerësimit të performancës, kryesisht si sondazhe. Nga ana tjetër, vlerësimi i aftësive dhe kompetencave të personelit dhe trajnuesve të AS-së kryhet nga drejtuesit e drejtorive dhe shërbimeve policore, ku këto vlerësime përfshihen në dosjen personale të punonjësve. (A2.4; A2.9-A2.11) [Standardi II.3]

2.4 AS-ja ka organizuar një sërë aktivitete për të nxitur dialogun social ndërmjet personelit, studentëve dhe komunitetit të përgjithshëm. Disa shembuj përfshijnë aktivitete sociale në bashkëpunim me Kryqin e Kuq, ose organizata të tjera në mbështetje të fëmijëve dhe familjarëve të oficerëve të policisë të rënë në detyrë. Personeli akademik është përfshirë në konferenca dhe workshop-e të ndryshme, ndërsa studentët janë angazhuar me institucione vendase dhe ndërkombëtare në fushën e sigurisë publike. Zyra e Burimeve Njerëzore e trajton të gjithë personelin e Akademisë në përputhje me Kodin e Punës dhe legjislacionin përkatës në fuqi. (A2.12-A2.15) [Standardi II.4]

2.5 Personeli akademik i AS-së është specifik dhe në përputhje me natyrën dhe fushën funksionale të këtij institucioni. Kryesisht, personeli akademik zotëron grada dhe tituj të akorduar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi (Personeli i AS-së u nënshtrohet testeve të ndryshme fizike dhe psikologjike përpara punësimit dhe më pas, në mënyrë periodike). Për AS-në, ky është akreditimi i parë institucional. Pavarësisht kësaj, gjatë viteve është treguar se personeli akademik ka një nivel qarkullimi të ulët, nën 30%. Duke qenë i vetmi institucion në fushën e sigurisë dhe shërbimeve policore, mundësitë për lëvizjen e personelit në institucione të tjera të të njëjtit profil për zhvillim në karrierë janë të kufizuara. Kjo shpjegon dhe arsyen përse AS-ja ka një nivel të ulët qarkullimi të personelit akademik prej 30%. AS-ja respekton dhe përmbush detyrimet dhe përgjegjësitë kontraktuale përkatëse (financiare, të sigurimeve shoqërore dhe kodit të punës) për personelin akademik. Fusha e përgjithshme dhe specifike e studimeve të personelit akademik të përfshirë në njësitë bazë përputhet me profilin e lëndëve. Akademia siguron lidhjet ndërmjet kategorive të personelit akademik, moshës, përvojës, etj., në mënyrë të tillë që garanton vijimësinë dhe shkëmbimin e përvojave ndërmjet brezave në zhvillimin e komunitetit bazë. [BM7] Gjithashtu, respektohen edhe kriteret ligjore për numrin, kualifikimin dhe raportin student/personel akademik. (A2.18) [Standardi II.5]

2.6 Sikurse u përmend më sipër, vlerësimi i aftësive të personelit kryhet në mënyra të ndryshme. Ai kryhet nga eprori i drejtpërdrejtë, përgjegjësi i departamentit ose përgjegjësi i zyrës, si dhe nga studentët dhe NjSBC-ja. Gjithashtu, NjSBC-ja kryen një vlerësim të vazhdueshëm të ecurisë së të nxënës, mbikëqyrje për kontrollin e provimeve, përputhshmërinë e mësimdhënies me përmbajtjen e përcaktuar të kursit dhe mundësimin e materialeve shtesë, si literatura ose leksionet. AS-ja i kushton vëmendje të veçantë përfshirjes dhe transparencës, duke organizuar mbledhje në nivel departamenti, në rektorat, anketa personeli rreth çështjeve të ndryshme për diskutim, identifikim problemesh, nevojash, marrje të opinionit të personelit për akte të ndryshme rregullatore, etj. (A2.19-A2.22) [Standardi II.6]

2.7 AS-ja e ushtron veprimtarinë e saj në një kampus universitar me sipërfaqe 8.4 ha dhe 20 godina, në Tiranë. Ambientet janë lehtësisht të aksesueshme me transport publik dhe ndodhen larg qendrave industriale. Godinat janë të izoluara siç duhet dhe me furnizim të rregullt elektriciteti dhe uji, me sisteme ajri të kondicionuar, të izoluara ndaj zhurmës dhe të pajisura me shkallë dhe dalje emergjence [Turi]. Ambientet e disponueshme përmbushin kërkesat ligjore dhe ofrojnë kushte të përshtatshme dhe funksionale për zhvillimin e një procesi akademik dhe mjedisi pune cilësor. E gjithë infrastruktura fizike, godinat dhe mjediset janë pjesë të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe ruhen e mirëmbahen si çdo aset dhe pronë publike. AS-ja është përgjegjëse për mirëmbajtjen dhe kujdesin për to. (A2.23-A2.31) [Standardi II.7]

2.8 Akademia e Sigurisë ka një strukturë të plotë që përmbush jo vetëm standardet dhe kriteret e cilësisë, por edhe standarde të tjera lidhur me sigurinë dhe aspekte të tjera. Gjatë vizitës, pamë klasat, zyrat dhe të gjitha ambientet që AS-ja ofron. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vlerëson se infrastruktura dhe logjistika e institucionit në lidhje me studentët dhe programet e studimit janë të standardeve të larta sa i përket fushës së institucionit. Disa nga laboratorët, sallat e improvizimit, palestrat, etj., janë unike në nivel kombëtar

për shkak të specificitetit dhe natyrës së institucionit dhe nevojës për të cilën përdoren. (A2.23-A2.31; Turi) [Standardi II.8]

2.9 Sikurse u përmend në standardet e mësipërme, AS-ja ka hapësira dhe godina të mjaftueshme në dispozicion. Institucioni ofron kushte të mira pune, të sigurta për personelin akademik dhe studentët. Gjithashtu, laboratorët dhe sallat e leksionit/ushtrimeve janë të pajisura me pajisjet e nevojshme për procesin mësimor, si laptopa, kompjutera, projektor dhe akses në internet nëpërmjet Wifi-t. AS-ja ofron ambiente dhe për personelin akademik, për personelin administrativ, dhe salla mbledhjesh, salla kompjuterike, multimedia, etj. Institucioni ka vendosur në dispozicion ambiente mësimore të ndërtuara (ose rikonstruktura) me materiale bashkëkohore cilësore, që përmbushin kushtet higjienike dhe sanitare për studentët dhe personelin akademik e administrativ, duke shmangur elementet e rrezikshme. Institucioni mundëson infrastrukturë, logjistikë dhe akses të pakufizuar për kategoritë e personave me aftësi të kufizuara që vizitojnë institucionin, prandaj, në Akademinë e Sigurisë nuk ka studentë me nevojë të veçanta. (A2.33) [Standardi II.9]

2.10 AS-ja është një institucion publik i posaçëm dhe ofron programe studimi vetëm në fushën e sigurisë publike. Për pjesën praktike të secilit program studimi, institucioni përdor laboratorë, si Salla Taktike, Poligoni, STAZ-i, etj. Secili ambient laborator ka manualin përkatës, që u vendoset në dispozicion personelit akademik dhe studentëve. (A2.34-A2.36) [Standardi II.10]

2.11 Godinat e AS-së ndodhen brenda një kompleksi universitar dhe rrethohen nga hapësira/kopshte të gjelbra të vogla, të pajisura me stola dhe kosha mbeturinash. Hapësira përfshin vende parkimi, hapësirë çlodhëse (parqe të vogla), një bar-kafe, hapësirë për konsum ushqimi, Qendër Shëndetësore, fushë futbollit dhe disa palestra. (A2.37-A2.41) [Standardi II.11]

2.12 Ambientet e AS-së mirëmbahen rregullisht nga sektori i mirëmbajtjes, i përbërë nga kopshtarë, hidraulikë, elektrikistë, etj., si dhe nëpërmjet marrëveshjeve me palë të treta për vlerësimin vjetor të ambienteve të AS-së. Këto ambiente janë në përdorim të vazhdueshëm nga personeli akademik dhe studentët. Aty ata kryejnë veprimtarinë laboratorike, punojnë me detyrat e caktuara nga pedagogët, si dhe zhvillojnë punë që mund t'u shërbejnë në praktikën e tyre të pavarur. AS-ja i kushton vëmendje të konsiderueshme zhvillimit të praktikave laboratorike. Çdo laborator është i pajisur me rregullat përkatëse të sigurisë teknike. AS-ja e vlerëson gjendjen e infrastrukturës në shërbim të studentëve dhe personelit nëpërmjet anketave. Institucioni ofron infrastrukturë dhe shërbime me profil të veçantë (poligone), që janë të vlerësuara dhe certifikuar nga organizata dhe institucione të tjera. [BM2] (A2.42-A2.44) [Standardi II.12]

2.13 AS-ja ka një trashëgimi të fuqishme akademike dhe kulturore dhe arkivon botimet e stafit akademik dhe tezat e diplomës të hartuara nga studentët. Arkiva e Akademisë ruan të gjitha dokumentacionet fizike. Gjithashtu, AS-ja përdor një sërë sistemesh elektronike, pjesë të Policisë së Shtetit. Institucioni ka një bazë të dhënash për regjistrimin e studentëve, numrat e matricimit, etj., në përputhje me aktet nënligjore

në fuqi, por që nuk shërben vetëm për qëllime akademike. AS-ja mban regjistrin themeltar të studentëve, të dhënat dhe regjistrat e tyre personale gjatë formimit dhe ciklit Bachelor. Vlerësimet e kryera gjatë programit të studimit dhe të dhënat e tjera të marra bashkë me suplementin e diplomës përdoren për përparimin e karrierës në polici [BM3, BM9]. Në Akademi gjenden sisteme menaxhimi për të siguruar kujdesin dhe ruajtjen e të gjithë dokumentacionit dhe informacionit, që përfshijnë dhe të dhënat e studentëve të mbajtura nga Sekretaria Mësimore. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstatoi se ambientet e ruajtjes dhe arkivimit në biblioteka dhe formë elektronike përmbushin pritshmëritë për sektorin sa i përket funksionalitetit të brendshëm. (RVV; A1.14; Turi) [Standardi II.13]

2.14 AS-ja, si pjesë e Policisë së Shtetit, zotëron një sistem për menaxhimin e informacionit, që bën të mundur komunikimin e informacioneve, si: statistikë, kalendari i sezoneve të provimeve, rezultatet dhe mbledhjet e punës. Institucioni përdor programe, sisteme menaxhimi dhe rrjete komunikimi të brendshëm (intranet) nëpërmjet infrastrukturës së Policisë së Shtetit. Sistemet e informacionit mundësojnë akses dhe shërbime të posaçme për personelin, studentët dhe bashkëpunëtorët. Sistemet informatike dhe të menaxhimit ofrojnë statistika dhe informacione në kohë reale rreth veprimtarive, treguesve dhe treguesve në nivel institucioni, programi dhe veprimtarie. [BM2, BM5, BM7, BM8, BM9] Gjatë vizitës në ambient, për shkak të sulmit kibernetik ndaj qeverisë, shumë nga sistemet ishin jofunksionale, duke përfshirë faqen e internetit të institucionit. Gjatë takimeve me studentët, personelin dhe personelin mbështetës u diskutua edhe ndihma që këto sisteme u ofrojnë atyre. Megjithatë AS-ja përdor një numër të madh sistemesh, ato janë pjesë e Policisë së Shtetit, ndaj, shfaqet mungesa e përdorimit të një sistemi menaxhimi akademik të veçantë nga sistemet e trajnimit ose sistemet e përdorura nga Policia e Shtetit. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm sugjeron zbatimin e një sistemi të informacionit të menaxhimit, kushtuar menaxhimit akademik, të veçantë nga sistemet e tjera që përdor Policia e Shtetit, ku studentët mund të aksesojnë të dhëna për programet e tyre të studimit, si syllabusi, plani mësimor, komunikimi, etj. (A2.46; A2.47) [Standardi II.14]

2.15 AS-ja ka ndërmarrë zhvillimin e infrastrukturës së saj digjitale në mbështetje të të nxënës të studentëve dhe zhvillimit profesional të personelit akademik. Si rrjedhojë, shumica e veprimtarive institucionale janë të disponueshme në formë elektronike në sistemin bibliotekar dhe në një platformë të të nxënës elektronik, të krijuara për të lehtësuar të nxënës në distancë. AS-ja ofron një gamë laboratorësh kompjuterikë, të pajisur me harduerët e nevojshëm për të mbështetur të nxënës e studentëve dhe procesin mësimor në tërësi. Sipas RVV-së, në ambientet e AS-së gjenden shërbime interneti dhe laboratorë kompjuterikë në shërbim të personelit dhe studentëve. AS-ja përdor në mënyrë efektive teknologjinë e informacionit në funksion të arsimit e formimit në distancë, etj. Për këtë qëllim, janë mbajtur një sërë trajnimesh, me përfshirjen e ekspertëve ndërkombëtarë, të cilët shfrytëzojnë sisteme të avancuara të arsimit në distancë, nga vende si Estonia dhe Finlanda. Sektori i TI-së në AS, si dhe ai në Policinë e Shtetit, e trajnojnë rregullisht personelin e AS-së rreth shërbimeve të teknologjisë së informacionit që ofrohen. Megjithatë, gjatë vizitës, GVJ-ja konstatoi probleme lidhur me aksesin në sistemet e TI-së, për shkak të sulmit kibernetik të ndodhur, prandaj, thuajse të gjitha sistemet ishin mbyllur për arsye sigurie dhe hetimi. (RVV; A2.46; A2.48) [Standardi II.15]

2.16 AS-ja ushtron autonomi financiare në përputhje me rregullat dhe standardet financiare të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe Policisë së Shtetit. Buxheti i AS-së përcaktohet në përputhje me strukturën e Policisë së Shtetit, sipas parashikimit të Urdhrit të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë. Bordi Administrativ diskuton dhe miraton buxhetin e propozuar të AS-së. Buxheti diskutohet në të gjitha bordet dhe komitetet përkatëse në Njësitë Bazë dhe në Senatën Akademik. Transparenca garantohej nëpërmjet diskutimit të çështjeve financiare në Bordin Administrativ. Sipas RVV-së, çdo vit akademik, AS-ja i nënshtrohet auditimit financiar të kryer nga strukturat e kontrollit të Policisë së Shtetit dhe raportet përkatëse bëhen publike. Raportet e auditimit të Policisë së Shtetit për AS-në shqyrtohen nga Bordi i Administrimit. GVJ-ja identifikoi vështirësi në gjenerimin e të ardhurave nga shërbimet që akademia u ofron palëve të treta, si dhe në mënyrën e përdorimit të mundshëm të këtyre të ardhurave (si miratimi i përdorimit të të ardhurave dytësore). Për këtë arsye, GVJ-ja rekomandon që AS-ja të hartojë dhe miratojë udhëzime për gjenerimin dhe përdorimin e të ardhurave financiare në funksion të statusit si institucion i arsimit të lartë. [B9] (A2.50- A2.58) [Standardi II.16, II.17, II.18]

2.17 Bazuar te specifikat përkatëse, AS-ja ka një rrjet partnerësh në nivel kombëtar dhe rajonal, që përfshin institucione të arsimit të lartë, organe publike dhe agjenci ligjzbatuese. Ndërkombëtarizimi është përfshirë si një veçori kryesore në Strategjinë e Zhvillimit, bashkërisht me nevojat e Policisë së Shtetit. Studentët, personeli akademik, të diplomuarit dhe përfaqësuesit e Policisë së Shtetit treguan për lidhje të forta ndërmjet organizatave vendore dhe atyre rajonale. AS-ja ka një numër të madh bashkëpunimesh në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar me institucione dhe partnerë në fushën e veprimtarisë së saj. [Standardi II.16, II.17, II.19]. (BM5; BM7; BM9) [Standardi II.19] Gjithashtu, AS-ja ka lidhur marrëveshje partneriteti me institucione shtetërore dhe private në nivel vendor dhe ndërkombëtar, në fushën e sigurisë publike, në kuadër të ofrimit të shërbimeve ndaj studentëve dhe sigurimit se programet përkatëse të studimit do të përmirësohen dhe përshtaten për të përmbushur nevojat dhe pritshmëritë e tyre. Mbikëqyrja e marrëveshjeve të partneritetit drejtohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe nga secila Njësi Bazë. AS-ja ka lidhur marrëveshje partneriteti edhe me institucione, si Instituti i Policisë Shkencore dhe Institucioni i Mjekësisë Ligjore, me qëllim mundësimin e njohurive praktike për studentët përkatës, që lidhen drejtpërdrejt me fushën e tyre të studimit. (A2.61; A2.62) [Standardi II.20]

2.18 Akademia ka lidhur një sërë marrëveshjesh formale që i mundësojnë personelit dhe studentëve të marrin pjesë në veprimtari ndërkombëtare, si konferencat, kongreset, simpoziumet, etj. Në bazë të kuotave të caktuara nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, studentët mund t'i transferojnë studimet e tyre jashtë vendit në institucionet me të cilat AS-ja ka lidhur marrëveshje formale. Gjithashtu, sipas personelit akademik [BM7], AS-ja ndjek një politikë për integrimin e personelit akademik të ftuar dhe studiuesve të huaj. AS-ja mirëpret profesorë të huaj në kuadër të marrëveshjeve institucionale për zbatimin e procesit mësimor, kryesisht për programet e formimit profesional. Ndërkohë, GVJ-ja konstatoi se mobiliteti i studentëve dhe personelit ka gjasë të rritet, duke u bazuar te bashkëpunimet me institucionet dhe partnerët e tjerë, si BE-ja, OSBE-ja, NATO-ja, OBSH-ja, etj., si dhe me misionet e bashkëpunimit me policinë e huaj, si PAMECA, FRONTEX, MAPE, ICITAP, CEPOL,

Akademia e Sigurisë, institucion në progres (Akreditimi institucional)

etj. (A2.63; A2.64) [Standardi II.21]

2.19 Sikurse përmendet në këtë raport, bazuar te specifikat e këtij institucioni, nevojat për hapjen dhe përshtatjen e programeve të studimit burojnë drejtpërdrejt nga analiza dhe nevojat e brendshme të Policisë së Shtetit dhe agjencive të tjera ligjzbatuese në vend. Kjo analizë është kryer nga grupet e posaçme të përbëra nga anëtarë të Policisë së Shtetit dhe AS-së. Sipas personelit akademik dhe studentëve [BM5, BM7], kohët e fundit, Këshilli i Ministrave ka nisur një program të ri arsimit profesional trevjeçar për punësimin e studentëve të ekselencës në administratën shtetërore. Ky program u ofron studentëve të ekselencës që kanë përfunduar ciklin e parë dhe të dytë të studimeve (në fushat: jurisprudencë, ekonomik, teknologji informacioni) mundësinë të punësohen në strukturat e Policisë së Shtetit si oficerë policie, pas përfundimit të programit. Deri më tani, 135 studentë ekselence kanë përfunduar programin (2019-2022) dhe janë caktuar në struktura të ndryshme të policisë. (RVV; A2.65; A2.66) [Standardi II.22]

Gjetje

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë:

- Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vlerëson se infrastruktura dhe logjistika e institucionit në lidhje me studentët dhe programet e studimit janë të standardeve të larta sa i përket fushës së institucionit. Disa nga laboratorët, sallat e improvizimit, palestrat, etj., janë unike në nivel kombëtar për shkak të specificitetit dhe natyrës së institucionit dhe nevojës për të cilën përdoren. [Standardi II.8, II.9, II.10]

Pikat e dobëta

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi pikat e dobëta të mëposhtme:

- Mungesa e sistemit të menaxhimit akademik të institucionit, i veçuar nga sistemet e trajnimit ose sistemet e përdorura nga Policia e Shtetit. [Standardi II.14];
- Vështirësitë në gjenerimin e të ardhurave nga shërbimet që akademia u ofron palëve të treta, si dhe mënyra e përdorimit të mundshëm të këtyre të ardhurave (si miratimi i përdorimit të të ardhurave dytësore). [Standardi II.16, II.17, II.18]

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- Grupi i Vlerësimit të Jashtëm sugjeron zbatimin e një sistemi të informacionit të menaxhimit, kushtuar menaxhimit akademik, të veçantë nga sistemet e tjera që përdor Policia e Shtetit, ku studentët mund të aksesojnë të dhëna për programet e tyre të studimit, si syllabusi, plani mësimor, komunikimi, etj. [Standardi II.14]
- GVJ-ja rekomandon që AS-ja të hartojë dhe miratojë udhëzime për gjenerimin dhe përdorimin e të ardhurave financiare në funksion të statusit si institucion i arsimit të lartë. [Standardi II.16, II.17, II.18]

Konfirmimi i veprimit të ndërmarrë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk bëri asnjë pohim.

Fusha e vlerësimit 3: Programet e studimit, Mësimdhënia dhe Vlerësimi

3.1 AS-ja është një institucion unik në Republikën e Shqipërisë, që ofron programe në fushën e sigurisë publike dhe operon në përputhje të plotë me Misionin e saj të përcaktuar në Statut. AS-ja ofron programe që përputhen me nevojat e tregut të punës dhe nevojat e Policisë së Shtetit. Misioni i AS-së dhe objektivat e përcaktuar në strategjinë e zhvillimit të institucionit përcaktojnë qartë, përkatësisht, diplomën me të cilën studenti pajiset dhe mundësitë e punësimit. Akademia harton programe studimi, objektivat e të cilave përputhen me misionin dhe strategjinë e zhvillimit, dhe që janë në përmbushje të nevojave të institucioneve të sigurisë publike. (A3.1-A3.4) [Standardi III.1]

3.2 Strategjia e Zhvillimit e AS-së mbështetet te burime të ndryshme informacioni, studime tregu dhe mënyra të tjera komunikimi me organizatat shtetërore, për të bashkërenduar programet përkatëse me dinamikat dhe nevojat vendore për profesionistët e aftë. Gjatë krijimit dhe përmirësimit të programeve të saj, AS-ja merr parasysh edhe strategji të tjera kombëtare, si Strategjia Kombëtare e Sigurisë; Strategjia Ndërsëktoriale e Sigurisë në Komunitet; Strategjia kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda, etj. (A1.7.1; A3.4; A3.6) [Standardi III.2]

3.3 AS-ja e ushtron veprimtarinë e saj sipas sistemit të Bolonjës dhe përkon me Nivelin 6, 7 dhe 8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, në përputhje me Ligjin nr. 10247, datë 04.03.2010 “Për kornizën shqiptare të kualifikimeve”, i ndryshuar, dhe përafron Nivelin 6 dhe 7 të Sistemit të Bolonjës. Rezultatet e të nxëniet të programeve të studimit të AS-së përkojnë me Nivelin e kualifikimit 6 dhe 7 (që është nën licensim), dhe AS-ja ka infrastrukturën dhe personelin akademik të nevojshëm për arritjen e këtyre rezultateve të të nxëniet. Objektivat e të nxëniet përcaktohen qartë edhe në syllabuse. Aftësitë, objektivat dhe mundësitë e punësimit të programeve të studimit përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit (A3.23; A3.29) [Standardi III.3].

3.4 Institucioni ka krijuar procedura për miratimin e programeve të reja të studimit, të parashikuara qartë në aktet nënligjore dhe rregulloret. Procedurat për hapjen dhe miratimin e programeve të reja të studimit përcaktohen në Statut dhe rregulloren specifike, ku njësia bazë dhe Senati Akademik luajnë një rol thelbësor, në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit të AS-së. Në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, dhe me aktet rregullatore të AS-së dhe Policisë së Shtetit, AS-ja përfshin ekspertë nga institucione ose shërbime të ndryshme gjatë hartimit të programeve të reja (projektimi i programeve të Masterit Profesional). Institucioni i zhvillon në mënyrë analitike kriteret dhe miraton kuotat e pranimit të studentëve duke u mbështetur te studimet/nejat e tregut të punës dhe kapacitetet përkatëse. (A3.11-A3.13) [Standardi III.4]

3.5 Institucioni ka infrastrukturë dhe logjistikë të përshtatshme dhe respekton plotësisht kërkesat dhe standardet ligjore për zhvillimin e programeve të studimit. AS-ja ka krijuar një politikë punësimi dhe zbaton kriteret transparente për punësimin e

personelit akademik dhe mbështetjen e personelit administrativ. Politika e punësimit bazohet te dispozitat e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, si dhe tek aktet rregullatore të AS-së, konkretisht te Statuti dhe statusi i veçantë. Gjatë vizitës, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konfirmoi funksionimin e këtyre procedurave. Sa u përket kapaciteteve të personelit, AS-ja ka punësuar personel akademik dhe administrativ të aftë dhe të mirëpërgatitur. Në veçanti, personeli akademik përfshin një ndërthurje të personelit të nivelit të ulët dhe të lartë, që përgjithësisht janë edhe pjesë e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Gjithashtu, bazuar edhe te statusi i veçantë, numri i personelit me kohë të plotë dhe të pjesshme përputhet me kërkesat ligjore (A2.16; A3.14-A3.16; BM8) [Standardi III.5]

3.6 Programet e studimit të ofruara nga AS-ja respektojnë kuadrin shqiptar sipas Ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” (Ligji për Arsimin e lartë). Programet e studimit bazohen te Sistemi i Bolonjës i transferimit të krediteve ECTS, duke bërë të mundur mobilitetin e studentëve në programe të ngjashme studimi. Aktualisht, AS-ja ofron vetëm programe të ciklit të parë (Bachelor) dhe ka aplikuar për ciklin e dytë (në proces licensimi). Secili program studimi në AS është organizuar në kurrikula që përfshijnë të gjitha elementet, në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 41, datë 24.01.2018, i ndryshuar. (A3.3; A3.17; A3.18) [Standardi III.6]

3.7 Programet e studimit të AS-së janë projektuar për t’i pajisur studentët me njohuritë e nevojshme për të punuar në fushën e sigurisë publike. Këto kërkesa janë përcaktuar në bashkëpunim me Policinë e Shtetit dhe agjencitë e tjera ligjzbatuese në vend. Duke marrë në konsideratë personelin mësimor të përgatitur, infrastrukturën e përshtatshme dhe kurrikulat, studentët në AS mund të fitojnë njohuri dhe aftësi praktike dhe t’i zbatojnë ato në botën reale. [BM2, BM3] AS-ja ofron programe të ndryshme formimi, për përvetësimin e njohurive teorike dhe praktike gjithëpërfshirëse dhe të specializuara në një fushë punësimi, në një gamë të gjerë profesioneve dhe specializimesh në fushën e sigurisë. Këto programe formimi u ofrojnë studentëve dhe një gamë të gjerë aftësish konjitive dhe praktike, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve në mënyrë krijuese gjatë shërbimit në Policinë e Shtetit dhe në shërbimet e tjera të sigurisë publike. Aktualisht, AS-ja ofron vetëm një program Bachelor (Bachelor në “Siguri dhe hetim”), që luan një rol të rëndësishëm për përparimin në karrierë në Policinë e Shtetit, ndërkohë që është bërë dhe aplikimi për Masterin Profesional në “Rend dhe Siguri publike” në ministri për marrjen e licensimit. Studentët informohen dhe udhëzohen lidhur me mundësinë e transferimit të programeve të studimit ose krediteve të fituara gjatë zhvillimit të tyre (A3.3; A3.10; A3.19; A3.20) [Standardi III.7]

3.8 Bazuar te profili i institucionit, programet e formimit janë pjesë e veprimtarisë së AS-së. Të gjitha programet e formimit janë miratuar nga AS-ja në bashkëpunim me Policinë e Shtetit, duke u bazuar te nevojat e përparimit në karrierë dhe ngritjes në kategori, që janë të lidhura me arsimin e lartë policor. AS-ja detajon format e zhvillimit të këtyre programeve në rregulloret dhe në planet e miratuara nga dy departamentet e edukimit në vazhdim, FSH-ja dhe KLFP-ja, në bashkëpunim me drejtoritë përkatëse në Policinë e Shtetit. Programet e formimit dhe edukimit në vazhdim rishikohen dhe përmirësohen në bazë vjetore. Ndjekja e procedurave të vlerësimit dhe sigurimit të

cilësisë së këtyre programeve përcaktohet qartë në rregulloret e departamenteve të edukimit në vazhdim dhe njësisë kryesore. (RVV; A1.17; A3.10; A3.21) [Standardi III.8]

3.9 AS-ja është një institucion publik i posaçëm, dhe programet e studimit të saj fokusohen te siguria publike, që përkon me Nivelin 5 (programet e formimit), 6 (programi Bachelor) dhe 7 (programi Master në proces licensimi) në Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve. AS-ja kryen veprimtari kërkimi të aplikuar në masën e nevojshme për ofrimin dhe zhvillimin cilësor të programeve të studimit. Elementet e kërkimit shkencor janë përfshirë në procesin mësimor. Krahas kësaj, AS-ja, me synimin për të përditësuar kualifikimin shkencor të personelit akademik që do të angazhohet në programet e ciklit të parë, kryen vlerësime periodike të personelit të brendshëm dhe të jashtëm, duke u orientuar drejt përzgjedhjes së personelit me rangun më të lartë policor dhe titujt shkencorë më të lartë. Puna kërkimore e personelit akademik përcaktohet nga Departamenti sipas akteve rregullatore të AS-së. (RVV; A3.15) [Standardi III.9]

3.10 IAL-ja e zbaton monitorimin e programeve të studimit nëpërmjet strukturave organizative të brendshme, Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjSBC) në bashkëpunim me drejtoritë përkatëse të Policisë së Shtetit dhe agjencitë ligjzbatuese. Në kuadër të sigurimit të jashtëm të cilësisë, AS-ja i nënshtrohet vlerësimit të jashtëm institucional dhe të programeve të studimit, në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm. Në fillim të çdo viti, AS-ja, nëpërmjet NjSBC-së, miraton një plan pune dhe kryen mbikëqyrje periodike të zbatimit të planeve të programeve të studimit. Krahas kësaj, AS-ja ndjek edhe kriteret e tjera të posaçme për vlerësimin e performancës akademike të personelit, të përcaktuara nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe Policia e Shtetit. Personeli akademik ka për detyrë të përditësojë periodikisht përmbajtjen dhe literaturën e moduleve lëndore, duke pasqyruar kërkimin individual në kurrikul dhe vërejtjet e studentëve. (RVV; A3.23-A3.25) [Standardi III.10]

3.11 AS-ja përmirëson rregullisht programet e studimit, ku përfshihet përditësimi i kurrikulave, infrastruktura dhe labororët, për të krijuar një mjedis të nxëni të frytshëm. Këto ndryshime bazohen te zhvillimet e reja teknologjike dhe te nevojat e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit. NjSBC-ja ka hartuar një pyetësor për studentët, për të parë se si e vlerësojnë ata punën e secilit pedagog në mësimdhënie, në të gjithë komponentët, si leksionet, puna praktike dhe labororët. Ky pyetësor shpërndahet në fund të semestrit, dhe vërejtjet merren parasysh gjatë rishikimit dhe përditësimit të programeve të studimit. (A1.14; A1.49-A1.51) [Standardi III.11]

3.12 Sa i përket përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies, AS-ja ka një politikë të qartë të institucionalizuar nëpërmjet akteve nënligjore dhe rregulloreve. AS-ja ka ngritur NjSBC-në si një organ kryesor përgjegjës për monitorimin e cilësisë së mësimdhënies dhe performancës. Për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, AS-ja mbështet edhe zhvillimin e personelit akademik nëpërmjet programeve të ndryshme të trajnimit dhe në projekte të ndryshme në bashkëpunim me agjenci ligjzbatuese ndërkombëtare. (A1.7; A3.27; BM7). [Standardi III.12]

3.13 Programet e AS-së organizohen në lëndë, të vlerësuara me kredite (ECTS). Programi përfshin elementet e strukturës dhe veprimtari formuese të përcaktuara qartë

sipas VKM-së nr. 41, datë 24.01.2018, e ndryshuar. Fakulteti i Sigurisë koordinon veprimtarinë e personelit akademik për të garantuar koherencën e përmbytjes dhe e monitoron atë periodikisht. Gjithashtu, AS-ja mundëson kapacitete të mjaftueshme për formimin praktik dhe profesional për studentët, si puna laboratorike, modulet laboratorike, palestrat, praktika profesionale, mbështetja për stazhe dhe punë kërkimore, përgatitja për projekte, tema diplomash, etj. [Turi]. Institucioni u vendos studentëve në dispozicion literaturën mbështetëse të nevojshme për programin e studimit. Programi i studimit i ofruar nga AS-ja zbatohet në përputhje me strukturat e miratuara në nivel institucional dhe kombëtar, si Ministria e Punëve të Brendshme, agjencitë ligjzbatuese dhe Policia e Shtetit. Programi i studimit ofrohet me kohë të plotë. (A3.1; A3.3) [Standardi III.13].

3.14 Institucioni ofron një program studimi që i pajis studentët me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për zbatimin praktik të kurseve teorike. Programet e studimit të AS-së në fushën e sigurisë publike dhe hetimit të krimeve janë organizuar në mënyrë të tillë që mundëson zbatimin praktik të aftësive teorike të përvetësuara nga studentët gjatë ciklit të studimit. Në programet e ciklit të dytë, “Master Profesional” (në proces licensimi), parashikohet që studentët do të përfshihen në veprimtari kërkimore, në fushën përkatëse të programit. [BM7] AS-ja ndjek politika mbështetëse për veprimtaritë e studentëve, që pasqyrojnë veprimtaritë mësimore në funksion të formimit praktik dhe profesional, si punët laboratorike, ushtrimet, detyrat/projektet kërkimore, si dhe praktikat profesionale në fushë. AS-ja i ka dhënë rëndësi të veçantë organizimit të praktikës profesionale, duke u mundësuar studentëve ta kryejnë atë në mënyrën e duhur, brenda afatit kohor të parashikuar në kalendarin akademik, falë bashkëpunimit me strukturat e Policisë së Shtetit. Studentët ndiqen në vazhdimësi nën drejtimin e një pedagogu të caktuar nga departamenti përkatës. Institucioni pritës, bazuar te politikat e veta, cakton një oficer policie, i cili mbikëqyr studentët gjatë orëve të praktikës profesionale. (RVV; A1.53; A3.1; A3.3; A3.32) [Standardi III.14]

3.15 Mjedisi i mirë i të nxënit (infrastruktura dhe laboratorët), personeli i përshtatshëm dhe kurrikulat e mirëhartuara, të bazuara te nevojat konkrete të përmendura në këtë raport, mundësojnë bazën për Misionin e programeve të studimit lidhur me garantimin e përfshirjes aktive të studentëve në përvetësimin e kompetencave. Sistemi i dyfishtë i AS-së, i ndërthurur me aspekte të mira teorike të mësimdhënies dhe njohuri dhe aftësi praktike, u mundëson studentëve/të diplomuarve të përshtaten lehtësisht me përgjegjësitë e tyre gjatë ushtrimit të detyrës. Stafi pedagogjik i AS-së është certifikuar nëpërmjet trajnimit dhe takimeve të mundësuar nga Projekti i Binjakëzimit i AS-së me institucione arsimore të ngjashme dhe IAL-të jopolicore nga Finlanda dhe Estonia, realizuar nga BE-ja. Ndër të tjera, ky projekt synon ngritjen e kapaciteteve mësimore të AS-së, sikurse përmendet në Raport Progresin e BE-së për Shqipërinë, 2021. (RVV; A3.33-A3.35) [Standardi III.15]

3.16 AS-ja ka zhvilluar programe studimi në fushën e sigurisë publike dhe të diplomuarit janë punësuar në forcat e Policisë së Shtetit ose në agjenci të tjera ligjzbatuese. AS-ja ka mundësuar infrastrukturë dhe personel akademik të përshtatshëm, dhe ka ofruar mundësi zhvillimi profesional për personelin akademik, që reflektohet në performancë mësimore më të mirë dhe u bën të mundur studentëve përvetësimin e aftësive praktike. Nga ana tjetër, njohuritë dhe aftësitë praktike bëjnë të mundur që

studentët të kenë performancë dhe përshtatje më të mirë në detyrë. (A3.1; A3.3) [Standardi III.16]

3.17 Programet e studimit janë projektuar në përputhje me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) dhe në përputhje me standardet evropiane të fushës së studimit (parashikimet e Kartës së Bolonjës) dhe promovojnë mobilitetin e studentëve shqiptarë dhe ndërkombëtarë [BM2]. AS-ja është në procesin e hapjes së programeve të Masterit, duke bërë të mundur jo vetëm përmbushjen e misionit të institucionit, por edhe përparimin e karrierës akademike të të diplomuarve të saj. (A1.1) [Standardi III.17]

3.18 AS-ja ka përcaktuar një sërë rregulloresh që parashikojnë qartë modalitetet, rregullat dhe kërkesat për vlerësimin e njohurive, veçanërisht provimet dhe riprovimet që studentët duhet të japin. Ato përfshijnë procedura dhe rregulla për hartimin e tezave, monitorimin dhe fshehtësinë e provimeve, të drejtën e studentit për të hyrë ose jo në provim, dhe vlerësimin e studentëve. Mbrojtja e diplomës është detyrimi përfundimtar për diplomimin e studentëve. Mbrojtja kryhet nëpërmjet dorëzimit të tezës së diplomës ose provimit. Për të gjitha këto procedura, studentët informohen rreth rregulloreve dhe procedurave lidhur me provimet dhe diplomimin. Me përfundimin e programit të studimit, studentët pajisen me diplomë dhe me suplementin e diplomës të miratuar nga strukturat kombëtare përgjegjëse. (A1.2; A1.3; A1.17; 3.1; A3.23; BM5) [Standardi III.18]

3.19 Institucioni ofron një infrastrukturë të mirë, me laboratorë të posaçëm për të mbështetur programet e studimit dhe për të kryer orët e praktikës. AS-ja ka njësi të përshtatshme mësimore dhe administrative, si laboratorët, Poligonin, Sallën Taktike, ambientet e jashtme, palestrën, pajisjet dhe mjetet, bibliotekat dhe njësitë e tjera që kryejnë studime. (RVV; A2.34) [Standardi III.19]

3.20 Institucioni mundëson pajisje laboratorike të përshtatshme, krahas infrastrukturës dhe shërbimeve për mbështetjen e programeve të studimit. Institucioni i ka përmirësuar vazhdimisht laboratorët sipas kërkesave të pedagogut të secilës lëndë, të paraqitura në Departament. Personeli akademik që punon në laboratorë zotëron kapacitete dhe përvoja teknike. Akademia ka në dispozicion laboratorët e Teknologjisë së informacionit, Poligonin dhe ambientet e brendshme dhe të jashtme për aktivitete fizike. Secili laborator ka përcaktuar rregullat përkatëse të sigurisë teknike, që përbëjnë një element thelbësor për kryerjen e orëve të praktikës. Secili ambient laboratorik i ka vendosur në dispozicion personelit akademik manualin përkatës. Të gjitha zyrat e personelit akademik dhe administrativ janë pajisur me kompjutera dhe akses tek infrastruktura mbështetëse, si printerët, fotokopjet dhe skanerët. Institucioni ka edhe një muze rreth historikut të Policisë së Shtetit që prej fillësës së saj, që u shërben studentëve për të njohur zhvillimin e policisë shqiptare. (A2.25; A2.26; A2.38; A2.39) [Standardi III.20]

3.21 AS-ja ka ambiente dhe infrastrukturë biblioteka të përshtatshme, si dhe shërbime që ofrojnë akses në literaturë fizike lidhur me fushat e studimit të programeve dhe kërkimin. Biblioteka ofron materiale mësimore dhe kërkimore. Organizimi dhe funksionimi i Bibliotekës rregullohet nga rregullorja e veçantë e shpallur në ambient, krahas orarit të punës. Megjithatë, ofrohet dhe akses te literatura në internet nëpërmjet

Akademia
e Sigurisë,
institucion
në progres
(Akreditimi
institucional)

bibliotekave digjitale në internet, përveç bibliotekës së universitetit (U-Library). (A5.19)
[Standardi III.21]

Gjetje

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë.

Pikat e dobëta

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi.

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk dha asnjë rekomandim.

Konfirmimi i veprimit të ndërmarë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon veprimet aktualisht në proces si më poshtë:
- AS-ja është në procesin e hapjes së programeve të Masterit, duke bërë të mundur jo vetëm përmbushjen e misionit të institucionit, por edhe përparimin e karrierës akademike të të diplomuarve të saj. [Standardi III.17]

Gjykimi

Standardet për Programet e Studimit, Mësimdhënien dhe Vlerësimin janë përmbushur plotësisht.

Fusha e vlerësimit 4: Veprimtaria Shkencore/Artistike dhe Inovacioni

4.1 AS-ja ka përcaktuar qartë në Strategjinë e Zhvillimit dhe në Strategjinë për Veprimtarinë Kërkimore dhe Zhvillimore prioritetet e veprimtarisë së saj kërkimore dhe shkencore, në përputhje me fushën e sigurisë publike, me kapacitetet burimore që zotëron, dhe me llojin e profilit të kërkuar (A4.1; A1.7; f. 6). AS-ja ka harmonizuar prioritetet strategjike të kërkimit dhe zhvillimit sipas prioritetëve afatgjatë rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare. Përcaktimi i prioritetëve bazohet te dokumentet strategjike kryesore të Policisë së Shtetit, te prioritetet kombëtare të strategjive të ndryshme, te dokumentet strategjike të AS-së, si dhe te temat e përcaktuara çdo vit nga njësitë përkatëse (RVV, f. 35, A4.2; BM2). Në fillim të vitit, njësia kryesore dhe ato bazë informojnë dekanin dhe rektorin për prioritetet e tyre në përputhje me prioritetet institucionale për kërkimin shkencor (A4.3; BM3). Kërkimi shkencor dhe zhvillimi bazohen edhe tek idetë që vijnë nga aktorët e tjerë, si Policia e Shtetit, agjencitë e tjera ligjzbatuese në fushën e sigurisë, institucionet e arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit, etj. (A4.4; BM9). Megjithatë përcaktimi i prioritetëve dhe dokumenteve strategjike të kërkimit shkencor në fushën e sigurisë publike kryhet nëpërmjet një diskutimi të hapur dhe përfshirës me njësitë kryesore dhe ato bazë, strukturat e Policisë së Shtetit dhe agjencitë e tjera ligjzbatuese (RVV, f. 35, A4.1; A1.7) [Standardi IV.I].

4.2 AS-ja zotëron mekanizmat dhe mjetet e nevojshme për të zbatuar prioritetet e përcaktuara në dokumentet strategjike për kërkimin shkencor (A4.5), por zbatimi i tyre nuk është në nivel të kënaqshëm për shkak të mungesës së buxhetit, sepse personeli akademik përfshihet kryesisht në mësimdhënie dhe më pak në kërkim (BM3), por edhe për shkak të mungesës së studimeve në nivel MSc (BM2, BM3, BM7). AS-ja organizon konferenca, simpoziume, takime, projekte kërkimore, botime shkencore, etj. (A4.2, BM2; BM3; BM7), por nevojitet më shumë financim për kërkimet shkencore të zakonshme, si dhe fonde për pjesëmarrjen e personelit akademik në konferenca, simpoziume ndërkombëtare, etj. (BM3, BM7). AS-ja promovon kërkimin shkencor nëpërmjet personelit akademik të ri, të kualifikuar në kërkim shkencor, në përputhje me profilin e sigurisë publike, hetimit të krimit, jurisprudencës, dhe njësitë bazë kyç (A2.1; RVV f. 35-36). Strukturat e njërive bazë janë organizuar në grupe kërkimore që përputhen me profilin kërkimor të fushës së sigurisë dhe kërkimit (A4.6; BM7), dhe mundësojnë infrastrukturën e përshtatshme që nevojitet për realizimin e projekteve kërkimore, konferencave, botimeve shkencore, përdorimin e instrumenteve kërkimore shoqëruese me sondazhe/intervista/pyetësorë, etj. (A4.23; A2.39, BM3; BM7). Kërkimi që kryhet, bazohet kryesisht te mbledhja e të dhënave nga baza të ndryshme të dhënash, në lidhje me tema të caktuara, që kryesisht botohen në revistën e AS-së (BM3; BM7). AS-ja, në bashkëpunim me Policinë e Shtetit, ka krijuar një sistem efikas mbështetës për kërkimin dhe transferimin e njohurive dhe për zbatimin e teknologjive të reja nëpërmjet Qendrës së Kërkimit Shkencor (QKSh) [A4.6], që promovon veprimtarinë kërkimore-shkencore të Akademisë brenda dhe jashtë vendit. AS-ja i boton të gjitha materialet e konferencave nëpërmjet sektorit të botimeve të QKSh-së, që gëzon atributet e një shtëpie botuese për marrjen e numrave ISBN (A4.7; BM3; BM7) [Standardi IV.2].

4.3 AS-ja mbështet dhe inkurajon personelin akademik dhe departamentet për kërkimin dhe projektet shkencore nëpërmjet informimit dhe trajnimit (A4.8; A4.4; BM3; BM7). Fondet për projektet kërkimore janë të pamjaftueshme. Personeli akademik merr pjesë në konferenca vetëm me ftesë, por kur shkojnë vetë edhe shpenzimet i mbulojnë vetë (BM7). Aktualisht, personeli akademik nuk mbështetet financiarisht për të marrë pjesë në konferenca ndërkombëtare dhe për botimin e punimeve shkencore (BM7). AS-ja e mbështet personelin nëpërmjet organizimit të aktiviteteve orientuese rreth programeve evropiane të kërkimit shkencor dhe duke organizuar konferenca, workshop-e, leksione të hapura, trajnim shkencor, etj. (A4.9; A4.10; BM7). Institucioni bashkëpunon me organizata shkencore vendase dhe ndërkombëtare, si: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Akademia e Studimeve Albanologjike, AKKSH-ja, Akademia e Forcave të Armatosura, Akademia e Kosovës për Siguri Publike, Universiteti i Romës "Tor Vergata", Universiteti i Tiranës dhe Universiteti i Durrësit. Gjithashtu, dhe me akademitë policore dhe universitetet e: Finlandës, Estonisë, Italisë, Turqisë, Austrisë, Gjermanisë, etj. (RVV, f. 36, A2.60; BM2; BM5). Krahës kësaj, AS-ja bashkëpunon me organizata ndërkombëtare të rëndësishme në nivel botëror, si BE-ja, OSBE-ja, NATO-ja, OSSH-ja, etj., si dhe me misionet e huaja të bashkëpunimit policor, si PAMECA, FRONTEx, MAPE, ICITAP, CEPOL, etj. (RVV, f. 36, A4.10; BM2; BM5). [Standardi IV.3].

Akademia e Sigurisë, institucion në progres (Akreditimi institucional)

4.4 AS-ja ka mekanizma tregues për vlerësimin e performancës së kërkimit të njërive kryesore, bazë, grupeve kërkimore dhe studiuesve të posaçëm shkencorë, dhe i ruan këto të dhëna në një bazë të dhënash (RVV, f. 37). Bazuar te këto të dhëna, sektori i

kontrollit të kurrikulës dhe cilësisë kryen raportime të vazhdueshme tek institucionet përkatëse lidhur me ecurinë e veprimtarisë shkencore (A4.12; A2.65; BM5; BM7). Vlerësimi i arritjeve dhe performancës në fushën e kërkimit shkencor për secilin vit akademik kryhet nëpërmjet analizave, monitorimit dhe treguesve cilësorë dhe sasiorë, që publikohen për palët e interesit (A4.13; BM7). Njësitë bazë përgatisin raporte vjetore për ecurinë e studimeve dhe kërkimit shkencor të personelit akademik (A3.16), më pas, NjSBC-ja, bazuar te këto rezultate, harton raportin vjetor në nivel institucioni (A2.65), që përfshin botimet, konferencat dhe projektet kombëtare dhe ndërkombëtare të fituara nga personeli akademik, etj. (A3.16; BM5) [Standardi IV.4].

4.5 Rezultatet e kërkimit shkencor të kryer së fundmi nga AS-ja, tendencat dhe gjetjet e konstatuara nga veprimtaritë shkencore, kryesisht nga konferencat dhe disa projekte, u vendosen në dispozicion institucioneve të interesuara, si Policia e Shtetit, agjencitë ligjzbatuese në fushën e sigurisë dhe disa institucioneve të tjera (A4.14; BM9). AS-ja i boton të gjitha materialet e konferencave, projekteve, kërkimit, etj., nëpërmjet sektorit të botimeve të QKSh- së dhe në revistën e indeksuar me numër ISSN-je, “Policimi dhe Siguria”. Këto botime shkencore ndjekin një politikë të qartë për mbrojtjen e pronësisë intelektuale, qoftë në versionet fizike, po ashtu dhe në ato elektronike (A4.12; A4.15). Gjithashtu, të gjitha arritjet teorike në fushën e kërkimit shkencor, që AS-ja ua mundëson palëve të interesit në fushën e sigurisë publike, janë pa përfitime financiare. Për të rritur ndikimin social të veprimtarive kërkimore-shkencore, AS-ja bashkëpunon me agjenci dhe organizata vendase dhe të huaja. (A4.10; A4.16). AS-ja është i vetmi institucion në Shqipëri që ofron dhe kryen kërkime shkencore në fushën e sigurisë publike, dhe mbështetet nga një buxhet vjetor i caktuar nga PSh-ja, që nuk varet nga sigurimi i të ardhurave financiare nëpërmjet punës kërkimore dhe shërbimeve të tjera financiare (A2.50; A2.55; BM3). AS-ja ka bërë një kërkesë për sigurimin e të ardhurave nga trajnimet që organizon për zjarrfikësit, punonjësit e burgjeve, policinë bashkiake, dhe për gjenerimin e fondeve nëpërmjet kërkimit shkencor dhe projekteve të ndërmarra nga personeli akademik (BM3). Buxheti sigurohet nëpërmjet Policisë së Shtetit, dhe nuk alokohet buxhet nga Ministria e Arsimit (BM2; BM3). Pavarësisht kësaj, bazuar te buxheti i vitit 2022, fondet e alokuara për kërkimin shkencor janë të pamjaftueshme (BM6), dhe u deklarua se shuma për kërkimin dhe botimin është rreth 50.000 euro, ose 10.14% e buxhetit total (BM3; BM8). Megjithatë, GVJ-ja identifikoi mungesë mbështetjeje financiare për pjesëmarrje në konferenca, kongrese dhe simpoziume ndërkombëtare, tarifa për dorëshkrimet që do të botohen në revista kombëtare dhe ndërkombëtare dhe që buxheti për projektet kërkimore nuk është i mjaftueshëm dhe inkurajon rritjen e buxhetit për kërkimin vitin e ardhshëm (BM3). GVJ-ja rekomandon që AS-ja të rrisë mbështetjen financiare dhe aplikimet për projektet kërkimore të zakonshme në thirrjet kombëtare dhe ndërkombëtare, me qëllim rritjen e numrit të projekteve kërkimore ndërkombëtare. [Standardi IV.5]

4.6 Në AS, departamenti është njësia bazë për zhvillimin e mësimit dhe për punën kërkimore-shkencore, që përfshin fushat kërkimore shoqëruese dhe grupet e disiplinave mësimore përkatëse (A4.17; A1.18; BM3; BM7). Departamenti organizohet në grupe mësimore dhe kërkimore, që mund të jenë të përhershme ose të përkohshme (A4.6). Misioni i secilit departament është të promovojë, koordinojë dhe administrojë veprimtaritë mësimore dhe kërkimore, duke respektuar liritë akademike të personelit akademik dhe

të drejtën e tyre për të përdorur burimet materiale dhe financiare të disponueshme (A1.18). Në AS, departamenti, bashkërisht me grupet kërkimore, është promovues i veprimtarive të kërkimit shkencor, studimeve, botimeve dhe projekteve. Krahas kësaj, u ngrit dhe QKSh-ja si njësi koordinuese në funksion të proceseve kërkimore-shkencore (A4.17; A4.18; BM3). Gjatë vitit dhe në fund të secilit vit akademik, QKSh-ja raporton në Rektorat dhe në Senat Akademik mbi veprimtarinë kërkimore-shkencore, ku kryhen vlerësimet përkatëse (A4.19; BM3). QKSh-ja promovon veprimtarinë kërkimore-shkencore të Akademisë brenda dhe jashtë vendit (A4.16; A4.20; BM3; BM7). Përgjegjësi i departamentit harton programin vjetor dhe planin financiar të veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore dhe ia dorëzon njësisë kryesore, që i dërgon ato për miratim (RVV, f. 38, A4.21; BM7). Departamentet dhe grupet kërkimore bashkëpunojnë me organizata shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, si: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Akademia e Studimeve Albanologjike, AKKSH-ja, Akademia e Forcave të Armatosura, Akademia e Kosovës për Siguri Publike, Universiteti i Romës "Tor Vergata", Universiteti i Tiranës dhe Universiteti i Durrësit. Gjithashtu, bashkëpunojnë dhe me akademitë e policisë dhe universitetet e Finlandës, Estonisë, Italisë, Turqisë, Austrisë, Gjermanisë, etj. (RVV, f. 38; A2.60). Është tepër inkurajuese që, nga dy aplikime të AS-së për projekte shkencore me mbështetjen e AKKSHI-t, 1 prej tyre është vlerësuar pozitivisht (BM7) [Standardi IV.6].

4.7 Në të gjitha njësitë kryesore të AS-së mbahen diskutime të hapura, në të cilat shkëmbehen opinione me personelin akademik për të zhvilluar dhe miratuar objektivat vjetorë kryesorë të kërkimit shkencor (RVV, f. 38; BM3; BM7). Këta objektiva kryesorë mbështeten duke u bazuar te dokumentet strategjike kryesore dhe përshkruhen në planin e zhvillimit (A1.7; A4.22). Departamentet zbatojnë objektivat e miratuar nga njësitë kryesore, të cilat përcaktojnë detyrimet përkatëse të personelit akademik nëpërmjet planit vjetor të kërkimit shkencor (A4.23). AS-ja, nëpërmjet planifikimit vjetor, përcakton raportin ndërmjet veprimtarisë mësimore dhe veprimtarisë së kërkimit shkencor, administrative, etj., dhe mundëson infrastrukturën e nevojshme për realizimin e tyre në vijimësi (A4.24; Vizita orientuese). Me qëllim përmbushjen e objektivave në fushën e kërkimit shkencor, AS-ja ka ngritur grupe pune për zhvillimin e projekteve, studimeve, konferencave, etj. (A4.25). Një shembull i mirë është zbatimi i projektit "Siguria në Komunitet në Kontekstin e Fatkeqësive Natyrore", i mbështetur nga AKKSHI (BM3; BM7). Me qëllim ofrimin e kontributit, ekspertizës dhe përvojës së tyre, janë kryer dhe bashkëpunime shkencore me organizata ndërkombëtare të rëndësishme në nivel botëror, si: BE-ja, OSBE-ja, NATO-ja, OBSH-ja, etj., si dhe me misione të huaja bashkëpunimi policor, si: PAMECA, FRONTEX, MAPE, ICITAP, CEPOL, etj. (A4.10; BM2; BM3; BM7; BM8; Vizita orientuese) [Standardi IV.7].

4.8 Në shtatë vitet e fundit, AS-ja ka fuqizuar veprimtarinë kërkimore-shkencore (RVV, f. 39), bazuar te numri i veprimtarive kërkimore, numri i studiuesve të përfshirë dhe te bashkëpunimi në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar (A4.26). Megjithatë, AS-ja zotëron personel akademik dhe infrastrukturë për ta fuqizuar më tej veprimtarinë kërkimore-shkencore në të ardhmen, dhe buxheti për veprimtarinë kërkimore-shkencore duhet të planifikohet. AS-ja po inkurajon organizimin e konferencave shkencore të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare në fushat me prioritet dhe rëndësi të veçantë për AS-në (A4.27; A4.10; BM2; BM3; BM7; BM8). Personeli akademik është angazhuar

nëpërmjet shpalljeve dhe konferencave të ndryshme. AS-ja ka organizuar konferenca në bashkëpunim me Universitetet e Vlorës dhe Tiranës. Konferenca e fundit u mbajt në dhjetor të 2021-shit (BM7). Studentët nuk janë shumë të përfshirë në veprimtarinë kërkimore-shkencore, vetëm në disa projekte dhe duke marrë pjesë në disa konferenca dhe botime shkencore (A4.28; BM5; BM7). Gjatë viteve të fundit, AS-ja ka organizuar shtatë konferenca ndërkombëtare dhe gjashtë konferenca kombëtare, punimet e plota të së cilave janë botuar. Gjithsej, AS-ja ka 25 vëllime botimesh të indeksuara me numër ISBN dhe ISSN (duke përfshirë revistën “Policimi dhe Siguria”), që përfshijnë rreth 600 autorë, me mbi 5 mijë faqe botimesh shkencore (RVV, f. 39; A4.29; BM3; BM7). Në të ardhmen, AS-ja duhet t’i mbështesë dhe përfshijë më shumë studiuesit e rinj dhe studentët në projekte kërkimore dhe në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare. Krahas kësaj, duhet të merret në konsideratë numri i pedagogëve të huaj që mund të prezantojnë metoda të reja kërkimore [Standardi IV.8].

4.9 Botimet e AS-së janë të shtypura dhe të postuara në format elektronik në faqen e internetit të AS-së, që është krijuar që prej hapjes së akademisë dhe mirëmbahet e pasurohet me informacione nga QKSh-ja (RVV, f. 39; A4.30; A4.31), por nuk ka qenë funksionale kohët e fundit për shkak të sulmit kibernetik. AS-ja i ka shprehur qartë prioritetet në formën e strategjive dhe politikave të lidhura me publikimin e rezultateve të kërkimit shkencor dhe me veprimtari të ndryshme, si projektet ose konferencat kombëtare dhe ndërkombëtare (A4.1; A1.7; BM2; BM7). AS-ja boton një revistë shkencore të titulluar “Policimi dhe Siguria”, e regjistruar me numër ISSN, që siguron botimin e punimeve shkencore nga personeli akademik, studentët dhe studiues nga institucione të tjera me të cilat AS-ja bashkëpunon, dhe konsiderohet si një karakteristikë e praktikës së mirë (RVV, f. 40). Botimet në këtë revistë shkencore kryhen pa pagesë (A4.32; BM3; BM7; BM8). AS-ja posedon bazën elektronike të të dhënave të botimeve shkencore të personelit akademik dhe ua mundëson atë personelit akademik, studentëve, partnerëve shkencorë, etj. (A4.31; A4.12). Nëpërmjet Akademisë Kombëtare të Shkencave, sektori i botimeve përditëson arkivin e bibliotekës me botimet shkencore të personelit akademik, ku ia shpërndan këto botime të reja Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë, Bibliotekës së Akademisë së Forcave të Armatosura dhe Arkivit Qendror Shtetëror, etj. (RVV, f. 40; A4.16; A4.33) [Standardi IV.9].

4.10 Nëpërmjet QKSh-së, AS-ja kontrollon cilësinë e kërkimit shkencor, dhe QKSh-ja ka miratuar një rregullore të veçantë që trajton standardin e cilësisë së veprimtarive kërkimore dhe shkencore (RVV, f. 50). Gjithashtu, ajo përcakton mekanizma të tjerë vlerësimi lidhur me cilësinë e botimeve, versioneve të botimeve dhe punimeve shkencore në nivel institucional (A4.34; A4.11). QKSh-ja ngre komisione, borde editoriale dhe grupe vlerësimi, ku marrin pjesë specialistë të huaj, në bazë të nevojave, për të siguruar cilësinë e punimeve shkencore të botuara nga AS-ja (RVV, f. 40; BM7). Revista shkencore periodike “Policimi dhe Siguria” e AS-së e zhvillon veprimtarinë botuese bazuar te rregulloret për botimin; kjo revistë ka një bord editorial, që përfshin dhe profesorë të huaj (BM5; BM7). Për çdo konferencë kombëtare dhe ndërkombëtare ngrihen komitete organizative dhe shkencore, me personalitete akademike nga brenda dhe jashtë vendit (RVV, f. 40; BM7; BM8). Për botime monografike të ndryshme, vlerësimet kryhen në nivel departamenti nëpërmjet grupeve të vlerësimit (A4.35; A4.11). Këshilli i Etikës në AS është funksional dhe mbështetet te rregulloret e brendshme

(A1.16; BM6). Për promovimin e kulturës kërkimore, AS-ja ka ngritur borde editoriale shkencore me personalitete në fushën e sigurisë publike nga vendet e rajonit dhe BE-së (A4.29). Gjatë procesit përgatitor dhe të vlerësimit të botimit të materialeve shkencore të paraqitura në revista, konferenca ose në veprimtari të tjera shkencore, AS-ja përdor sisteme kundër plagjiaturës, si dhe mekanizma të tjerë vetëkontrolli për të shmangur plagjiaturën dhe respektuar të drejtat e pronësisë intelektuale (RVV, f. 41), por AS-ja nuk ka një program të sajën kundër plagjiaturës (BM5; BM6; BM70). Për çdo botim shkencor, AS-ja njofton personelin akademik lidhur me cilësinë e botimeve, plagjiaturën, të drejtën e autorit dhe përgjegjësitë ligjore përkatëse të çdo pale dhe individi (RVV, f. 41; A4.36). AS-ja, nëpërmjet QKSh-së, harton dhe zbaton politika për etikën në kërkimin shkencor dhe monitoron zbatimin (A4.1; A4.11), por nuk ka sisteme për kontrollin e plagjiaturës, megjithëse personeli akademik mendon se fusha është specifike dhe nuk ka raste plagjiature (BM3; BM7). Megjithatë, në të ardhmen planifikohet të kryhet ndërgjegjësim rreth plagjiaturës dhe të mundësohet një program (BM6). Pavarësisht kësaj, një nga profesorët u shpreh se është lidhur marrëveshje me Universitetin e Tiranës për përdorimin e programit të tij të plagjiaturës (BM7) [Standardi IV.10].

4.11 Personeli akademik merr pjesë, boton dhe referon punimet e kryera në të paktën një aktivitet kombëtar me karakter kërkimor (seminar, konferencë, workshop ose simpozium) gjatë vitit akademik (RVV, f. 41; BM3; BM7). Personeli akademik i AS-së e prezanton punën shkencore në konferenca të ndryshme vjetore, që organizohen nga AS-ja ose duke marrë pjesë në aktivitete të përbashkëta me institucione të tjera arsimore (A4.12). Gjithashtu, personeli akademik përgatit dhe libra mësimorë dhe autorizon leksione, bazuar te një proces i miratuar nga njësia kryesore (A4.37; BM3). AS-ja, në aktet rregullatore, ka përcaktuar veprimtaritë e kërkimit shkencor, kriteret që duhen ndjekur nga personeli akademik dhe ecurinë e veprimtarive kërkimore (A4.23; A1.17). Megjithatë, është dekurajuese që AS-ja nuk mbështet pjesëmarrjen e personelit akademik në konferenca, simpoziume, etj., dhe nuk ofron mbështetje financiare për personelin akademik që boton punime në revista kombëtare dhe ndërkombëtare (BM7) [Standardi IV.11].

4.12 AS-ja ka lidhur një sërë marrëveshjesh partneriteti dhe ka kryer bashkëpunime në fushat e kërkimit shkencor dhe sigurisë publike dhe sigurimit me institucione të huaja homologe të arsimit të lartë, institute kërkimore, agjenci dhe organizata ndërkombëtare të rëndësishme (OSBE, OBSH, NATO, BE, etj.) OECD-në, dhe vendet e BE-së dhe G20-s (RVV, f. 41; A4.10; A2.60). AS-ja ka marrë pjesë edhe në thirrje ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor, në bashkëpunim me institucione të tjera, si dhe në bashkëpunim rajonal (A4.38). AS-ja organizon konferenca ndërkombëtare dhe aktivitete në fushën e kërkimit shkencor, në partneritet me partnerë ndërkombëtarë (RVV, f. 41). Në bashkëpunim me partnerët, AS-ja organizon një konferencë shkencore ndërkombëtare vjetore; QKSh-ja kryen aktivitete me vendet e BE-së në kuadër të projekteve të binjakëzimit, si projekti me universitetet policore të Finlandës dhe Estonisë (A4.29; A4.39; A4.40; BM3; BM5; BM6). Personeli akademik merr vazhdimisht pjesë në konferenca dhe aktivitete kërkimore-shkencore ndërkombëtare në fushën e sigurisë (A4.29; BM5; BM7). Institucioni mbështet zhvillimin e kërkimit shkencor në fushat prioritare, të përcaktuara pjesërisht nga kapacitetet infrastrukturore dhe njerëzore (RVV, f. 41) [Standardi IV.12].

4.13 AS-ja fton personel akademik të huaj, të specializuar në fusha specifike, si kibernetika, kriminalistika, antiterrorizmi, balistika etj., për periudha të kufizuara kohore, kryesisht për trajnime dhe veprimtari kërkimore dhe mësimore afatshkurtra (RVV, f.42; A2.11). Personeli akademik i AS-së është përfshirë në grupe pune dhe në zbatimin e projekteve me institucione homologe në Finlandë dhe Estoni, në kuadër të një projekti të BE-së; gjithashtu, pati përfshirje edhe në programe të caktuara në vende të ndryshme partnere (A4.41; BM5; BM7) [Standardi IV.13].

4.14 AS-ja, bazuar te kuotat e përcaktuara nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, u jep studentëve mundësinë e studimit jashtë vendit (A4.42). AS-ja mirëpret profesorë të huaj në kuadër të marrëveshjeve institucionale për zbatimin e procesit mësimor, kryesisht për programet e formimit profesional (A4.43). GVJ-ja konstatoi se numri i mobiliteteve për studentët dhe stafin akademik është i vogël, përveç disa shkëmbimeve përvojash me pedagogë, me mbështetjen e projekteve të BE-së (BM3) AS-ja duhet të rrisë mobilitetin e personelit akademik dhe studentëve në të ardhmen (BM3; BM7) [Standardi IV.14].

4.15 Prioritetet e kërkimit shkencor përditësohen në përputhje me zhvillimet e reja në fushën e sigurisë publike, me nevojat e Policisë së Shtetit dhe agjencive ligjzbatuese që bashkëpunojnë me AS-në, si dhe me nevojat e sfidat përkatëse të fushës për vendin dhe rajonin (A4.1; A 1.7). Veprimtaria kërkimore orientohet nëpërmjet dokumenteve strategjike kryesore dhe cilësia e ecurisë vlerësohet periodikisht, për të gjykuar mbi efikasitetin e zbatimit të strategjisë (A1.33; A1.34). AS-ja ka nënshkruar disa marrëveshje bashkëpunimi me institucione kombëtare dhe ndërkombëtare të arsimit të lartë, si dhe me një sërë institucionesh të edukimit policor, me qëllim rritjen e reputacionit institucional, ngritjen e kapaciteteve të personelit akademik, si dhe për të përmirësuar veprimtarinë e personelit akademik [A4.10; A 2.60]. Megjithatë, bashkëpunimi duhet të përmirësohet në të ardhmen, me fokus të shtuar te veprimtaritë kërkimore [Standardi IV.15].

4.16 Në AS përdoren metoda dhe mekanizma cilësorë dhe sasiorë për vlerësimin e kërkimit shkencor nëpërmjet QKSh-së (A4.13; A4.19; A4.44). AS-ja merr pjesë në diskutime të ndryshme shkencore duke angazhuar ekspertë ose duke ushtruar rolin e koordinimit të aktiviteteve shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare (RVV, f. 43). Nëpërmjet QKSh-së, si organizatore e konferencave, dhe me Këshillin Kombëtar të Republikës së Kroacisë, AS-ja ka nxjerrë përfundime shkencore dhe rekomandime politikash, të cilat u janë ofruar për zbatim institucioneve të interesuara, që kanë përfshirë orientimin e zhvillimin social, ekonomik dhe shkencor të vendit dhe më gjerë (RVV, f. 43; BM9). Disa nga këto rekomandime lidhen me parandalimin e vetëvrasjeve, me sigurinë rrugore, sigurinë mjedisore, sigurinë kibernetike, etj. (A4.45). Gjithashtu, AS-ja këshillon, drejton dhe kryen kërkime dhe studime për institucionet dhe organizatat vendase dhe të huaja për sigurinë publike, si Gazsjellësi Trans Adriatik (TAP), SHELL Albania, OSBE, etj., që kanë mbështetur financiarisht botimet shkencore ose konferencat ndërkombëtare të AS-së, duke sjellë ekspertët e tyre në këto diskutime (RVV, f. 43; A4.46) [Standardi IV.16].

4.17 AS-ja i ka vendosur rezultatet e kërkimeve të fundit, tendencat dhe gjetjet e veprimtarive dhe studimeve shkencore në shërbim të Policisë së Shtetit dhe agjencive të tjera ligjzbatuese në fushën e sigurisë. Një shembull i mirë është ai i mbështetur nga

përfundimet e nxjerra nga konferenca ndërkombëtare për sigurinë rrugore për Ministrinë e Punëve të Brendshme, që synon përmirësimin e teknologjisë dhe masave që do të ndikojnë te siguria rrugore (RVV, f. 43; A4.47). AS-ja ndjek një politikë të qartë dhe të shkruar në strategjitë dhe rregulloret e kërkimit dhe zhvillimit, që rregullojnë kërkimin shkencor ose procesin e botimit, e cila mbron të drejtat e pronësisë intelektuale të autorëve (A4.1; A1.7; A4.11; A4.18), por, në të ardhmen, duhet të planifikohet kontrolli nëpërmjet një programi kundër plagjiaturës, pasi aktualisht nuk ekziston një i tillë (BM3, BM5). Megjithatë përmendet se AS-ja ka arritur të sigurojë të ardhura dhe financim nga palë të treta nëpërmjet arritjeve të kërkimit shkencor, këto të ardhura janë vetëm dhurime (RVV, f. 43; A4.46; A 4.25) [Standardi IV.17].

Gjetje

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë:

- Botimi i revistës “Policimi dhe Siguria” nga AS-ja, e regjistruar me numër ISSN, është shumë inkurajues, sepse mundëson botimin e punimeve shkencore të kryera nga stafi akademik dhe studentët [Standardi IV.9]

Pikat e dobëta

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi pikat e dobëta të mëposhtme:

- Mbështetja e ulët financiare për pjesëmarrje në konferenca, kongrese dhe simpoziume ndërkombëtare, tarifat për dorëshkrimet që do të botohen në revista kombëtare dhe ndërkombëtare dhe që buxheti për projektet kërkimore nuk është i mjaftueshëm. [Standardi IV.2, IV.3, IV.5]
- Numri i vogël i mobiliteteve për studentët dhe stafin akademik, përveç disa shkëmbimeve përvojash me pedagogët, me mbështetjen e projektit të BE-së. [Standardi IV.14].

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- AS-ja duhet të rrisë mbështetjen financiare dhe aplikimet për projektet kërkimore të zakonshme në thirrjet kombëtare dhe ndërkombëtare, me qëllim rritjen e numrit të projekteve kërkimore ndërkombëtare. [Standardi IV.2, IV.3, IV.5]
- AS-ja duhet të rrisë mobilitetin e stafit akademik dhe studentëve dhe të rrisë mbështetjen ndaj kërkuesve të rinj dhe studentëve, për t’u përfshirë më shumë në projekte kërkimore dhe në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare nga stafi i nivelit të lartë. [Standardi IV.8, IV.14]

Konfirmimi i veprimit të ndërmarrë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon veprimet aktualisht në proces si më poshtë:

- Zbatimi i projektit kërkimor kombëtar nga AS-ja, me mbështetjen e AKKSHI-t, është shumë inkurajues. [Standardi IV.7]

Gjykimi

Standardet për Veprimtarinë Shkencore/Artistike dhe Inovacionin janë përmbushur kryesisht.

Fusha e vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e tyre

5.1 Pranimi i studentëve të rinj në AS kryhet në bazë të kërkesave dhe politikave të Policisë së Shtetit për personelin, punësimin dhe rekrutimin, në përputhje me Ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, bazuar te kërkesat e posaçme të miratuara me vendimin e Senatit Akademik të AS-së, si dhe tek udhëzime të tjera ligjore në fuqi, në kuadër të arsimit të lartë (RVV, f. 44; A5.1; A3.13). I gjithë informacioni rreth kriterëve, kuotave dhe procedurës së aplikimit është publikuar në faqen zyrtare të internetit të AS-së (A5.2). Sa u përket kuotave për studentët dhe kolegjin, parimisht ndiqet e njëjta linjë për ata që vijnë në Policinë e Shtetit dhe nevojat për nënkomisionerët. Këtë vit planifikohet të regjistrohen 100 studentë (BM3). Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, në bashkëpunim me Bordin e Administrimit, miraton kuotat e pranimit për secilin program studimi, si dhe për trajnimet dhe kualifikimet vjetore (RVV, f.45; A5.3; A2.11; BM3). AS-ja merr parasysh dhe zbaton raportin numerik të personelit akademik për studentë, në mënyrë që të garantojë një proces mësimdhënieje cilësor, në përputhje me qëllimet për arsimin cilësor, dhe ky raport është 1 me 20 deri në 1 me 30 (RVV, f. 44; A5.4) [Standardi V.1].

5.2 Në departamentet përkatëse, studentët mbështeten me udhëzim dhe tutorim gjatë gjithë periudhës studimore.

Krahas kësaj, në fillim të secilit vit akademik, Zyra e Alumnit i ndihmon dhe i informon studentët për kurrikulën e programit të studimit, rëndësinë e ndjekjes së orëve, dhe se si të sigurojnë literaturën gjatë vitit akademik, nëpërmjet:

- programit të kursit, që u bëhet me dije të gjithë studentëve nga pedagogu i kursit që në orën e parë në auditor;

- pedagogëve trajnues;

- pedagogëve, gjatë udhëheqjes për udhëzim dhe mbështetje për përgatitjen e temës së diplomës, personelit bibliotekar dhe sekretarive mësimore (RVV, f. 45; BM5). Gjithashtu, AS-ja kryen promovime dhe publicitet për angazhimin e studentëve, me qëllim rritjen e cilësisë së kandidatëve për studime në BSC dhe kolegji (BM3). Po ashtu, trajnuesit i ndihmojnë studentët me përzgjedhjen e temës së diplomës duke i udhëhequr deri në përfundim të ciklit të studimeve (A5.5; BM5; BM3; BM7). Caktimi i udhëheqjes së temave të diplomave organizohet në përputhje me rregulloret e programeve të studimit (A1.17). Dokumentet e studentëve menaxhohen nga sekretaria mësimore dhe, pas diplomimit të studentëve, arkivohen sipas Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për arkivat në RSh”, i ndryshuar (A5.8; Vizita orientuese), por nuk ka sistem digjital për studentët. [Standardi V.2].

5.3 AS-ja u ofron studentëve këshillim, orientim dhe komunikim në nivele të ndryshme me personelin akademik, ndërsa, për çdo program studimi, departamentet dhe sekretariatë mësimore ofrojnë mbështetje për studentët (RVV, f. 45; BM3; BM7). Përdoren edhe rrjete elektronike për komunikim dhe informim: faqja e internetit e Akademisë së Sigurisë, rrjetet sociale të AS-së, si dhe rrjeti i Policisë së Shtetit (asp.gov.al), ndërsa për logjistikën mbështetja ofrohet nga “Sektori i Ekonomisë dhe Shërbimeve” (A5.6; A4.31). Informacioni

afishohet edhe në tabela në korridoret e fakultetit dhe studentët mund t'u drejtohen zyrrave të informacionit dhe përgjegjësve të departamenteve për pyetjet e tyre (BM3; BM5; Vizita orientuese). Përdorimi i internetit shërben si mundësi për komunikimin e brendshëm ndërmjet pedagogut dhe studentit, meqenëse studentët kanë adresa e-mail-i në rrjetin e brendshëm të Policisë së Shtetit, si dhe numrat individualë të telefonit të përdorur nga oficerët e policisë dhe studentët (A5.7). Komunikimi i jashtëm kryhet nëpërmjet faqes së internetit të institucionit, rrjetit social Facebook, adresës së e-mail-it, telefonit, postës, etj. (A 4.31; A5.7; BM5). Mënyrat dhe format kryesore të informimit dhe komunikimit me studentët në AS përfshijnë: faqen zyrtare të internetit të institucionit të AS-së; faqen zyrtare në Facebook; numrat e telefonit; adresat e e-mail-it; banderolat (posterat) e vendosura në këndet e informacionit; fletushkat; sekretarinë mësimore; dhe adresat postare (RVV, f. 46; BM5; Vizita orientuese). Krahës kësaj, studentët mund të komunikojnë me personelin administrativ nëpërmjet adresave elektronike të brendshme të personelit administrativ, të publikuara në rrjetin e brendshëm të përdorur nga policia (RVV, f. 46) [Standardi V.3].

5.4 Studentët kanë organin përfaqësues të Këshillit Studentor, bazuar te Nenet 54 dhe 55 të Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe te statuti i AS-së. Këshilli Studentor është një organizatë e pavarur e studentëve, që nuk zhvillon veprimtari politike dhe ekonomike. Anëtarët e këtij këshilli zgjidhen sipas një procedure të caktuar (RVV, f. 46; BM5). Këshilli Studentor promovon pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinon përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të AS-së, në strukturat mësimore-kërkimore dhe të shërbimit, si dhe funksionon në përputhje me aktet rregullatore të AS-së (A1.17; A1.1; BM5). Studentët ndahen në grupe dhe kanë nga një drejtues për çdo grup, si dhe një pedagog përgjegjës për klasën. Drejtuesi kryen mbledhje me pedagogët çdo javë dhe, më pas, ia drejton kërkesat Këshillit Studentor. Këshilli Studentor ka organizuar një sërë aktivitete (BM5). Për shembull, studentët kanë kërkuar rritjen e praktikës, që është miratuar dhe do të zbatohet për brezin e ardhshëm (BM5). Megjithatë, AS-ja inkurajon pjesëmarrjen e studentëve në vendimmarrje, organizimin e lirë dhe shprehjen e opinioneve të tyre. Kjo parashikohet shprehimisht në dispozitat e statutit të AS-së dhe në “Rregulloret e FSH-së”, etj. (RVV, f. 46; A1.1; A1.17; BM5). Fakulteti dhe kolegji kanë Këshill Studentor. Secili Këshill Studentor në nivel fakulteti ka përfaqësuesit e vet (A5.11), dhe përfaqësuesit e këshillit studentor janë pjesë e organeve kolegjiale të AS-së (A5.10). Këshilli Studentor, nëpërmjet përfaqësuesve të tij, shpreh opinione dhe propozime për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm për AS-në, si planet dhe programet e studimit; rregulloret për veprimtaritë mësimore; të drejtën e studimit; cilësinë e shërbimeve; zhvillimin e veprimtarive edukative; aktivitete të ndryshme kulturore, artistike, sportive, etj. (RVV, f. 46; BM5). Senati Akademik ka një përfaqësues studentësh, që zgjidhet me votë të fshehtë nga vetë studentët, dhe përfaqësuesi i studentëve në senatin e AS-së shpreh opinione dhe propozime për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm, që merren drejtpërdrejt nga takimet me studentët dhe nëpërmjet ankesave të paraqitura në sekretariatë mësimore (A5.12; BM5). Këshilli Studentor nuk ka një buxhet të posaçëm për veprimtaritë që kryen, ndaj bën kërkesa për nevojat për aktivitete të ndryshme sociale dhe sportive, por aktivitetet e Këshillave janë të mbështetura në mënyrë të përshtatshme (BM5) [Standardi V.4].

5.5 Departamentet, sekretariatë mësimore dhe sektori i ekonomisë dhe shërbimeve organizojnë aktivitete të përgjithshme dhe të ndara sipas programeve të studimit, për t'i njohur studentët me ambientet e Akademisë, personelin, mjedisin, rregulloret, të drejtat dhe detyrimet e studentëve (A5.8; A5.13; A5.14; BM5; BM7). Në AS funksionon dhe Sektori i disiplinës dhe sigurisë, që i ndihmon studentët gjatë veprimtarive 24 orë. Duke qenë se disa nga studentët janë akomoduar në konvikte, personeli i njeh me rregulloret dhe rregullat e disiplinës në konvikt (RVV, f. 47; A5.13). Materiali mësimor për studentët është kryesisht në formën e librave mësimorë dhe leksioneve, që jepen nga pedagogu në formë të printuar, por mund të gjenden edhe në bibliotekën e fakultetit ose mund të aksesohen nëpërmjet link-eve të rekomanduara në internet (BM5; Vizita orientuese). Biblioteka është e pajisur mirë, me materiale të mjaftueshme dhe një bibliotekë online për legjislacionin bazë, që është 100% e aksesueshme, por që mund të përdoret vetëm në AS (BM5; Vizita orientuese). Krahas kësaj, Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes së Studentëve u ofron studentëve materiale dhe broshura informuese lidhur me organizimin e institucionit, si dhe me të drejtat e tyre të miratuara në Statutin e AS-së dhe në rregulloret përkatëse të njësive të posaçme (RVV, f. 47) [Standardi V.5].

5.6 Për fëmijët jetimë të oficerëve të policisë të rënë në detyrë ofrohen bursa (RVV, f. 47; A5.15), dhe AS-ja zbaton edhe politika të Policisë së Shtetit që favorizojnë dhe inkurajojnë rekrutimin e grave (A5.16; BM5). Aktivitetet sportive janë pika më e fortë. Muajin e kaluar, studentët morën pjesë në maratonën në Voskopojë, ndërsa tani po përgatiten për maratonën në Tiranë (BM5). Krahas kësaj, janë organizuar edhe konkurse të tjera ndërmjet klasave në futboll, volejboll, basketboll, ping-pong, xhudo, etj., meqenëse disponohen të gjitha kushtet për këto aktivitete (BM5; Vizita orientuese). Për pranimin e studentëve nga pakicat e ndryshme ndiqen edhe politika të veçanta (A5.17) dhe AS-ja ndjek një politikë mbështetëse për studentët nga komuniteti rom dhe egjiptian, në përputhje me ligjet në fuqi dhe udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (RVV, f. 47) [Standardi V.6].

5.7 AS-ja ofron një bibliotekë të pasur me libra mësimorë dhe literaturë shtesë, ndërsa librat mësimorë për studentët miratohen nga njësitë bazë përkatëse dhe përdoren edhe në universitete të tjera në vend dhe më gjerë (RVV, f. 47; BM3; BM5). Biblioteka shërben edhe si sallë studimi për studentët, në të cilën gjendet literaturë me tituj librash universitarë dhe botimesh artistike, me rreth 7000 tituj [A 5.1, Vizita orientuese]. Studentët marrin materiale të tjera mësimore online nga pedagogët, që i kanë botuar në formë të shtypur (BM5). Literatura pasurohet periodikisht dhe pasqyrohet në syllabuset e kurseve përkatëse, si dhe nëpërmjet botimeve në revistën shkencore “Policimi dhe Siguria” të AS-së, abonimeve në biblioteka dhe revista në internet, kërkimit shkencor nga pedagogët, dhe botimeve në kuadër të projekteve ndërkombëtare (RVV, f. 48; A3.3; A4.12).

